

IX 9Marks SI TË NDËRTOJMË KISHA TË SHËNDETSHME

ANËTARËSIA E KISHËS

SI E
KUPTON BOTA
SE KUSH
E PËRFAQËSON
JEZUSIN

JONATHAN LEEMAN

Parathënia nga Michael Horton

“Udhëheqësit e kishave në shumë denominacione të ndryshme do të zbulojnë që ky libër i vogël është i mbushur me ide praktike dhe argumente të mira, të cilat do të na ndihmojnë që t'i kurojmë të krishterët në kulturën tonë të sotme nga alergjia e tyre ndaj anëtarësisë së kishës, autoritetit pastoral, llogaridhënies në jetë, si dhe ndaj çdo kufizimi që i bëhet lirisë së tyre personale.”

Tim Keller, pastor kryesor, Redeemer Presbyterian Church,
New York City

“I shkurtër, i freskët, argëtues dhe, mbi të gjitha, biblik. Ky libër është shpjegimi më i qartë dhe mbrojtja më e mirë e anëtarësisë së kishës që keni pritur të lexoni.”

Mark Dever, pastor kryesor, Capitol Hill Baptist Church,
Washington, DC

“Praktik. Bindës. Besnik ndaj Biblës. Leeman-i na kujton që anëtarësia e kishës nuk është një zgjedhje, por një domosdoshmëri. Ky është një libër goditës dhe provokues, por, njëkohësisht, është i mbushur me ungjillin e hirit.”

Thomas Schreiner, profesor i interpretimit të Dhiatës së Re në katedrën “James Buchanan Harrison”, The Southern Baptist Theological Seminary

ANËTARËSIA E KISHËS

9Marks: Si të ndërtojmë kisha të shëndetshme

Redaktuar nga Mark Dever dhe Jonathan Leeman

Expositional Preaching: How We Speak God's Word Today,
David Helm

Sound Doctrine: How a Church Grows in the Love and Holiness of
God, Bobby Jamieson

Ungjilli: Si e portretizon kisha bukurinë e Krishtit, Ray Ortlund

Ungjillëzimi: Si flet e gjithë kisha për Jezusin, J. Mack Stiles

Anëtarësia e kishës: Si e kupton bota se kush e përfaqëson Jezusin,
Jonathan Leeman

Disiplina e kishës: Si e ruan kisha emrin e Jezusit,
Jonathan Leeman

Pleqësia e Kishës: Si ta bariton grigjën e Perëndisë si Jezusi,
Jeramie Rinne

SI TË NDËRTOJMË
KISHA TË SHËNDETSHME

ANËTARËSIA E KISHËS



SI E
KUPTON BOTA
SE KUSH
E PËRFAQËSON
JEZUSIN

JONATHAN LEEMAN

Parathënia nga Michael Horton

Titulli në original:

Church Membership: How the World Knows Who Represents Jesus

Copyright © 2012 Jonathan Leeman

Published by Crossway

a publishing ministry of Good News Publishers

Wheaton, Illinois 60187, U.S.A.

This edition published by arrangement
with Crossway.

All rights reserved.

Për më shumë materiale të tjera nga qendra "IGNIS",
vizitoni faqen www.dritez.al

Përktheu: Asim Hamza

Redaktori: Rudina Boçe - Le Clus

Arti grafik i kopertinës: Dual Identity Inc.

Imazhet e kopertinës: Wayne Brezinka për brezinkadesign.com

Përshtatja e faqesjes në gjuhën shqipe: IGNIS

Të gjitha citimet biblike, nëse nuk thuhet ndryshe, janë marrë nga Bibla ABS, 2009,
përdorur me leje nga Albanian Bible Society (A.B.S.)

Të gjitha të drejtat të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet,
të vendoset në ndonjë sistem, ose të transmetohet nëpërmjet çdo forme apo mënyre
elektronike, mekanike, fotokopjimi, incizimi apo në ndonjë mënyrë tjetër, pa marrë
leje me shkrim nga botuesi.

9Marks ISBN: 979-8-89218-228-7

Dedikuar anëtarëve të dikurshëm dhe të tanishëm
të Kishës Baptiste Capitol Hill

PËRMBAJTJA

Dy fjalë për serinë	11
Parathënie	13
Hyrje	17
1 Qasja jonë ka qenë krejt e gabuar	21
2 Shfaqjet e anëtarësisë së kishës në Dhiatën e Re	37
3 Çfarë është një kishë? Çfarë është një anëtar kishë?	53
4 Si duket një kishë dhe anëtarët e saj?	73
5 Cilat janë “standardet” e anëtarësisë? (Të bëhesh anëtar)	89
6 Si i nënshtrohet i krishteri kishës? (Të jesh anëtar)	99
7 Çfarë ndodh kur anëtarët nuk e përfaqësojnë Jezusin?	117
8 A duhet që anëtarësia të duket kudo njëlloj?	131
Përfundim: Si përkufizohet dashuria nga anëtarësia e kishës	143
Burime të mëtejshme	145
Falënderime të veçanta	147
Shënime	149
Treguesi i Shkrimeve	151

DY FJALË PËR SERINË

A besoni se është përgjegjësia juaj të ndihmoni në ndërtimin e një kishe të shëndetshme? Ne besojmë se, nëse jeni të krishterë, është edhe përgjegjësia juaj.

Jezusi ju urdhëron të bëni dishepuj (Mateu 28:18-20). Juda thotë se duhet ta ndërtoni veten tuaj mbi besimin tuaj (Juda 20-21). Pjetri ju bën thirrje t'i vini në shërbim të tjerëve dhuntitë tuaja (1 e Pjetrit 4:10). Pali ju thotë të shpallni të vërtetën me dashuri, në mënyrë që kisha juaj të rritet në çdo gjë (Efesianëve 4:13, 15). A e dalloni se ku po e marrim këtë ide?

Pavarësisht nëse jeni anëtar ose udhëheqës i kishës, seria e librave *Si të ndërtojmë kisha të shëndetshme* synon t'ju ndihmojë të përmbushni këto porosi biblike dhe, si rrjedhojë, të luani rolin tuaj në ndërtimin e një kishe të shëndetshme. Një mënyrë tjetër për ta thënë këtë mund të jetë kjo: “Ne shpresojmë që këta libra do t'ju ndihmojnë të rriteni në dashurinë për kishën tuaj, një dashuri e ngjashme me atë të Jezusit për të.”

9Marks ka botuar një libër të shkurtër dhe të lexueshëm për secilën prej atyre që Mark Dever-i i ka quajtur *nëntë shenjat e një kishe të shëndetshme*, edhe një tjetër mbi doktrinën e shëndoshë. Kërkoni libra mbi predikimin shtjellues, teologjinë biblike, ungjillin, kthimin në besim, ungjillëzimin, anëtarësinë e

kishës, disiplinën e kishës, dishepullimin dhe rritjen, si dhe udhëheqësinë e kishës.

Kishat vendore ekzistojnë për t'ua shfaqur kombeve lavdinë e Perëndisë. Ne e bëjmë këtë duke i ngulitur sytë tek ungjilli i Jezu Krishtit, duke i besuar atij për shpëtim dhe mandej duke e dashur njëri-tjetrin me shenjtërinë, unitetin dhe dashurinë e vetë Perëndisë. Lutemi që ky libër që po mbani në duar t'ju ndihmojë.

Me shpresë,
Mark Dever dhe Jonathan Leeman
Redaktorët e serisë

PARATHËNIE

“Nuk janë pjesët e Biblës që nuk i kuptoj dot ato që më shqetësojnë”, u shpreh Mark Twain-i, “por janë pjesët që i kuptoj.” Fatkeqësisht, mund të thuhet se komenti i Twain-it shërben si akuzë ndaj shumë të krishterëve që “e besojnë Biblën”, sidomos kur bëhet fjalë për pasazhe biblike, të cilat flasin në lidhje me përgjegjësitë e anëtarëve të kishës.

Thjesht mendoni pak për mënyrën se si kultura perëndimore na ndikon të gjithëve ne. Ylli i filmave John Wayne shpesh citohet se ka thënë që i pëlqente Perëndia derisa “hyri nën një çati”. Këngëtarët tanë këndojnë nën zë: “Mos më rretho me gardh!” dhe “E bëra si dija vetë!”. Reklamuesit përpiqen ta joshin hapur narcizmin tonë, duke thënë: “Bëje si dëshiron vetë” dhe “Timonin e ke ti”. Me gjithë këtë atmosferë përreth nesh, është e lehtë të dëshirosh përfitimet, por jo përgjegjësitë e përkatësisë — në miqësi, në martesë, në vendin e punës dhe, sigurisht, në kishë.

Imazhet e individëve që janë bërë të famshëm me forcat e tyre, na kanë bërë pjesërisht dyshues ndaj institucioneve. Por edhe një vazhdë e njëtrajtshme skandalesh publike, si dhe politikat e mërisë, burokracia pa shpirt dhe e paefektshme, bashkë me premtimet e shkelura, e kanë tronditur besimin e publikut tek udhëheqësit dhe institucionet. Madje edhe njerëzit që janë rritur në kisha janë zhgënjyer, janë plagosur

dhe janë abuzuar nga ata që pretendonin të ishin barinj të Krishtit.

Por, për këtë gjë, nuk duhet fajësuar vetëm kultura jashtë kishës. Një pjesë e madhe e ungjillorizmit është kalitur në një përshtirshmëri që e vendos marrëdhënien personale me Jezusin kundër kishës së dukshme dhe me shërbesën e saj publike. Kjo ka ndodhur pjesërisht për arsye se ungjillorët kanë dashur ta shmangin përkushtimin sa për emër dhe formalizmin, gjëra që bëjmë mirë t'i shmangim. Por gjatë procesit, ne kemi pasur prirjen — sidomos që nga Rizgjimi i Dytë i Madh i shekullit të nëntëmbëdhjetë — që t'i kritikojmë ofiqet zyrtare të kishës dhe mjetet e zakonshme të hirit, duke preferuar udhëheqësit karizmatikë dhe lëvizjet e jashtëzakonshme. Mendësia “shpejt dhe lehtë” ka fituar mbi mendësinë “e sprovuar dhe e efektshme”. Rritja e shpejtë në numra është vlerësuar më tepër sesa rritja në hir. Rezultatet pragmatike, jo strukturat formale, janë parë si çelësat e suksesit. Përgjatë këtij shtegu, shumë prej nesh u rritën me nxitjen ungjillore: “Nuk po të kërkoj që t'i bashkohesh një kishe, por që ta pranosh Jezusin si Zotin dhe Shpëtimtarin tënd personal.”

Nuk është e habitshme që pas lëvizjeve të tilla të njëpasnjëshme, “shpëtimi” nuk ka shumë lidhje me bashkimin me një kishë. Madje tani ka lëvizje ungjillore që e shpërfillin krejtësisht idenë e anëtarësisë së kishës. Ato thonë se mjafton që njerëzit të vijnë... ose jo. Një udhëheqës ungjillor feston për shfaqjen e “Revolucionarëve”, të cilët, në njëfarë mënyre, kanë vendosur që *të jesh kisha*, do të thotë *të mos i bashkohesh një kishe*. Përkundrazi, këta revolucionarë i gjejnë burimet e tyre frymërore në internet dhe në takime joformale.

Dhe pastaj vjen Jonathan Leeman-i, i cili jo vetëm që na kujton gjithë ato pasazhe të cilat i kemi lënë mënjanë, por edhe guxon të thotë gjëra të tilla si “Krishti nuk na bën thirrje që t’i bashkohemi një kishe, por që t’i nënshtrohemi një të tille”. Kisha nuk është thjesht një shoqëri tjetër vullnetare, si puna e *Boy Scouts*-ve ose *Sierra Club*-it. Kisha është një ambasadë e mbretërisë së Krishtit. Mbretërit nuk japin sugjerime, nuk shesin produkte dhe as nuk sigurojnë burime të cilat njerëzit mund t’i marrin ose t’i lënë.

Leeman-i gjen vendin mes individualizmit pa fre dhe autoritarizmit legalist, dhe të krishterët e sotëm kanë nevojë të madhe që ta dëgjojnë atë që ai ka për të thënë. Ai na tregon se mbretëria e Krishtit është kundërhelmi i vetëm për këto dy ekstreme. Krishti sundon mbi ne për të na shpëtuar dhe na shpëton për të sunduar mbi ne. Ndryshe nga sundimtarët e kësaj epoke, Jezusi nuk na kërkon të derdhim gjakun për perandorinë e tij; përkundrazi, ai vetë e dha jetën për mbretërinë e tij. Pastaj ai u ngrit në lavdi si fillimi i krijimit të ri, dhe tani ai është duke mbledhur bashkëtrashëgimtarë në mbretërinë e tij, të cilët i përkasin njëri-tjetrit, sepse, së bashku, ata i përkasin atij. Kisha e dukshme është vendi ku do të gjeni mbretërinë e Krishtit mbi këtë tokë, dhe nëse shpërfillni mbretërinë, keni shpërfillur Mbretin e saj.

Disa lexues kanë nevojë që të binden në lidhje me kërkesat biblike — si edhe me bekimin — e anëtarësisë së kishës. Të tjerët, që tashmë janë të bindur, mund të vrasin mendjen se si teoria kthehet në praktikë në jetën reale të kishës. Cili është kriteri i anëtarësisë së kishës dhe si arrijmë të “gjykojmë” me vend dhe me një ndjeshmëri pastorale? Cilat janë pasojat,

sidomos në rastet kur disiplina është e nevojshme në doktrinë apo në jetë? Cilat janë kufizimet dhe përgjegjësitë e udhëheqësve në ushtrimin e autoritetit të tyre të shërbesës? Këto janë pyetje të mëdha. Autori nuk flet në erë, por i thekson të gjitha këto çështje praktike që ngrihen nga argumentet e tij të mbështetura në Shkrim.

Pavarësisht nëse në fund bini apo jo dakord me autorin, Leeman-i thjesht përcjell shumë urtësi biblike në këto pak faqe, urtësi që nuk mund të shpërfilllet kollaj nga asnjë i krishterë. Duke mos qenë baptist, unë nuk bie dakord me gjithçka! Megjithatë, për shumë nga argumentet kryesore në favor të anëtarësisë së kishës kam thirrur "Amen!" me gjithë zemrën time. Më e rëndësishmja është që dallova se po kënaqesha sërish në sigurimin e mrekullueshëm të një Bariu të Mirë, i cili jo vetëm që i ka shpenguar delet e tij, por, gjithashtu, ka një plan të qartë se si t'i ushqejë dhe t'i udhëheqë ato deri në fund.

Michael Horton

Profesor i teologjisë sistematike dhe
i apologjetikës në katedrën "J. Gresham Machen" në
Westminster Seminary, California

HYRJE

Shumë më e rëndësishme nga sa e kuptojmë

Nuk dëshironi me të vërtetë që të lexoni një libër mbi anëtarësinë e kishës. E kuptoj. Ndoshta këtë libër jua ka dhënë dikush. Ndoshta po vrisni mendjen nëse ky do të ishte një material i dobishëm për të tjerët. Le ta themi hapur, tema e anëtarësisë së kishës nuk duket si një temë jashtëzakonisht interesante. Ju bëheni i krishterë dhe i bashkoheni një kishë. Kjo është e gjitha, apo jo?

Ndonjëherë anëtarësia e kishës përfshin elemente programore, si puna e klasave dhe një intervistë. Kjo temë ngatërrrohet me pyetjet në lidhje me pagëzimin dhe Darkën e Zotit. Megjithatë, përveç gjithë këtyre, a ka ndonjë gjë për t'u diskutuar?

Herën e parë kur dikush më tha se duhej t'i bashkohesha kishës ku po merrja pjesë, nuk kisha ndonjë bindje të fortë as pro e as kundër. Ndoshta isha paksa kundërshtues ndaj kësaj ideje? Nuk më kujtohet fare. Megjithatë, ja se çfarë më kujtohet: bashkimi me atë kishë do të më jepte mundësi për të jetuar në "shtëpinë e djemve", me një qira shumë simbo- like dhe në një nga lagjet më të lakmuara. Kështu që iu bashkova kishës. Jo, këtë arsye nuk ua përmenda pastorëve që më intervistuan. As ata nuk më pyetën.

Megjithatë, pikëpamja që kisha për anëtarësinë e kishës ishte si diçka që nuk kërkonte shumë përkushtim. Çfarë mendoni ju: a është gjë e rëndësishme anëtarësia e kishës, apo jo?

Ka disa njerëz që thonë se anëtarësia e kishës është e nevojshme dhe ka disa të tjerë që thonë se ajo është fakultative. Megjithatë, supozoj se shumica e të krishterëve gjenden diku në mes. Ata kanë një ndjesi të mjegullt që të krishterët duhet të përfshihen në një kishë vendore. Por ata thonë gjithashtu se kjo nuk është gjëja më e rëndësishme në botë, prandaj nuk duhet t'i bëjmë shumë bujë. Nëse të krishterët shpenzojnë disa vjet duke kaluar nga një kishë në tjetrën ose nëse vendosin të frekuentojnë vazhdimisht një kishë pa u anëtarësuar në të, të dyja janë në rregull.

Nëse jeni pjesë e kësaj shumice që gjendet në mes, atëherë ju jeni njerëzit për të cilët po e shkruaj këtë libër. Nuk po e shkruaj më së pari për personin që është skeptik ndaj anëtarësisë së kishës, edhe pse, nëse jeni një person i tillë, libri mund të jetë i dobishëm edhe për ju. Unë kam në mendje frekuentuesin e zakonshëm të kishës, anëtarin e kishës, udhëheqësin e kishës, të cilët thjesht kanë ndjekur turmën në lidhje me këtë temë. Ju nuk jeni të sigurt se pse kjo gjë paska kaq shumë rëndësi, por, gjithsesi, thoni: Dakord. Le ta praktikojmë anëtarësinë.

Ju jeni personi të cilit dëshiroj t'i flas. Dëshiroj t'i përgjigjem një pyetjeje të cilën nuk po e bëni, por duhet ta bëni.

Qëllimi im parësor është që t'ju tregoj se *çfarë është anëtarësia e kishës*, sepse ajo nuk është çfarë mendoni ju se është. Nuk do ta mbroj këtë që po them, të paktën jo në mënyrë të drejt-përdrejtë. Thjesht do t'ju paraqes një vizion për anëtarësinë e

kishës. Ja se cili është parashikimi im: nëse e rrokni si duhet mënyrën se si e sheh Bibla anëtarësinë e kishës, mund të ndodhë që kjo ta ndryshojë formën e krishterimit tuaj.

Anëtarësia e kishës, siç paraqitet në Bibël, është një realitet i mahnitshëm. A nuk jeni sadopak kurioz? Ju, madje, nuk jeni plotësisht të bindur se ajo gjendet në Bibël, apo jo?

QASJA JONË KA QENË KREJT E GABUAR

Imperium. Këtë fjalë e zbulova kohët e fundit. Nuk është një fjalë të cilën do ta përdornit teksa pini kafe me miqtë tuaj. Kjo tingëllon si një fjalë e sikletshme nga ana shoqërore, ashtu si në rastin e një trembëdhjetëvjeçari tepër inteligjent. Megjithatë, unë mendoj se kjo është një fjalë e dobishme.

Kjo është fjala që krijohet kur termin *imperial* e kthen në emër, fjalë të cilën mund të ndodhë që ta dëgjoni në biseda kafenesh. *Imperium* do të thotë pushtet suprem ose sundim absolut, dhe kjo të jep idenë se kush e ka autoritetin final në shoqëri. Kush është autoriteti të cilit duhet t'i japin llogari të gjitha autoritetet e tjera? Kush mund të japë ndëshkimin më të rëndë, në kuptimin e plotë të fjalës, pa iu trembur hakmarrjes, pasi kjo përfshihet në vetë autoritetin e tij? Mund të thuhet se ky person ka *imperium*.

Imperium-i ishte ajo që Cezari kishte në Romë, sikurse edhe ata mbretër të mesjetës të cilët gjithmonë thërrisnin: "T'i pritet koka!". Në kohët moderne, ne mund të themi se shteti ka *imperium*. Nuk ka pushtet më të lartë se shteti. Ai

ANËTARËSIA E KISHËS

thotë fjalën e fundit. Vetëm shteti ka fuqinë mbi jetën dhe vdekjen — fuqinë e shpatës.

Prandaj, nëse dëshironi të filloni një biznes ose një shkollë, keni nevojë për lejen e shtetit. E njëjta gjë vlen edhe për klubet sportive, sindikatat ose organizatat bamirëse. Ato ekzistojnë me miratimin e shtetit dhe shteti është ai që i qeveris me ligjet e veta. Nuk e qeverisin ato shtetin. Ato nuk kanë *imperium*.

Dakord, por, ç'mund të themi për kishat vendore? A ekzistojnë ato me lejen e shtetit? Kjo na sjell te një temë interesante. Në fakt, kjo është një temë që mund t'i kthejë kokëposhtë idetë tona të tanishme për kishën vendore dhe anëtarësinë e saj.

JEZUSI KA *IMPERIUM*

Shumica e njerëzve në shoqëritë perëndimore i futin kishat në të njëjtën kategori me klubet e futbollit dhe me organizatat bamirëse. Ne themi se kishat janë një lloj tjetër shoqate vullnetare.

Për pasojë, ne i konsiderojmë kishat si ofruese të një shërbimi, si puna e një mekaniku që i bën shërbime shpirtit tuaj ose si një pikë karburanti që jua mbush serbatorin tuaj frymëror.

Mirëpo, a janë kishat vendore klube ose ofruese shërbimi, të cilat ekzistojnë me lejen e shtetit, si njëfarë lypësi tjetër që varet nga mëshira e zotit të vendit?

Është e vërtetë që ju si individ i krishterë duhet t'i nënshtroheni autoritetit të shtetit. Megjithatë, mbani mend që shteti është “shërbenjësi” dhe “agjenti” i Perëndisë për të ushtruar gjykim (Romakëve 13:4). Po, shteti është ai që e mban “shpatën”, por kjo ndodh vetëm me lejen e Perëndisë.

Është e vërtetë që kishat duhet t'i respektojnë ligjet e

vendit kur bëhet fjalë për rregulla si kodi i ndërtesave (nëse kisha ka një ndërtesë) ose pagimi i taksave për rrogat e stafit (nëse kisha ka staf me pagesë). Në atë kuptim, kishat janë si çdo biznes ose organizatë tjetër.

Në të njëjtën kohë, ka diçka e cila duhet të jetë plotësisht e qartë në mendjen e të krishterit: kisha vendore nuk ekziston me lejen e shtetit. Ajo ekziston për shkak të autorizimit të qartë të Jezusit. Në fund të fundit, Jezusi është ai që ka *imperium* dhe jo shteti.

Të jesh i krishterë, do të thotë të dish këtë: Jezusi është ai që ka autoritetin përfundimtar. Jezusi është autoriteti të cilit duhet t'i japë llogari çdo autoritet tjetër. Jezusi do t'i gjykojë kombet dhe qeveritë e tyre. Jezusi është ai që ka pushtetin final mbi jetën dhe vdekjen. Shteti ekziston vetëm me lejen e Jezusit dhe jo e kundërta. Sigurisht që, zakonisht, shtetet nuk e pranojnë këtë fakt. Mirëpo kishat e dinë që kjo është e vërtetë (Gjoni 19:11; Zbulesa 1:5; 6:15–17).

I gjithë pushteti në qiell dhe mbi dhé i është dhënë Jezusit, dhe ai i jep kishës së tij autoritetin për të marshuar drejt kombeve. Prandaj, kisha e tij do të përparojë si një ushtri që nuk mund të ndalet. Kufijtë e kombeve nuk do ta ndalojnë kishën. Urdhrat ekzekutivë të presidentëve dhe kryeministërve nuk do ta ndalojnë atë. Madje as portat e ferrit nuk do ta ngadalësojnë atë.

Jezusi ka *imperium*.

KEMI NEVOJË QË TË NDRYSHOJMË TË MENDUARIT TONË

Në rast se ndiejmë tundimin për ta mbivlerësuar autoritetin e shtetit, fakti që Jezusi ka *imperium* duhet ta trajtojë këtë gjë.

ANËTARËSIA E KISHËS

Shteti është thjesht një nga agjentët e tij, të cilit i është dhënë një mandat i veçantë.

Mirëpo fakti që Jezusi ka *imperium* duhet të ketë efektin e kundërt mbi pikëpamjen tonë për kishën vendore: ajo duhet të fisnikërohet. Edhe kisha vendore është një prej agjentëve të Jezusit dhe ai i ka dhënë asaj një autoritet të cilin ju dhe unë, si individë të krishterë, nuk e kemi. Kjo ka rrjedhoja radikale për atë se çfarë është kisha vendore dhe se çfarë do të thotë të jesh anëtar i saj.

Nëse je një i krishterë që jeton në një demokraci perëndimore, ka të ngjarë të kesh nevojë që ta ndryshosh mënyrën se si mendon për kishën tënde dhe mënyrën se si lidhesh me të. Ti e nënçmon kishën tënde. Ti e deformon atë në një mënyrë që deformon krishterimin tënd.

Të gjithë ne kemi qenë duke menduar për kishën vendore dhe për anëtarësinë e saj sikur ajo është një gjë, kur, në realitet, është diçka krejt tjetër. Kjo është sikur ta shihnim familjen tonë të afërt (babanë, nënën, fëmijët) dhe ta konsideronim atë një biznes. Dhe ja ku vij unë e ju them: “Ato nuk janë biznese; ato janë familje! Kemi nevojë që të nisim e t’i trajtojmë ndryshe.”

Më lejoni që në këtë kapitull të përpiqem t’ju shpalos të gjithë vizionin me pesë ide të mëdha, të cilat mbështeten në realitetin gjithëpërfshirës të *imperium*-it të Jezusit. Pastaj, pjesën tjetër të librit do ta kaloj duke trajtuar rrëmujën që do të bëj këtu: duke argumentuar, duke shtjelluar dhe duke zbatuar.

Do të fillojmë duke thënë se çfarë nuk është kisha vendore. Nëse je i krishterë, kisha vendore nuk është një klub.

Ajo nuk është një organizatë vullnetare, në të cilën anëtarësia është diçka me zgjedhje. Kisha nuk është një grup miqësor njerëzish që kanë interes për gjërat fetare, dhe prandaj mbli-dhen çdo javë për të folur për realitetin e hyjnore.

Kisha nuk është as një ofruese shërbimesh, ku të gjithë autoritetin e ka konsumatori. Është diçka ironike që ne flasim për “shërbimet” e kishës (po, edhe unë e bëj). Siç ju thashë edhe më parë, është sikur ne po u themi njerëzve që të vijnë në par-kimin e kishës në orën 11:00 dhe aty të marrin shërbimin — “Rregullime për shpirtin tuaj brenda gjashtëdhjetë minutash!”.

Ndoshta këtë lloj të kuptuari për kishën vendore e kemi marrë nga theksimi protestant për vendin ku ndodh predi-kimi dhe ku ofrohen sakramentet. Ndoshta jemi mashtruar nga shoqëria demokratike dhe perëndimore që t’i shohim kishat si shoqata vullnetare. Ndoshta ngaqë kemi një shekull që po e praktikojmë të qenët konsumatorë. Nuk jam i sigurt. Por ja ku janë disa nga simptomat e të menduarit tonë të gabuar:

- Të krishterët mund të mendojnë se është në rregull që të frekuentojnë një kishë për një kohë të pacaktuar edhe pa iu bashkuar asaj si anëtarë;
- Të krishterët e mendojnë pagëzimin të shkëputur nga bash-kimi me kishën;
- Të krishterët e marrin Darkën e Zotit pa iu bashkuar kishës;¹
- Të krishterët e shohin Darkën e Zotit si përjetimin e tyre privat, mistik dhe jo si një veprimtari për anëtarët e kishës, të cilët janë përfshirë së bashku në jetën e trupit;
- Të krishterët nuk e lidhin jetën e tyre nga e hëna në të shtunë me jetët e shenjtoreve të tjerë;
- Të krishterët supozojnë se mund të ruajnë një zakon të

ANËTARËSIA E KISHËS

përhershëm të të munguarit në takimet e kishës për dy apo më shumë javë në muaj;

- Të krishterët marrin vendime madhore në jetë (zhvendosja e vendbanimit, pranimi i një ngritjeje në detyrë, zgjedhja e bashkëshortit/bashkëshortes etj.) pa i menduar efektet e atyre vendimeve në rrjetin e marrëdhënieve në kishë ose pa u konsultuar me urtësinë e pastorëve të kishës dhe të anëtarëve të tjerë;
- Të krishterët blejnë shtëpi ose marrin apartamente me qira pa i kushtuar shumë rëndësi mënyrës se si faktorë të tillë si largësia dhe kostoja do të ndikojnë në aftësinë e tyre për t'i shërbyer kishës së tyre;
- Të krishterët nuk e kuptojnë që janë pjesërisht përgjegjës si për mirëqenien frymërore, ashtu edhe për atë fizike të anëtarëve të tjerë të kishës së tyre, madje edhe për anëtarët që nuk i kanë takuar. Kur dikush vajton, vajton vetëm. Kur dikush gëzohet, gëzohet vetëm.

Sëmundja bazë pas gjithë këtyre simptomave, sëmundja të cilën e pranoj që gjendet edhe në venat e mia, është supozimi që ne kemi autoritetin për ta drejtuar vetë jetën tonë të krishterë. Ne e përfshijmë pjesën e kishës kur na pëlqen dhe aty ku na pëlqen.

Kjo do të thotë që ne e trajtojmë kishën vendore si një klub të cilit mund t'i bashkohemi — ose jo. Ky supozim na lë në një pozitë ku e jetojmë jetën tonë të krishterë disi të shkëputur nga kisha vendore, madje edhe atëherë kur i *bashkohemi* një të tille: “Sigurisht, unë jam anëtar, por pse vallë t’i kërkoj kishës që të më ndihmojë për ta menduar mirë mundësinë e pranimi të asaj pune në filan qytet?”.

Ju lutem, më kuptoni, nuk jam thjesht duke treguar me

gisht. Këto janë edhe instinktet e mia kulturore. Unë rrëfej që dëshiroj t'i bëj gjërat sipas mënyrës sime. Dëshiroj t'i shmangem mbajtjes përgjegjësi për të tjerët.

Mirëpo kjo nuk është tabloja biblike. Duhet t'i heqim syzet që kemi dhe të vendosim një palë të tjera. A jeni gati?

AUTORITETI MË I LARTË I MBRETËRISË MBI TOKË

Çfarë është kisha vendore? Do t'ju them disa gjëra për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, por më lejoni të filloj me këtë: kisha vendore është autoriteti që Jezusi e ka themeluar mbi tokë për ta afirmuar zyrtarisht dhe për t'i dhënë formë jetës sime të krishterë dhe jetës suaj gjithashtu.

Jezusi e themeloi kishën vendore, po ashtu sikurse themeloi edhe shtetin. Ky është një autoritet institucional, sepse Jezusi e *themeloi* me autoritet. Tani, po përpiqem fort që këtu të mos hyjmë në ndonjë bisedë për marrëdhënien mes kishës dhe shtetit, por ja se çfarë duhet të kuptoni nëse do të bëjmë një diskutim që ndryshon mendësinë në lidhje me anëtarësinë e kishës:

Ashtu sikurse Bibla e deklaron hapur qeverinë e kombit tuaj si autoritetin tuaj më të lartë mbi tokë kur bëhet fjalë për qytetarinë tuaj në atë komb, po kështu Bibla e deklaron hapur kishën vendore si autoritetin tuaj më të lartë mbi tokë kur bëhet fjalë për dishepullimin tuaj në Krishtin dhe për qytetarinë tuaj në kombin e tanishëm dhe në atë të premtuar të Krishtit.

Prandaj, Jezusi e ka themeluar shtetin duke i dhënë atij pushtetin e shpatës. Në kuptimin më të ngushtë, kjo do të thotë që shteti mund të ta marrë jetën (nën autoritetin e Fjalës

ANËTARËSIA E KISHËS

së Perëndisë). Si rrjedhim, kjo do të thotë që ai e ka mekanizmin përforcues dhe të nevojshëm për themelimin e strukturave bazë të shoqërisë si, për shembull, për të vendosur se kush pranohet publikisht si qytetar i tij.

Në mënyrë të ngjashme, Jezusi ka themeluar kishën vendore duke i dhënë asaj “pushtetin e çelësve”. Në kuptimin më të ngushtë, kjo do të thotë që ajo mund ta përjashtojë një person nga anëtarësia e kishës (nën autoritetin e Fjalës së Perëndisë). Si rrjedhim, kjo do të thotë që ajo e ka mekanizmin përforcues dhe të nevojshëm për themelimin e strukturave bazë të jetës së mbretërisë si, për shembull, për të vendosur se kush pranohet publikisht si qytetar i saj.

TË KËRKOSH GJËRAT E DUHURA

Prandaj, në vend që të fillojmë me idenë e një kishe si një shoqatë vullnetare, ne kemi nevojë që të fillojmë me idenë e kishës si populli i një mbretërie apo i një kombi. A e dalloni se çfarë dua të them kur e ndryshoj kategorinë, pra, si kalimi nga biznesi te familja?

Kur njerëzit pyesin: “Ku e gjejmë *anëtarësinë* në Bibël?”, problemi është që ata po kërkojnë diçka si puna e një klubi të cilit t’i bashkohen, sepse fjala *anëtarësi* është një fjalë që lidhet me idenë e klubit. Klubet, partitë politike dhe sindikatat e punëtorëve kanë anëtarësi. Por ju nuk e përdorni shpesh fjalën *anëtarësi* në lidhje me qeveritë dhe qytetarët e kombeve. Ju nuk thoni: “Si po ecën anëtarësia e kombit tuaj britanik? A nuk keni arritur diku te gjashtëdhjetë milionë anëtarë në këto kohë?”

Klubet fillojnë me një pikë interesi të përbashkët. Ofruesit e shërbimit fillojnë me një nevojë ose dëshirë të përbashkët.

Kishat i kanë të gjitha këto, por ato kanë diçka më shumë: një mbret i cili kërkon bindjen e njerëzve të tij. Kisha fillon me këtë fakt: Jezusi është Shpëtimtar dhe Zot. Ai ka vdekur në kryq për mëkatet e të gjithë atyre që do të besojnë dhe do ta ndjekin atë.

Kjo do të thotë që Bibla nuk flet për anëtarësinë e kishës ashtu siç mund të doni ju që të flasë. Përkundrazi, ajo flet për mënyrën se si populli i Perëndisë *mblidhet bashkë nën sundimin e tij suprem*. Bibla është e interesuar për qytetarët e një mbretërie dhe jo për anëtarët e një klubi. Përtej kësaj, Bibla flet për unitetin e kishës duke përdorur një numër të caktuar metaforash të tjera (familje, hardhi etj.). Kjo na sjell tek ideja e dytë e madhe:

Kur hapni Biblën tuaj, mos kërkonit më shenjat e një klubi me anëtarët e tij vullnetarë. Përkundrazi, kërkonit një Zot dhe popullin e tij të lidhur bashkë. Kërkonit, gjithashtu, forma të tjera uniteti (vëllezër dhe motra në një familje, degë të një hardhie etj.).

A gjendet anëtarësia e kishës në Bibël? Nëse e kërkonit gjënë e duhur, ajo gjendet kudo. Do të përpiqem t’ju tregoj në kapitujt 2, 3 dhe 4.

JO NJË KLUB, POR NJË AMBASADË

Kisha është shumë më tepër se një autoritet institucional mbi ju dhe mua. Kemi nevojë për idenë e një kishe si familje, si tufë, si tempull, e kështu me radhë. Mirëpo të gjitha këto realitete të tjera duhen vendosur brenda strukturës së autoritetit të kishës vendore dhe kjo është arsyeja pse po filloj me këtë. Autoriteti i

ANËTARËSIA E KISHËS

kishës u jep *formë* aspekteve familjare të jetës së kishës, aspekteve të trupit në jetën e kishës, e kështu me radhë.

Prandaj, për të përshkruar se si duket jeta brenda kishës vendore, do të përdor disa metafora biblike. Megjithatë, dëshiroj të filloj me një mbi të cilën të mund të ndërtojmë më tej, me një që zëvendëson idenë e “klubit” ose të “ofruesit të shërbimeve”: kjo është metafora e një pararoje apo e një ambasade.

Ku e gjeta idenë e një ambasade? Këtë e gjej tek ideja biblike e mbretërisë së Krishtit. Një kishë nuk është mbretëria; ajo është një pararojë ose një ambasadë e asaj mbretërie.

Çfarë është një ambasadë? Ajo është një institucion që përfaqëson një komb brenda një kombi tjetër. Ajo shpall interesat e *atdheut* të saj në *kombin pritës* dhe i mbron qytetarët e atdheut që jetojnë në kombin pritës. Për shembull, unë kalova pesë muaj të universitetit në Bruksel të Belgjikës. Gjatë asaj kohe, më skadoi pasaporta amerikane. Nëse do të isha përpjekur të largohesha nga vendi pa e rinovuar pasaportën, do të kisha përfunduar në telashe. Nuk kisha më një dokument të vlefshëm që vërtetonte se isha qytetar i SHBA-së. Një pasdite shkova në Ambasadën e SHBA-së në Bruksel dhe aty e rinovova pasaportën time. Ambasada nuk më *bëri* qytetar amerikan atë pasdite, por ajo *e vërtetoi* zyrtarisht qytetarinë time. Edhe pse jam qytetar i SHBA-së, nuk e kam autoritetin që ta shpall veten time zyrtarisht si të tillë përpara kombeve. Megjithatë, afirmimi nga ambasada më dha mundësinë që të vazhdoja të jetoja në një qytet të huaj, duke gëzuar mbrojtjen e të gjitha të drejtave dhe përfitimeve që burojnë nga qytetaria ime.

Prandaj, një ambasadë përfaqëson një vend në një vend tjetër të globit. Po sikur t’ju thosha se ekziston një lloj tjetër

ambasade, një ambasadë që përfaqëson një vend *nga e ardhmja*? E tillë është kisha vendore. Ajo përfaqëson gjithë grupin e njerëzve nën sundimin e Krishtit, të cilët do të mbledhen bashkë në fund të historisë.

Pali na thotë se qytetaria e një të krishteri është në qiell. Ai, madje, na quan “bashkëqytetarë” me Izraelin, gjë që është interesante kur marrim parasysh se çfarë do të thoshte qytetaria për Izraelin.

Megjithatë, ndryshe nga Izraeli, atdheu i të krishterëve nuk gjendet në planetin Tokë. Ne jemi të huaj dhe shtegtarë. Të krishterët duhet të presin atdheun e tyre. Ata presin ditën kur “Mbretëritë e botës u bënë të Zotit tonë dhe të Krishtit të tij”, kur çdo gju do të bjerë dhe çdo gjuhë do të rrëfejë se “Jezu Krishti është Zot” (Zbulesa 11:15; Filipianëve 2:11).

Mirëpo prisni pak. Tani ekziston një vend në botë ku qytetarët e qiellit mund të mbledhen, të njihen zyrtarisht dhe të strehohen: ky vend është kisha vendore. Kishat përfaqësojnë mbretërimin e Krishtit tani. Ato i afirmojnë dhe i mbrojnë qytetarët e tij tani. Ato shpallin ligjet e tij tani. Ato përulen përpara tij si Mbret tani dhe u bëjnë thirrje të gjithë njerëzve për të bërë të njëjtën gjë. Ja ku është ideja e tretë e madhe:

Një kishë vendore është një ambasadë reale, e vendosur në të tashmen, e cila përfaqëson mbretërinë e ardhshme të Krishtit, si dhe kishën e tij të ardhshme mbarëbotërore.

Ideja e anëtarësisë del menjëherë nga kjo tablo e kishës vendore. Çfarë është një anëtar i kishës? Ai është dikush që hyn në derën e ambasadës dhe deklaron që i përket mbretërisë së

ANËTARËSIA E KISHËS

Krishtit. “Përshëndetje, emri im është i Krishterë.” Nëpunësi i ambasadës shtyp disa butona në tastierën e kompjuterit të tij dhe thotë: “Po, më dalin të dhënat e tua. Ja ku e ke pasaportën.” Tani personi mund t’i shijojë shumë nga të drejtat, përfitimet dhe detyrimet që rrjedhin nga qytetaria e tij, edhe pse është duke jetuar në një vend të huaj. Por jo vetëm kaq — dhe kjo është pjesa e pabesueshme — ai person bëhet vetë pjesë e ambasadës — një nga nëpunësit që i afirmon dhe i mbikëqyr të tjerët. Të jesh anëtar i kishës, do të thotë *të jesh* kisha, të paktën një pjesë e saj.

Prandaj, një anëtar i kishës është dikush që njihet formalisht si i krishterë dhe si pjesë e trupit të përbotshëm të Krishtit. Kjo nuk do të thotë që kishat gjithmonë e dallojnë saktë këtë gjë, por është përgjegjësia e tyre që të identifikojnë dhe të afirmojnë se kush i përket mbretërisë dhe kush jo. Kjo është ideja e katërt e madhe:

Një anëtar i kishës është dikush që është njohur zyrtarisht dhe publikisht si i krishterë përpara kombeve, dhe si dikush që ka pjesë në të njëjtin autoritet për të afirmuar dhe për të mbikëqyrur zyrtarisht të krishterët e tjerë në kishën e tij apo të saj.

Anëtarësia e kishës është shumë më tepër se kaq. Sërish, ne duhet të flasim për tiparet e familjes, të trupit dhe të tufës së anëtarësisë, si dhe për shumë gjëra të tjera, siç do ta shohim në kapitullin e katërt. Por po fillojmë këtu, sepse kjo përfaqëson autoritetin e mbretërisë të cilin Krishti nuk na e ka dhënë neve si të krishterë individualë, por neve si anëtarë të kishës vendore. Jezusi nuk na la që të vetëqeverisemi dhe të vetëshpallemi nënshtetas të tij. Ai la pas një institucion që

na afirmon si besimtarë, dhe pastaj na ndihmon për t'i dhënë formë dhe drejtim jetës sonë të krishterë.

Autoriteti i kishës vendore, i ngjashëm me atë të ambasadës, u jep mundësi individëve që shqiptojnë fjalët, “Unë jam me Jezusin”, që të demonstrojnë se ato fjalë kanë kuptim. Kisha vendore e ruan reputacionin e Krishtit duke i ndarë rrëfyesit e vërtetë të besimit nga ata të rremët. Kisha vendore i jep mundësi botës të shohë kanavacën e popullit të Perëndisë dhe aty të dallojë një tablo të vërtetë të dashurisë dhe shenjtërisë së Krishtit, dhe jo një falsifikim. Kisha vendore shtron një shteg me parmakë dhe me vendpushime për udhëtimin e gjatë të jetës së krishterë.

Mbretërit dhe qeveritarët e kombeve nuk tregohen të shkujdesur për faktin se kë njohin si qytetarë të tyre. A do të tregohet Mbreti i gjithësisë më pak i kujdesshëm se ata?

NËNSHTRIM, JO THJESHT BASHKIM

Nëse Jezusi e themeloi kishën vendore me autoritet mbi ne, ne nuk i bashkohemi një kishe ashtu siç i bashkohemi një klubi ose një shoqate vullnetare; ne i nënshtrohemi kishës ashtu siç bëjmë me shtetin. Dhe kjo është ideja e pestë e madhe:

Të krishterët nuk u bashkohen kishave; ata u nënshtrohen atyre.

Në fund të fundit, si kisha, ashtu edhe qeveria, përfaqësojnë autoritetin e Jezusit, edhe pse e bëjnë këtë në mënyra të ndryshme. Edhe pastorët dhe udhëheqësit e kishës duhet t'i nënshtrohen kishës në këtë mënyrë. Edhe qytetaria e tyre duhet të afirmohet nga kisha përmes Darkës së Zotit.

ANËTARËSIA E KISHËS

Tani mos më keqkuptoni. Nga pikëpamja e jo të krishterit, një kishë vendore është një shoqatë vullnetare. Askush nuk ka pse t'i bashkohet asaj. Megjithatë, nga pikëpamja e jetës së krishterë, ajo nuk është e tillë. Sapo të zgjidhni Krishtin, ju duhet të zgjidhni edhe njerëzit e tij. Kjo është paketë e pandashme. Zgjidhni Atin dhe Birin, dhe ju duhet të zgjidhni edhe gjithë familjen — gjë që e bëni *përmes* një kishe vendore.

Po ashtu, një kishë e ushtron autoritetin e saj të dhënë prej Krishtit shumë ndryshe nga shteti. Jezusi tha: "...Ju e dini se të parët e kombeve i sundojnë ato dhe të mëdhenjtë përdorin pushtet mbi ato..." (Mateu 20:25). Në fjalinë tjetër, ai thotë se autoriteti i krishterë funksionon duke e dhënë jetën tonë për hir të të tjerëve, sikurse bëri ai për ne (vargjet 26-28). Autoriteti i krishterë funksionon edhe përmes fuqisë së butë, të efektshme dhe zemërndryshuese të Fjalës dhe Frymës, dhe jo përmes fuqive manipuluese të bindjes dhe të shtrëngimit.

Megjithatë, Jezusi dëshiron që të krishterët ta japin veten me dëshirë — të nënshtrohen — ndaj një kishe vendore. Mënyrën se si duket dhe nuk duket kjo, ne do ta shqyrtojmë në kapitullin e gjashtë.

PSE KISHAT PËRBËJNË NJË RREZIK KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR

Kam përshtypjen se shumë të krishterë nuk e kuptojnë se për çfarë bën fjalë anëtarësia dhe pse është kaq e rëndësishme. Por kjo ndodh për shkak se i jemi qasur kësaj teme krejtësisht gabim.

Megjithatë, unë mund t'ju drejtoj te dy grupe që e kuptojnë shumë mirë rëndësinë e kësaj teme. Së pari, mendoni

për të gjitha qeveritë që i kanë përndjekur kishat dhe anëtarët e tyre. Këto qeveri e kanë pasur gabim që i kanë parë kishat si një kërcënim për pushtetin e tyre institucional — Jezusi nuk u dha kishave pushtetin e shpatës. Mirëpo qeveri të tilla kanë pasur plotësisht të drejtë në bindjen që anëtarët e kishave nuk do t'ua japin atyre besnikërinë supreme. Këtë besnikëri ata ia japin Jezusit.

Dëgjoni se si Eusebi, historiani romak i shekullit të katërt, e përshkroi një të krishterë të hershëm të quajtur Sanctus, kur ai ishte përpara torturuesve të tij në vitin 177 pas Krishtit: “Ai qëndroi i palëkundur përpara sulmeve të tyre, dhe nuk ua tregoi emrin, racën, vendin e lindjes dhe nëse ishte skllav apo i lirë. Secilës pyetje ai iu përgjigj në latinisht me fjalët: ‘Unë jam i krishterë.’ Këtë gjë shpalli ai vazhdimisht, në vend të emrit, vendit të lindjes, kombësisë dhe gjërave të tjera, dhe paganët nuk dëgjuan asnjë fjalë tjetër prej tij.”²

Grupi i dytë që e kupton rëndësinë e kësaj teme përbëhet nga të gjithë të krishterët si Sanctus-i, të cilët kanë jetuar nën përndjekje, sidomos nën përndjekjen e mbështetur nga qeveria. Këta vëllezër dhe motra kanë rrezikuar jetën e tyre duke u pagëzuar në një kishë. Mos flisni me ta për “anëtarësinë vullnetare”, a thua se kisha është një klub *bowling*-u. Ata e njohin mirë çmimin e aleancës së tyre të re. Ja pse vras mendjen nëse ky libër do të ketë më tepër kuptim për ta sesa për perëndimorë si puna ime. “Lum ata që përndiqen për shkak të drejtësisë, sepse e tyre është mbretëria e qiejve” (Mateu 5:10).

Imagjinoni, nëse mundeni, një glob me të gjitha kombet e botës të shënuara mbi të. Tani imagjinoni një ambasadë të vogël të dritës. Kjo është një mbledhje të krishterësh, të cilët

ANËTARËSIA E KISHËS

janë bashkuar në emër të Mbretit të tyre, Jezusit. Pastaj, ajo pikë e dritës ndahet dhe bëhet dy, pastaj katër, pastaj tetë, dhe kështu vazhdon. Një komb i ri po rritet, një komb i vendosur brenda kombeve të tjera. Ky komb i ri i lë kufijtë mbi hartë, aty ku gjenden, por vetë nuk mund të kufizohet nga vijat e hartës. Kufijtë e hartës nuk kanë autoritet për t'i ndaluar ata qytetarë të një bote tjetër. Pikat e dritës i kalojnë të gjithë kufijtë, duke u përhapur kudo si puna e majasë në brumë ose si yjet që shfaqen njëri pas tjetrit në errësirën e qiellit të natës.

Këto janë kishat e Krishtit dhe anëtarët e tyre. Bota nuk ka njohur kurrë diçka të ngjashme me ta.

SHFAQJET E ANËTARËSISË SË KISHËS NË DHIATËN E RE

Nëse synimi ynë është të kuptojmë se çfarë është anëtarësia e kishës, mund të jetë e dobishme t'i hedhim një vështrim të shpejtë terrenit të Dhiatës së Re, thjesht për t'u siguruar që po shohim të njëjtën gjë. Kjo është si puna e blerjes së një cope tokë. Ti dëshiron të dish më shumë informacion se përshkrimi që jep agjenti i shitjeve. Ti dëshiron të shkosh atje dhe ta shohësh vetë.

Për ta bërë këtë, si mendoni nëse udhëtojmë pas në kohë në dekadat e para të ekzistencës së kishës, duke filluar në fillim të viteve 30 pas Krishtit?

Nëse supozojmë që makina jonë e kohës shfaqet diku mbi Atlantikun e Veriut, ne fluturojmë në jug dhe kalojmë mbi atë që romakët e quajtën Britani. Kur hedhim vështrimin poshtë, ne shohim Stonehenge-in dhe jemi dy mijë e pesëqind vjet më parë. Londra nuk do të shfaqet ende edhe për një tjetër dekadë, derisa të themelohet nga ushtarët romakë.

Kalojmë ngushticën e detit dhe pastaj fluturojmë mbi fushat

ANËTARËSIA E KISHËS

dhe pyjet e Galisë, një vend që u pushtua nga Jul Cezari në vitin 51 para Krishtit. Sot kjo zonë quhet Francë. Kalojmë Alpet e mbuluara nga bora dhe rrëshqasim poshtë mbi peizazhet italiane plot pluhur në ngjyrë kafe dhe, më në fund, shohim qytetin e madhërishtë, Romën vetë, atje ku mbretëron Cezar Tiberi.

Kur kthehemi në lindje, nxitojmë sipër detit Adriatik, pastaj ndjekim bregun përgjatë Mesdheut nëpër territoret e Maqedonisë, Trakës, Azisë, Likisë, Kilikisë dhe arrijmë në cep të Sirisë, të gjitha këto territore të pushtuara gjatë dy shekujve të kaluar nga batalionet e pangopura romake. Nuk do të kalojmë përtej lumit Eufrat, matanë të cilit gjendet Perandoria Parthiane dhe në kufi me të Perandoria Kushane. Përkundrazi, do të kthehemi nga jugu për të shkuar në Palestinë dhe në krahinën romake të Judesë. Judea u pushtua nga gjeneral Pompei nëntëdhjetë vjet më herët, në vitin 63 para Krishtit. Tani kjo krahinë qeveriset për llogari të Romës nga famëkeqi Ponc Pilati dhe nga mbreti judë Herod Antipa.

Pas pak anija prek tokën në qytetin e Jerusalemit dhe ne dalim dhe shkelim në tokën palestineze të plasarit nga dielli. Hedhim vështrimin përreth dhe shohim shtëpi me tulla dhe baltë, disa pallate dhe, diku në largësi, vetë Malin e Tempullit.

Qëllimi i udhëtimit tonë është i thjeshtë: duam të hedhim një vështrim mbi kishat më të hershme dhe anëtarët e tyre. A ekzistojnë kishat vendore? A e praktikojnë atë që ne njerëzit modernë e quajmë anëtarësia e kishës?

KISHA NË JERUSALEM

Shohim përreth dhe dallojmë që jemi të rrethuar nga “judenj ... nga çdo komb nën qiell”: nga Parta, Mesopotamia, Kapadokia,

Azia, Egjipti, Libia, Roma, Kreta, Arabia... dhe lista vazhdon (Veprat e Apostujve 2:5, 9–11). Ata janë mbledhur bashkë për festën e përvitshme judaike të Rrëshajëve. Ngjyrat dhe aromat e shumta na bëjnë të mendojmë se gjendemi në një treg të hapur.

Megjithatë, gjëja e parë që na bën përshtypje nuk është një pamje, por një tingull, “një ushtimë, si ajo e një ere që fryn furishëm” (Veprat e Apostujve 2:2). Papritur kuptojmë se jemi bërë pjesë e një turme dhe po qëndrojmë përpara një grupi burrash, të cilët, në njëfarë mënyre, po predikojnë në gjuhët amtare të këtyre njerëzve. Turma ka mbetur pa frymë.

Njëri prej tyre, Pjetri, i sfidon hapur njerëzit. Ai u kujton mbretin e madh David, i cili e quajti Jezusin e sapokryqëzuar “Zoti im”. Pastaj, ai e mbyll me një deklaratë tronditëse: “...atë Jezus që ju e keni kryqëzuar, Perëndia e ka bërë Zot e Krisht” (Veprat e Apostujve 2:36).

E kthejmë vështrimin tonë nga dëgjuesit dhe presim që ata t’i sulen Pjetrit. Sigurisht që ata do ta shpallin tradhtar dhe do ta tërheqin zvarrë për ta çuar përpara autoriteteve.

Mirëpo nuk pati asnjë shpërthim. Në njëfarë mënyre, sfida funksionoi. Turmës iu “tejshpua zemra” dhe ata e pyetën Pjetrin se çfarë duhej të bënin (Veprat e Apostujve 2:37). Pa hezituar fare, Pjetri u përgjigj: “Pendohuni dhe secili nga ju le të pagëzohet në emër të Jezu Krishtit për faljen e mëkateve; dhe ju do të merrni dhuratën e Frymës së Shenjtë” (Veprat e Apostujve 2:38).

Kjo është një lëvizje e guximshme, përderisa ekzekutimi i Jezusit u shoqërua edhe me akuzat e tradhtisë. Mirëpo Pjetri nuk po përpiqet ta fshehë faktin që Jezusi është mbret,

ANËTARËSIA E KISHËS

madje këtë deklaratë ai e vendosi edhe në gojën e Davidit dhe atë të Perëndisë. Për më tepër, ai u tha njerëzve që të identifikoheshin me Jezusin nëpërmjet pagëzimit. Duket sikur ai dëshiron të themelojë një popull të dallueshëm — një lëvizje që mund të identifikohet publikisht.

Në mënyrë të habitshme, turma njerëzish reagojnë ndaj sfidës së tij: “Ata që e pranuan fjalën e tij me gëzim, u pagëzuan; atë ditë u shtuan rreth tri mijë shpirtra” (Veprat e Apostujve 2:41).

Duket sikur makinën tonë të udhëtimit në kohë e kemi ulur pikërisht në vendin e duhur. Këtu filloi e gjitha kjo. Teksa pyesim përreth, zbulojmë që, para se të arrinim ne, ata si grup ishin “rreth njëqind e njëzet” (Veprat e Apostujve 1:15). Pastaj, në këtë ditë të mahnitshme, shtohen edhe tre mijë emra të tjerë: Jakobi, Andrea, Lidia, Alfeu, Prohori, Xhimi, Skuteri, Alisa... Kisha po numëron anëtarët dhe po mban regjistra. Ata e dinë se kush janë.

RRITJA DHE PËRNDJEKJA

Me kalimin e ditëve, marrim me qira një tendë si zyrë dhe nisim të shkruajmë raportimet tona, teksa vazhdojmë ta shohim këtë grup të përqafojë një stil të ri jete. Ata i kushtohen mësimi të apostujve. Ata kanë përbashkësi, thyejnë bukën bashkë dhe luten bashkë. Ata e quajnë veten “besimtarë” dhe gjithçka e kanë të përbashkët, përfshirë këtu edhe zotërimet dhe të mirat, të cilat i ndajnë sipas nevojave të njerëzve (Veprat e Apostujve 2:44–45).

Ky grup po jeton në një nivel krejt tjetër nga pjesa tjetër e qytetit. Duket sikur ata janë nga një vend tjetër. E gjithë

bashkësia e tyre takohen bashkë “në tempull” dhe pastaj shpërndahen në grupe më të vogla “nga shtëpia në shtëpi” (Veprat e Apostujve 2:46). Grupi, gjithashtu, vazhdon të rritet: “...Dhe Zoti i shtonte kishës çdo ditë ata që ishin shpëtuar” (Veprat e Apostujve 2:47).

Tani kanë kaluar javë dhe muaj. Gjithnjë e më shumë njerëz shpallin se e besojnë mesazhin. Shumë shpejt, vetëm anëtarësia e burrave bëhet “rreth pesë mijë” (Veprat e Apostujve 4:4). Ne pyesim veten nëse ky grup është thjesht i interesuar për të shtuar numrat e vet. Mos ndoshta janë më të interesuar se duhet për numrat?

Përgjigjja që mund ta japim fare pa hezitim është e qartë: aspak. Në njëfarë mënyre, udhëheqësit janë të vetëdijshëm për shkarjet morale dhe veprojnë për t’i korrigjuar ato (Veprat e Apostujve 5:1-11). Në njëfarë mënyre, e gjithë “kisha” — siç e quajmë veten e tyre tani — vazhdon ende të mblidhet “në Portikun e Salomonit” (Veprat e Apostujve 5:11-12). Në njëfarë mënyre, e gjithë kisha dëshiron që anëtarët të takohen dhe të flasin bashkë për mënyrat se si t’u tregojnë më mirë dashuri vejushave (Veprat e Apostujve 6:1-2).

Nuk ka pikë dyshimi: këta njerëz kalojnë kohë bashkë dhe kujdesen për njëri-tjetrin. Jeta e tyre së bashku është aq e jashtëzakonshme, saqë, duke vëzhguar popullsinë e Jerusalemit, zbulojmë se “populli i lartësonte” (Veprat e Apostujve 5:13).

Sigurisht, ata nuk pëlqeshin nga të gjithë. Apostujt merren dy herë në pyetje. Pjetri thotë dy herë diçka të ngjashme: “Duhet t’i bindemi Perëndisë më shumë sesa njerëzve” (Veprat e Apostujve 4:20; 5:29). Ky grup e di që autoritetin final e ka Jezusi dhe askush tjetër. Ata “nuk pushonin duke mësuar dhe

ANËTARËSIA E KISHËS

duke shpallur lajmin e mirë: që Jezusi është Krishti” (Veprat e Apostujve 5:42).

Megjithatë, jeta bëhet shumë e vështirë për kishën. Përndjekja vazhdon ndërkohë që autoritetet vendore provokohen. Një nga udhëheqësit me emrin Stefan e vrasin me gurë. Madje duket sikur kryepiftërinjtë kanë gjetur një listë emrash dhe adresash, sepse një nga ithtarët e tyre më të zellshëm, një farise i quajtur Saul, filloi të “hynte shtëpi më shtëpi” dhe t’i tërhiqte zvarrë për t’i futur në burg anëtarët e kishës (Veprat e Apostujve 8:3).

Çuditërisht, puna e Saulit ka një efekt të paparashikuar. Shumë lajmëtarë vijnë në zyrën tonë dhe na sjellin të njëjtin lajm: “Ata, pra, që u shpërndanë shkonin rreth e përqark, duke shpallur fjalën” (Veprat e Apostujve 8:4). Përndjekja po i shpërndan të krishterët larg Jerusalemit, në qytete dhe vende të tjera.

Shumë shpejt dëgjojmë për dishepuj që shfaqen në Samari, Damask, Lida, Jopa dhe Cezare (Veprat e Apostujve 8:14; 9:10, 32, 42; 10:24). Të gjithë nisin të kuptojnë që Jezusi nuk erdhi thjesht si një mbret për judenjtë (Veprat e Apostujve 11:18).

Tani në Jerusalem kanë filluar të përhapen fjalë se vetë Sauli është kthyer në besim dhe ka nisur të predikojë në sinagoga që Jezusi “është Biri i Perëndisë” dhe “Krishti” (Veprat e Apostujve 9:20, 22). Shumë nuk e besojnë derisa vetë Sauli vjen dhe predikon “lirisht në emër të Zotit Jezus” (Veprat e Apostujve 9:27–28).

Për njëfarë kohe, gjërat duken se po ecin mirë. Kisha e Jerusalemit, e cila tani është shpërndarë “në mbarë Judenë, në Galile dhe në Samari”, duket se po shijon “paqe” (Veprat e Apostujve 9:31).

KISHAT NË SIRI, NË AZINË E VOGËL DHE MË TEJ

Ne vendosim që është e domosdoshme të bëjmë një takim për t'i shqyrtuar të dhënat. Njëri prej nesh sugjeron mundësinë që Perëndia i dërgoi *qëllimisht* të gjithë këta qytetarë ndërkom-bëtarë në Jerusalem për festën e Rrëshajëve, dhe pastaj *qëlli-misht* lejoi që të vinte përndjekja, në mënyrë që të kthyerit në besim të përhapeshin përtej kufijve ndërkombëtarë.

Dhe ja, në mes të takimit tonë vjen një prej miqve tanë nga kisha e Jerusalemit. Ai mezi po merr frymë dhe i duhet të përkulet, të mbështetet mbi gjunjë, por, duke vështuar lart dhe duke buzëqeshur, ai thotë se “lajmi për ta arriti në vesh të kishës në Jerusalem” dhe “një numër i madh besoi dhe u kthye te Zoti” nga përtej kufirit me Sirinë dhe në qytetin e Antiokisë (Veprat e Apostujve 11:19–22).

Shkojmë përpara një vit. Marrim një kopje të letrës me lajme nga kisha e Jerusalemit — “Fjalimi i apostujve” — dhe lexojmë që në Antioki “një numër i madh personash iu shtua Zotit” dhe “që plot një vit ata mblidheshin në kishë dhe mësuuan një numër të madh njerëzish” (Veprat e Apostujve 11:24, 26).

Duket qartë që ky nuk ishte thjesht një fenomen judaik.

Këta të krishterë sirianë janë besimtarë të vërtetë. Në Judé ra një zi buke, por dishepujt në Siri dërgojnë ushqime në jug. Në fakt, falë bujarisë së të krishterëve në Antioki, ne jemi ulur në shtëpinë e një anëtari të kishës dhe po shijojmë qengjin e pjekur në hell, të shoqëruar me sallatë me thjerrëza dhe fiq, me bukë të pjekur në prush, djathë dhe dollma me gjethe hardhie të mbushura me oriz. Nuk ka pikë dyshimi që dashuria e krishterë është shumë e shijshme. Këta të krishterë e

ANËTARËSIA E KISHËS

tregojnë vazhdimisht se kujdesen për njëri-tjetrin dhe se kujdesi i tyre i kalon kufijtë kombëtarë dhe arrin kisha përtej kishave të tyre.

Tani kanë kaluar disa dekada dhe po shohim se si po rritet hovi i mbjelljes së kishave. Sauli, i cili tani quhet Pal, nisët për një udhëtim gjatë të cilit mbjell kisha në Qipro dhe në Azinë e Vogël, duke përfshirë këtu edhe qytete si Derba, Listra, Ikoni dhe Antiokia e Pisidisë (Veprat e Apostujve 13:4; 14:20–23). Në një udhëtim të dytë, ai mbjell kisha më në perëndim, në qytetet e Filipisë, Thesalonikit, Bereas, Korintit dhe Efesit, nëse përmendim vetëm disa prej tyre (Veprat e Apostujve 15:36–18:22). Pastaj ai bën një udhëtim të tretë për t'i forcuar shumë nga këto kisha (Veprat e Apostujve 18:23–21:26).

Jo vetëm që na vijnë lajme gojarisht, por na vijnë edhe kopje të letrave të shkruara nga apostujt për kishat e ndryshme — letra për kishat në Galati, Thesaloniki, Korint, Romë dhe vende të tjera. Pali, madje, shkruan letra edhe kur është në arrest shtëpie: “...jam ambasador në pranga...” (Efesianëve 6:20). Ai i përdor lidhjet e tij me autoritetet e botës në dobi të Mbretit Jezus.

Në përgjithësi, reagimi nga autoritetet qeverisëse është shumë i ndryshëm. Herod Antipa i arreston dhe i vret anëtarët e kishës (Veprat e Apostujve 12:1–2). Prokonsulli romak i Qipros e beson mesazhin e tyre dhe bëhet i krishterë (Veprat e Apostujve 13:12), siç bën edhe kreu i sinagogës (Veprat e Apostujve 18:8). Qeveritari Feliks sheh mundësinë për të marrë ryshfet (Veprat e Apostujve 24:26). Qeveritari Fest i quan të krishterët “të çmendur” (Veprat e Apostujve 26:24). Mbreti Agripa provokohet (Veprat e Apostujve 26:28). Dhe një

prokonsull tjetër romak, Galioni, me pak fjalë thotë: “Bëni si të doni”, dhe i shpërfill gjërat sikur të ishte duke larguar një mizë që po e bezdiste (shih Veprat e Apostujve 18:17).

Duket sikur kishat dhe anëtarët e tyre kanë mbetur diku në cepat e shoqërisë — ata nuk janë pjesë e saj, nuk janë as mish e as peshk. Një ditë, na vjen në zyrë një kopje e letrës së dërguar nga Pjetri dhe thotë pikërisht këtë. Ai i quan të krishterët “diaspora” (1 e Pjetrit 1:1).

NJË TABLO E QARTË DHE E QËNDRUESHME

Vazhdojmë t’i lexojmë dhe t’i rilexojmë raportet tona. Mbajmë shënime. Përpiqemi të shohim nëse mund të krijojmë një tablo të plotë për faktin se çfarë janë kisha vendore dhe anëtarësia e saj. Ndërsa e bëjmë këtë gjë, në dokumentimet tona shfaqen dhjetë tema të padiskutueshme:

1) *Vetë ekzistenca e kishës përqendrohet te mesazhi për një Shpëtimtar dhe Zot.* Sikurse i dëgjuam atë ditë të parë në Jerusalemin, fjalët “për faljen e mëkateve” dhe “Jezusi është Zot” shfaqen herë pas here në shënimet tona. Apostujt e shpallin atë (2 e Korintasve 4:5; krahaso me Veprat e Apostujve 17:3; Gjoni 20:31). Ata e quajnë këtë udhë e shpëtimit dhe lajmi i mirë (Romakëve 10:9; 1 e Korintasve 15:1–5; Efesianëve 1:7; 1 e Pjetrit 1:3–12). Dhe Fryma e Shenjtë u jep njerëzve gjuhën për ta thënë këtë (1 e Korintasve 12:3). Këta të krishterë i respektojnë autoritetet laike dhe u nënshtrohen atyre deri në një pikë të caktuar, por besnikëria e tyre më e lartë është ndaj Jezusit. Ata e quajnë veten “ambasadorë në pranga” dhe rrezikojnë gjithçka, madje edhe vdekjen.

2) *Të krishterët zakonisht u bashkohen kishave të veçanta, por*

ANËTARËSIA E KISHËS

të ndërlidhura me njëra-tjetrën. Në fillim, çdo besimtar lidhej me kishën në Jerusalem ose “i shtohet” asaj. Pastaj vjen një fazë tranzicioni kur ka dishepuj të veçuar dhe të shpërndarë, si në rastin kur Filipi ia shpjegoi ungjillin eunukut etiopas. Por të gjitha këto kanë të bëjnë me vijën e misionit. Përveç këtyre, ne nuk gjejmë shembuj të krishterësh të veçuar nga kishat. Shumë shpejt u themeluan kisha në Antioki, Ikon, Korint, e më tej. Këto kisha vazhduan të komunikonin, të identifikoheshin me njëra-tjetrën dhe t'i shërbenin njëra-tjetrës në kohë nevojë, madje edhe përtej kufijve kombëtarë.

3) *Të krishterët e identifikojnë veten kolektivisht si kisha.* Ne mund ta dëgjojmë këtë në mënyrën se si ata flisnin për veten e tyre: “Por Sauli po shkatërronte kishën...” (Veprat e Apostujve 8:3). “Lajmi për ta arriti në vesh të kishës...” (Veprat e Apostujve 11:22). “...ata [Barnaba dhe Sauli] mblidheshin në kishë...” (Veprat e Apostujve 11:26). “...mbreti Herod vuri duart që të keqtrajtojë disa nga kisha” (Veprat e Apostujve 12:1). “...nga ana e kishës bënë lutje të vazhdueshme...” (Veprat e Apostujve 12:5). “...mblodhën kishën...” (Veprat e Apostujve 14:27). “...si u përcollën nga kisha...” (Veprat e Apostujve 15:3). “...u pritën nga kisha...” (Veprat e Apostujve 15:4). Të krishterët e përdorin fjalën *kishë* për t'u identifikuar në jetën e tyre së bashku. Individët i përkasin diçkaje më të madhe dhe të përbashkët.

4) *Të krishterët zotërojnë një fuqi të veçantë dhe identitet të përbashkët kur mblidhen zyrtarisht.* Pali i shkruan kishës në Korint dhe u thotë: “...mblidheni... me fuqinë e Zotit tonë Jezu Krisht” (1 e Korintasve 5:4). Më vonë, në po këtë letër, ai u referohet rasteve kur ata “[mblidhen] në kishë”

(1 e Korintasve 11:18), a thua se ata janë më shumë “një kishë” kur janë bashkë, sesa kur janë veç e veç. Duket sikur kjo asamble e mbledhur ka pushtet për të bërë gjëra, për të marrë vendime dhe për të dhënë deklarata nga ana e Jezusit.

5) *Hapi i parë i jetës së krishterë është pagëzimi — gjithmonë.* Kjo është shumë e qartë për këta besimtarë. “Pendohuni dhe secili nga ju le të pagëzohet...” (Veprat e Apostujve 2:38). “Dhe ata që e pranuan fjalën e tij me gëzim, u pagëzuan...” (Veprat e Apostujve 2:41). “Por, kur i besuan Filipit, që shpalli lajmin e mirë të mbretërisë së Perëndisë dhe emrin e Jezu Krishtit, u pagëzuan burra dhe gra” (Veprat e Apostujve 8:12). “Dhe menjëherë [Saulit] i ranë si luspa nga sytë... dhe si u ngrit, u pagëzua” (Veprat e Apostujve 9:18). “...Dhe ai dhe të gjithë të tijtë u pagëzuan menjëherë” (Veprat e Apostujve 16:33). “...dhe shumë nga korintasit, duke dëgjuar Palin, besuan dhe u pagëzuan” (Veprat e Apostujve 18:8). “Dhe tani ç’pret? Çohu dhe pagëzohu dhe lahu nga mëkatet e tua, duke thirrur emrin e Zotit” (Veprat e Apostujve 22:16). Nuk është aspak e habitshme që, kur Pali i shkruan kishës në Romë, thjesht supozon që të gjithë lexuesit e letrës së tij janë pagëzuar (Romakëve 6:3). Kjo shenjë publike e identitetit nuk vihet aspak në dyshim.

6) *Të krishterët janë urdhëruar që të veçohen nga bota dhe të mos shoqërohen zyrtarisht me të.* Pali nuk i ndalon marrëdhëniet me jobesimtarët (shih 1 e Korintasve 5:9-10), por u thotë të krishterëve të mos bëjnë asgjë që mund të përbëjë rrezik, që ata ta fshehin identitetin e tyre të krishterë para jobesimtarëve. Ai u thotë: “Mos hyni në një zgjedhë bashkë me jobesimtarët...”, përderisa drita dhe errësira nuk kanë bashkësi me

ANËTARËSIA E KISHËS

njëra-tjetrën (2 e Korintasve 6:14). Ashtu sikurse Perëndia dëshironte që të kishte një vijë të qartë ndarëse mes Izraelit dhe kombeve të tjera, po kështu Ai dëshiron që të ketë një vijë të qartë dhe të dukshme ndarëse mes kishës dhe botës: "...dilni nga mesi i tyre dhe ndahuni prej tyre, thotë Zoti, dhe mos prekni asgjë të papastër, dhe unë do t'ju pranoj" (2 e Korintasve 6:17). Ky kufi ndarës është shumë i qartë.

7) *Jeta dhe autoriteti i kishës vendore i formon dhe i orienton jetët e anëtarëve të saj.* Kjo ishte veçanërisht e qartë gjatë javëve dhe muajve tanë të parë në Jerusalem. Jeta e krishterë nisi me skemën e autoritetit: individët pagëzoheshin, i shtoheshin kishës dhe pastaj mbledheshin për të dëgjuar mësimin e apostujve. Duke u nisur nga kjo, besimtarët e orientonin jetën e tyre rreth anëtarëve të tjerë të kishës: vaktet e tyre, lutjet e tyre, oraret e tyre, vendimet e tyre financiare dhe për pasurinë, dhe ndihmën për vejushat. A ishte ky model unik për ata muaj të parë? Bujaria e kishës në Antioki ndaj kishës në Jerusalem na sugjeron diçka tjetër, sikurse edhe episode të tjera të cilat nuk i përmendëm, si rasti i bujarisë së Lidias ndaj misionarëve në udhëtim. Përkundrazi, ajo që dëshmuam ata muaj të parë na dha një tablo të hollësishme, e cila nuk kishte pse të përsëritej sërish në regjistrimet që u bënë gjatë viteve në vazhdim. Edhe letrat që morëm, na japin copëza të së njëjtës jete komunitare (për shembull: Romakëve 12:4–16; 1 e Korintasve 5:11; Galatasve 2:11–12; 1 e Timoteut 5:9–10; Hebrejve 10:34; 1 e Pjetrit 4:8–11).

8) *Udhëheqësit e krishterë janë përgjegjës për një grup të caktuar deleth.* Pjetri u thotë pleqve: "...ruani tufën e Perëndisë midis jush..." (1 e Pjetrit 5:2). Pali u thotë të njëjtën gjë pleqve të

Efesit: “Kini kujdes, pra, për veten tuaj dhe për gjithë tufën, në të cilën Fryma e Shenjtë ju ka vënë juve mbikëqyrës...” (Veprat e Apostujve 20:28). Pleqtë e dinë se për kë janë përgjegjës.

9) *Të krishterët janë përgjegjës për t’iu nënshtruar udhëheqësve të caktuar.* Autori i Hebrenjve shkruan: “Dëgjoni udhëheqësit tuaj dhe bindjuni...” (Hebrenjve 13:17). Është e qartë që besimtarët duhet ta dinë se cilët janë udhëheqësit e tyre. Pali shkruan: “Pleqtë që qeverisin mirë, le të nderohen dyfish...” (1 e Timoteut 5:17). Të krishterët e dinë se kë të nderojnë.

10) *Të krishterët i përjashtojnë nga bashkësia ata që bëjnë një rrëfim të gënjeshtërt të besimit.* Në një nga letrat e tij, Pali i thotë kishës në Korint: “...nxirreni të ligun nga vetja juaj” (1 e Korintasve 5:13). Duket qartë që nuk mund ta nxirrni dikë nga kisha nëse, më së pari, ai nuk i përket kishës. Në një vend tjetër, Pali thotë se një person sektar duhet paralajmëruar dy herë dhe pastaj “refuzojë” (Titit 3:10). Dhe Gjoni flet për mësuesit e rremë, për të cilët thotë: “Prej nesh dolën, por nuk ishin prej nesh...” (1 e Gjonit 2:19).

KISHA ËSHTË VETË ANËTARËSIA E SAJ

Nëse i mbledhim bashkë të gjitha këto, një gjë bëhet e qartë për komitetin tonë të hulumtimit në Jerusalem: të jesh i krishterë, do të thotë t’i përkasësh një kishe. Askush nuk shpëtohet dhe pastaj të endet kuturu i vetmuar, duke vrarë mendjen nëse do që t’i bashkohet një kishe apo jo. Njerëzit pendohen dhe pagëzohen në bashkësinë e një kishe. Ta shohësh Krishtin si Zot, do të thotë të jesh i bashkuar me popullin e Tij. Kjo është diçka automatike, ashtu sikurse në rastin e birësimit ndodh që shumë shpejt të uleni në një tryezë me vëllezër dhe motra.

ANËTARËSIA E KISHËS

Ideja e anëtarësisë së kishës shfaqet në gjithçka që lexojmë dhe dëgjojmë. Në asnjë nga raportimet tona nuk gjetëm një mësues të shkollës të së dielës, i cili qëndron para një klase dhe u kërkon pjesëmarrësve që ta hapin manualin te pjesa 2C, për të lexuar një përkufizim për “anëtarësinë e kishës”. Mirëpo të gjithë — të brendshëm e të jashtëm — e dinë se për kë bëhet fjalë kur të krishterët flasin për “kishën” që bën *këtë* apo *atë*: “...ata [Barnaba dhe Sauli] mblihdeshin në kishë...” (Veprat e Apostujve 11:26). “...mbreti Herod vuri duart që të keqtrajtojë disa nga kisha” (Veprat e Apostujve 12:1). “...si mbërritën, mblodhën kishën...” (Veprat e Apostujve 14:27). Të jesh anëtar kishë, do të thotë të jesh një nga individët që përbëjnë një kishë. Sërish, ata e dinë se kush janë.

Në fakt, ju thjesht nuk mund të flisni dot për një kishë vendore pa folur për anëtarët e saj. Është sikur të përpiqeni të flisni për një ekip, një familje, një komb ose, po, edhe një klub, pa folur për anëtarët e tyre. Secila prej këtyre *është* vetë anëtarësia e tyre.

KTHEHEMI SËRISH TEK E ARDHMJA

Duket sikur e gjetëm atë për të cilën erdhëm. Kanë kaluar disa dekada, por është e qartë që kishat vendore ekzistonin që nga fillimi i krishterimit, dhe ato kisha përbëhen vetëm nga anëtarët e tyre, as më shumë dhe as më pak se kaq. Pra, po, ato e praktikuan “anëtarësinë e kishës”, edhe nëse askush nuk ua kishte përmendur klasat ose librat e anëtarësisë.

Megjithatë, ne ende nuk u jemi përgjigjur të gjitha pyetjeve tona, dhe e para prej tyre ishte: çfarë *është* një kishë vendore? Lajmi i fundit që morëm nga Pali në Romë ishte që ai

po predikonte “mbretërinë e Perëndisë” (Veprat e Apostujve 28:31). Duket qartë që kjo nuk është një klub. Njerëzit nuk i ngatërrojnë klubet e tyre me një mbretëri. Ata nuk e quajnë veten ambasadorë të lidhur me zinxhirë për një organizatë vullnetare. Sigurisht që ata nuk i rrezikojnë jetët e tyre për një ofrues shërbimesh.

Prandaj, çfarë është saktësisht një kishë vendore? Për më tepër, çfarë është një anëtar kishë?

Tani mund t’i hipim sërish makinës sonë të udhëtimit në kohë dhe të kthehemi në të tashmen për t’iu përgjigjur këtyre dy pyetjeve. Mos u shqetësoni, nuk do të udhëtojmë më pas në kohë.

Gjatë udhëtimit tonë të kthimit, njëri nga ne nxjerr një Bibël xhepi dhe e hap atë te Libri i Zbulesës. Kjo është një letër nga Gjoni drejtuar shtatë kishave të ndryshme në Azinë e Vogël, të cilat po përleshën me tundimin dhe përndjekjen. Aty nga fundi gjejmë një përshkrim të Bishës, e cila tingëllon shumë si Cezari dhe si pretendimet e tij se është hyjnor dhe se ka *imperium*. Si i inkurajon Gjoni këto kisha? Ai u tregon atyre një tablo të Krishtit të ulur mbi fronin e tij dhe qeniet qiellore që i hedhin kurorat e tyre përpara tij. Cezari është mashtrues. Vetëm sundimi i Krishtit është absolut. Kjo është pikërisht ajo që kanë nevojë të dëgjojnë kishat, për të mbijetuar si kisha.

Jezusi është Zot.

ÇFARË ËSHTË NJË KISHË? ÇFARË ËSHTË NJË ANËTAR KISHE?

Nga Jerusalemi i shekullit të parë kthehem i në trotuarin jashtë një kafeneje italiane në Washington, DC. Ky është një ndryshim i këndshëm skenash. Unë dhe shoku im Coyle sapo kishim ngrënë drekë dhe po flisnim për anëtarësinë e kishës. Pastaj Coyle-i më bëri këtë pyetje të vështirë: “Cili është ndryshimi mes dy të krishterëve që i përkasin së njëjtës kishë dhe dy të krishterëve që u përkasin dy kishave të ndryshme?”.

Ndoshta mund të më imagjinoni duke qëndruar aty, me disa njolla të reja salce domateje në këmishën time, duke e parë atë si i përhumbur. Nuk isha i sigurt se si t'i përgjigjesha.

Megjithatë, kjo është një pyetje shumë e mirë për të arritur në thelb të çështjes se çfarë është një kishë vendore dhe anëtarësia e saj. Mendojeni kështu: Coyle-i i përket kishës sime. Shoku im i ngushtë, Mike-u, i cili është besimtar i krishterë gjithashtu, i përket një kishe që gjendet në rrethinat e qytetit, afër aeroportit. Prandaj, pyetja është kjo: ku ndryshon

ANËTARËSIA E KISHËS

marrëdhënia ime me Coyle-in nga ajo me Mike-un? A kam detyrime të ndryshme ndaj këtyre dy burrave?

Ju mund të thoni që të tre ne i përkasim trupit të Krishtit, popullit të Perëndisë dhe kishës universale, asaj që njihet si “Kisha” me *K* të madhe. Për më tepër, që të tre ne jemi thirrur për ta dashur njeri-tjetrin, për t’u lutur për njëri-tjetrin, për ta inkurajuar njëri-tjetrin, për ta qortuar mëkatin te njëri-tjetri dhe, madje, për t’u kujdesur për njëri-tjetrin nga ana financiare sipas nevojës.

Prandaj, ku qëndron ndryshimi? Çfarë duhej t’i kisha thënë shokut tim Coyle? Nëse *nuk* ka dallim, atëherë do të na duhet të themi se kisha vendore *nuk ekziston*. Do të ishte sikur të thoshim se nuk ka dallim mes marrëdhënies sime me bashkëshorten time dhe marrëdhënies sime me çdo grua tjetër. Kjo do të ishte e vërtetë vetëm nëse *nuk do të ekzistonte* besëlidhja e martesës. Mirëpo martesa ekziston, prandaj ka një dallim të madh mes këtyre marrëdhënieve. Po kështu edhe kisha vendore ekziston dhe duket se duhet të ketë disa dallime në ato marrëdhënie. Megjithatë, cili është dallimi?

Ja një ide për t’ju ndihmuar: unë dhe kisha ime kemi mundësi për të ushtruar disiplinë zyrtare mbi Coyle-in, por jo mbi Mike-un. Domethënë, Jezusi më ka dhënë mua, si një anëtar i kishës, një rol zyrtar gjykues për ta luajtur në jetën e krishterë të Coyle-it, rol të cilin nuk ma ka dhënë për ta luajtur në jetën e Mike-ut. Por të kuptuarit se çfarë është ky rol gjykues, kërkon që të pyesim se çfarë është kisha vendore dhe anëtarët e saj. Ky është synimi i këtij kapitulli dhe i atij në vazhdim. Këta, në fakt, mund të jenë dy kapitujt më të rëndësishëm të këtij libri.

INSTITUCIONALE DHE ORGANIKE

Ka të paktën dy mënyra se si mund t'i përgjigjemi pyetjes se çfarë është një kishë vendore: mund t'i përgjigjemi asaj në mënyrë organike ose institucionale. Mund të shohim mishin ose kockat.

Në kohët tona, njerëzve u pëlqen të flasin në mënyrë organike. Mishi është i butë, i epshëm dhe i bukur. Mirëpo mishi pa kockat nuk duket shumë i bukur. Prandaj, në të vërtetë, na duhen të dyja.

Për ta kuptuar dallimin, mendoni edhe një herë në lidhje me analogjinë e martesës. Nëse do të flisnim për martesën në kuptimin organik, ne do të flisnim për të gjitha gjërat e mrekullueshme që ka mundësi të bëjë një çift i martuar: të jetojnë bashkë, të krijojnë familje, të përjetojnë intimitet martesor, të lindin fëmijë, t'i besojnë të fshehtat njëri-tjetrit, e kështu me radhë. Këto janë veprimtaritë e mrekullueshme që ne i lidhim me marrëdhënien martesore.

Megjithatë, nëse flet për martesën nga ana institucionale, do të thotë të flasësh për gjëra që kultura jonë i kupton gjithnjë e më pak dhe madje ka nisur t'i braktisë:

- “Jemi mbledhur përpara Perëndisë dhe këtyre dëshmitarëve për të bashkuar këtë burrë dhe këtë grua.”
- “Nëse dikush ka një arsye të drejtë se pse këta të dy nuk mund të bashkohen ligjërisht...”
- “Me këtë unazë, unë martohem me ty.”
- “Tani shpall se ata janë burrë dhe grua.”

Pas gjithë këtyre frazave perëndimore qëndron ideja e asaj që Bibla e quan bashkimi në një mish të vetëm dhe që ne mund

ANËTARËSIA E KISHËS

ta quajmë besëlidhja e martesës. Kjo besëlidhje shërben si skeleti. Kjo është struktura e qartë që krijon bazën e marrëdhënies dhe e dallon marrëdhënien e një burri me bashkëshorten e tij nga marrëdhëniet e tij me të gjitha gratë e tjera, dhe po kështu edhe për gruan. Kjo është kupa prej metali në të cilën mbahet vera e jetës martesore. Nëse e humbisni kupën, shumë shpejt do të humbisni edhe verën (shih Fjalët e Urta 5:15-16).

Botës së sotme i pëlqejnë veprimtaritë e martesës, por jo institucioni i saj, dhe kjo është arsyeja pse një numër gjithnjë e më i madh çiftesh jetojnë bashkë pa u martuar. Ata e duan verën, por jo kupën e verës. Nuk është për t'u habitur që gjithçka është bërë lëmshe.

Sërish, shumë njerëz zgjedhin veprimtarinë, por jo institucionin, sepse i kanë parë prindërit ose gjyshërit e tyre që u martuan dhe ishin aq të mjeruar. Shpjegimi ishte “këto janë rregullat”. Ata nuk i panë etërit e tyre t'i trajtonin me butësi nënat e tyre dhe as nënat që t'i vlerësonin baballarët e tyre. Ata panë vetëm vështirime të përhumbura dhe se si ata shkëmbejnë informacione pa ndjenjë. Ata panë jetë, jetë vërtet të gjallë, vetëm gjatë përleshjeve me të bërtitura. Sa ironike dhe tragjike njëkohësisht! Këtë nuk e dëshirojmë as ne.

Mirëpo si rregullat, ashtu edhe veprimtaritë, janë caktuar nga Perëndia: ato janë kockat dhe mishi.

Kështu është edhe me kishën vendore.

JEZUSI DHE MBRETËRIA

Le të fillojmë me përshkrimin institucional — me kockat, me kupën e verës. Dhe kjo është ajo që njerëzit sot më së shpeshti nuk e kapin apo e shmangin. Bashkimi i marrëdhënieve që e

kthen një grup të zakonshëm të krishterësh — shumë shpejt! — në një kishë vendore, nuk është një bashkim i llojit “derisa vdekja të na ndajë”. Mirëpo është *diçka*, sikurse bëhet e qartë edhe nga mundësia për disiplinën e kishës.

Në kapitullin e parë, ne e quajtmë kishën vendore një pararojë ose një ambasadë. Për ta shtjelluar më tej, ja se cili është përkufizimi im institucional me një fjali për kishën vendore: *një kishë vendore është një grup të krishterësh të cilët mbledhen rregullisht në emrin e Krishtit, për ta afirmuar dhe për ta mbikëqyrur zyrtarisht anëtarësinë e njëri-tjetrit në Jezu Krishtin dhe në mbretërinë e tij, përmes predikimit dhe sakramenteve të ungjillit.*

Po, ky përkufizim është pak i ngatërruar, por çdo fjalë është e ngarkuar me qëllim.

Përpara se ta shtjelloj më tej, dëshiroj që të shihni se ku e kam gjetur. Mund ta keni vënë re se, në kapitullin e dytë, gjatë kërkimit të shfaqjeve të anëtarësisë në faqet e Dhiatës së Re nuk folëm për Jezusin dhe Ungjijtë. Pse? Pjesërisht, për shkak se Jezusi foli shumë më tepër për mbretërinë sesa për kishën. Letrat, nga ana tjetër, kanë theksimin e kundërt. Këtë kapeni mirë:

- Tek Ungjijtë, Jezusi e përmend “kishën” dy herë dhe “mbretërinë” dyzet e nëntë herë vetëm tek Ungjilli sipas Mateut.
- Te Letrat e Palit, “kisha” përmendet dyzet e tri herë dhe “mbretëria” katërmëdhjetë herë.

Jezusi foli për mbretërinë. Pali foli për kishën.

Çfarë po ndodh? Kjo mund t’ju habitë, por theksimi i mbretërisë nga ana e Jezusit është ajo që e themelon kishën

ANËTARËSIA E KISHËS

si një institucion. Pali shkroi më shumë në lidhje me kishën organike, gjë që do ta trajtojmë në kapitullin tjetër.

Ç'lidhje ka mbretëria e Jezusit me kishën?

NA ISHTE NJË HERË NJË MBRETËRI. . .

Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, le t'i kthehemi një historie. Na ishte një herë një mbretëri e quajtur Izrael. Si gjithë mbretëritë e tjera, Izraeli kishte një mbret, një tokë dhe një sërë ligjesh. Por ndryshe nga shumica e mbretërive, qytetarët e Izraelit kishin për të bërë një punë shumë të veçantë: *Izraeli duhej të përfaqësonte Perëndinë mbi tokë.*

Duket sikur Perëndia u dërgoi një njoftim për shtyp të gjitha kombeve të dheut, duke u shpjeguar se Izraeli ishte kombi i tij dhe se kombet duhej të shihnin ata për të zbuluar se si ishte Perëndia. A ishte Perëndia i mëshirshëm apo i pamëshirshëm, i drejtë apo i padrejtë? “Shikoni këtë komb dhe do ta zbuloni”, thoshte njoftimi për shtyp. Perëndia u kishte dhënë atyre një sërë ligjesh të hollësishme, që ata ta dinin me saktësi se çfarë të bënin.

Fatkeqësisht, Izraeli dështoi për turp e për faqe të zezë në punën e tij. Ata u sollën si adoleshentë të pasigurt, të cilët e vrisnin mendjen tepër fort për opinionet e moshatarëve të tyre, dhe kështu imituan kombet në vend që të imitonin Perëndinë. Ndoshta mendonin se ishin tepër të rëndësishëm për t'u marrë me ligjin e Perëndisë. Kjo i bëri kombet që, në fund të fundit, të mendonin se Perëndia nuk ishte kush e di se çfarë. Në fakt, ai duhet t'u ngjajë shumë atyre.

Pastaj, një ditë erdhi një burrë i quajtur Jezus, i cili tha të paktën katër gjëra që i rrëzojnë mbretëritë.

- 1) Perëndia po e pushonte Izraelin nga puna. Ata po e humbisnin punën e tyre si përfaqësues të Perëndinë (Mateu 3:9–12; 8:11–12).
- 2) Tani ishte Jezusi ai që do ta përfaqësonte Atin qiellor (Mateu 3:17; 11:27; Gjoni 14:9). Ai, në fakt, ishte Perëndi dhe shëmbëllimi i përsosur i Perëndisë (Kolosianëve 1:15).
- 3) Perëndia po themelonte një mbretëri, jo një vend si Izraeli, por si mbretërimin e tij mbi një grup të caktuar njerëzish. Kjo mbretëri ishte për njerëz të penduar, skamës në frymë dhe të përlulur si fëmijët (Mateu 4:17; 5:3; 18:3).
- 4) Qytetarët e mbretërisë së tij, të cilët do t'i blejë me vdekjen e tij në kryq, do të bashkohen me të për ta përfaqësuar Perëndinë mbi tokë (Mateu 5:48; Romakëve 8:29; 1 e Korintasve 15:49; 2 e Korintasve 3:18; Kolosianëve 3:9–10).

Megjithatë, një mbretëri e tillë, pa tokë dhe pa kufij gjeografikë, u përball me një dilemë serioze politike: kushdo mund të thoshte se ishte qytetar i kësaj mbretërie. Jezusi parashikoi që do të kishte lloj-lloj mashtresish (Mateu 7:21–23; si dhe Mateu 24:5; 25:44–45).

Kjo, nga ana e vet, prodhoi një makth të vërtetë në marrëdhëniet publike: mashtres të tillë do të bënë që emri i mbretit të shahej. Mbani mend, kjo mbretëri duhej të ishte për ata që janë të penduar, skamës në frymë dhe të përlulur si fëmijët. Kjo duhej të ishte një lloj i ri shoqërie. Por nëse realisht *kushdo* — me vullnetin e vet — do të fillonte të thoshte se ishte një qytetar, do të krijohesh një rrëmujë e madhe. Harrojeni atë “shoqërinë e re”.

Qytetarët e administratës së mëparshme dalloheshin nga fakti që jetonin në një vend të caktuar. Madje, edhe kur largoheshin nga ai vend, ata kishin disa veçori si puna e rrethprerjes,

ANËTARËSIA E KISHËS

shabati dhe rregullat e ndryshme të dietës. Mirëpo si do të dallohen qytetarët e mbretërisë së Jezusit, e cila nuk ka tokë dhe as kufij? Kush do ta ruajë kufirin kur nuk ka kufij?

INTERVAL: SALLA E KONFERENCAVE PËR SHTYP NË SHTËPINË E BARDHË

Le të bëjmë një interval të shkurtër përpara se të vazhdojmë me këtë histori të mbretërisë së Jezusit. Mendoni pak se çfarë rrezikohet kur bëhet fjalë për bisedën e madhe në lidhje me anëtarësinë e kishës. Jemi duke folur për përfaqësimin e vetë Perëndisë në planetin Tokë. Kjo ishte puna e Izraelit, apo jo? Shkoni pothuajse në cilindo mjedis universitar sot, dhe do të dëgjoni që aty shpallet njëzëri: “Askush nuk mund të pretendojë se përfaqëson Perëndinë.” Mirëpo kjo është pikërisht ajo për të cilën po flasim.

A po filloni ta shihni se sa e rëndësishme është kjo temë? Jo? Më lejoni t’ju jap një shembull tjetër. Le të themi se u larguam nga ajo kafeneja italiane, shkuaam në Shtëpinë e Bardhë dhe u futëm në sallën e konferencave për shtyp. Dikur njihja dikë që njihte dikë tjetër, i cili më çoi në sallën e konferencave. Ai më bëri një fotografi teksa qëndroja pas podiumit dhe dukej qartë që ky nuk ishte vendi im.

Mund ta keni idenë se për cilin podium jam duke folur. Ai del shpesh nëpër lajme. Mbi të është vendosur sigla e presidentit. Pas tij qëndron një perde blu dhe një flamur amerikan, bashkë me një medaljon të varur që lexon “Shtëpia e Bardhë”. Ky ka të ngjarë të jetë podiumi më i pushtetshëm në botë.

Nga ai podium janë shpallur luftëra. Janë ndikuar tre-gjet. Ekonomi të tëra janë trajtuar si të parëndësishme. Janë

shpjeguar marrëveshje ndërkombëtare. Nga ai podium janë ndikuar miliona, madje miliarda jetë njerëzish.

Ja pyetja që kam për ju: a keni folur ndonjëherë për llogari të presidentit të SHBA-së nga ai podium? A i keni parë kamerat dhe dritat e studios së korrespondentëve të Shtëpisë së Bardhë dhe të keni paraqitur zyrtarisht mendimet e presidentit?

Supozoj që përgjigjja është “jo”. Presidenti duhet t’ju autorizojë zyrtarisht që të përcillni mendimet e tij. Madje as miqtë më të ngushtë dhe as anëtarët e familjes së tij nuk mund të dalin në skenën botërore dhe të marrin përsipër ta bëjnë këtë gjë. Bëhet fjalë për gjëra tepër të rëndësishme dhe jo çdokush mund ta bëjë këtë.

Dakord, ja një pyetje tjetër: a ke folur ndonjëherë për llogari të Jezusit dhe të mbretërisë së tij? A të ka autorizuar dikush që të përfaqësosh mendimet e këtij mbreti?

Përfaqësimi i Jezusit nuk është as ofiq pa pasoja. Në fakt, Jezusi, siç e pamë në kapitullin e parë, ka më shumë pushtet dhe autoritet se presidenti. Fjalët e tij nuk do të bien kurrë poshtë. Vendimet e tij do të ndikojnë gjithë përjetësinë. E thamë që Jezusi ka *imperium*.

Supozoj që shumë të krishterë nuk kanë ndaluar kurrë për të menduar nëse është e ligjshme për ta që të pretendojnë se flasin në emër të Jezusit. Që nga rënia e njeriut në mëkat, ne e kemi parë veten si njerëz që kemi të drejtë të bëjmë ç’të duam, dhe këtë ndjesi të drejte e kemi sjellë edhe në krishterimin tonë.

Në të vërtetë, qeniet njerëzore nuk e kanë të drejtën për të bërë *ndonjë gjë* pa autorizimin e Perëndisë. E njëjta gjë vlen edhe për mbretërinë e Jezusit: ne mund të veprojmë në

ANËTARËSIA E KISHËS

mënyrë të ligjshme vetëm aty ku ai na ka dhënë leje për të vepruar. Një qenie individuale njerëzore nuk mund të vendosë papritur që ai apo ajo i përket mbretërisë së Jezusit dhe që, për pasojë, ka të drejtë të dalë përpara planetit Tokë dhe të përfaqësojë Jezusin. Këtë gjë nuk do të mund ta bënit dot për presidentin. Pse vallë pretendoni që mund ta bëni për Mbretin e presidentëve?

Dakord, kaq ishte intervali. Çfarë kemi mësuar nga kjo? Të supozosh që ke autoritet për të përfaqësuar Mbretin Jezus, Birin hyjnor, është po aq mendjemadhësi sa edhe të supozosh që ke autoritet për të përfaqësuar presidentin e Shteteve të Bashkuara — në fakt, është edhe më tepër mendjemadhësi. Dikush duhet t’ju autorizojë për këtë gjë.

HISTORIA VAZHDON: ÇELËSAT E MBRETËRISË

Tani po i kthehemi historisë sonë për mbretërinë e Jezusit, e cila nuk ka tokë dhe as kufij. Kush e ka autoritetin për të shpallur publikisht se kush është një qytetar dhe kush jo? Si fillim, Pjetri dhe apostujt.

Një ditë, Jezusi i paralajmëroi dishepujt që të mos e besonin mësimin e udhëheqësve të Izraelit (Mateu 16:1–12). Mandati i tyre kishte përfunduar, dhe shumë shpejt do të largoheshin nga ndërtesat e qeverisë, duke i marrë sendet e tavolinave të tyre në kuti kartoni. Pastaj, ai i pyeti se kush mendonin ata se ishte ai. Pjetri, i cili ndoshta foli për llogari të të gjithë grupit, iu përgjigj: “Ti je Krishti, Biri i Perëndisë të gjallë” (v. 16). Jezusi e pohoi përgjigjen e Pjetrit, duke thënë se ajo kishte ardhur nga “Ati [i tij] që është në qiej”. Pastaj vazhdoi dhe tha:

Dhe unë po të them gjithashtu se ti je Pjetri, dhe mbi këtë shkëmb do të ndërtoj kishën time dhe dyert e ferrit nuk do ta mundin atë. Dhe unë do të të jap çelësat e mbretërisë së qiejve; ç'të kesh lidhur mbi tokë, do të jetë lidhur në qiej, dhe ç'të kesh zgjidhur mbi tokë, do të jetë zgjidhur në qiej. (Mateu 16:18–19)

Kjo është hera e parë nga të dyja herët që Jezusi e përdor fjalën *kishë*. Këtu ai është duke folur për kishën universale: asamblenë e të gjithë të krishterëve nga të gjitha epokat, e cila do të mbledhet në fund të historisë. Jezusi do ta ndërtojë këtë asamble të kohëve të fundit.

Si do ta ndërtojë ai? Ai do ta ndërtojë “mbi këtë shkëmb”. Mbi cilin shkëmb? Teologët kanë debatuar gjatë nëse shkëmbi është Pjetri ose nëse është rrëfimi i tij. Në fakt, mendoj se duhet të thoni të dy. Teologu Edmund Clowney shkruan: “Rrëfimi nuk mund të ndahet nga Pjetri dhe as Pjetri nuk mund të ndahet nga rrëfimi i tij.”¹ Jezusi do ta ndërtojë kishën e tij jo mbi fjalë dhe as mbi njerëz, por mbi njerëz që besojnë fjalët e duhura të ungjillit (si, për shembull, vetë Fjala që u bë mish). Jezusi do ta ndërtojë kishën mbi *rrëfyesit*.

Pastaj Jezusi i dha Pjetrit dhe apostujve çelësat e mbretërisë, gjë që i dha Pjetrit autoritetin për të bërë atë që Jezusi sapo e kishte bërë me të: të vepronte si përfaqësues zyrtar i Perëndisë mbi tokë, për të afirmuar rrëfimet dhe rrëfyesit e vërtetë të ungjillit.

Është e mahnitshme të mendojmë për ndërveprimet mes qiellit dhe tokës në këtë pasazh. Pjetri e rrëfeu saktë se kush ishte Jezusi dhe Jezusi tha se përgjigjja e Pjetrit erdhi nga Ati në *qiell*. Edhe pse Jezusi ishte *mbi tokë*, ai foli për llogari të

ANËTARËSIA E KISHËS

qiellit. Menjëherë pas kësaj, Jezusi e autorizoi Pjetrin të bënte të njëjtën gjë — të përfaqësonte atë që lidhet dhe zgjidhet *në qiell*, duke lidhur dhe duke zgjidhur *mbi tokë*!

Ndonjëherë studiuesit e Biblës flasin për “lidhjen dhe zgjidhjen” si për një veprimtari gjyqësore ose rabinike, gjë që na ndihmon për ta kuptuar këtë frazë. Për shembull, një rabin mund të vendosë nëse një ligj zbatohet ose e lidh një person të caktuar në disa rrethana të veçanta. Në thelb, Jezusi u dha apostujve këtë lloj autoriteti: autoritetin për të qëndruar përpara një rrëfyesi, për ta marrë parasysh rrëfimin e tij apo të saj, për ta parë jetën e tij apo të saj dhe për të dhënë një gjykim zyrtar për llogari të qiellit. A është ky rrëfimi i duhur? A është ky një rrëfyes i vërtetë? Me fjalë të tjera, *apostujt kishin autoritetin e qiellit, për të deklaruar se cili person mbi tokë është qytetar i mbretërisë dhe, si rrjedhim, e përfaqëson qiellin*.

Nuk po them që, te Mateu 16, Jezusi themeloi një “program për anëtarësinë e kishës”, por, në mënyrë të pamohueshme, ai themeloi kishën (e cila *përbëhet* nga anëtarët e saj), dhe ai i dha asaj autoritetin e çelësave për të vazhduar që ta ndërtojë veten — saktësisht, autoritetin për t’i pranuar dhe për t’i përjashtuar anëtarët. Autoriteti i çelësave është autoriteti për t’i vlerësuar fjalët dhe veprat e ungjillit të një personi dhe për të dhënë një gjykim.

Dy kapituj më pas, kur Jezusi e përdor fjalën *kishë* për herë të dytë, shohim që ata çelësa vihen në përdorim:

Por në qoftë se vëllai yt ka mëkatuar kundër teje, shko dhe qortoje vetëm për vetëm; në qoftë se të dëgjon, e fitove vëllanë tënd; por në qoftë se nuk të dëgjon, merr me vete edhe një ose dy vetë,

që çdo fjalë të vërtetohet nga goja e dy ose tre dëshmitarëve. Nëse pastaj refuzon t'i dëgjojë, thuaja kishës; dhe në qoftë se refuzon të dëgjojë edhe kishën, le të jetë për ty si pagan ose tagrambledhës. Në të vërtetë ju them se ç'të keni lidhur mbi tokë do të jetë lidhur edhe në qiell; dhe ç'të keni zgjidhur mbi tokë do të jenë zgjidhur edhe në qiell. Përsëri po ju them se, në qoftë se dy prej jush bien në ujdë mbi tokë të kërkojnë çfarëdo gjëje, kjo do t'u jepet atyre nga Ati im në qiej. Sepse, kudo që dy a tre janë bashkuar në emrin tim, unë jam në mes të tyre. (Mateu 18:15–20)

Pasazhi fillon me tablonë e një vëllai që mëkaton, dhe mëkati i tij nuk përputhet me rrëfimin e tij të besimit. Pastaj Jezusi rekomandon katër raunde ballafaqimi. Në raundin e parë, ballafaqimi bëhet privatisht. Nëse mëkatari pendohet, rrëfimi i tij i besimit e rifiton besueshmërinë e tij dhe ballafaqimi merr fund. Jeta e tij përputhet me rrëfimin e tij. Ai është sërish duke e përfaqësuar si duhet Jezusin.

Në raundin e dytë, ballafaqimi zgjerohet për të përfshirë dy ose tre dëshmitarë, siç ndodhte edhe në sfondin e gjyqeve në Dhiatën e Vjetër. Në raundin e tretë përfshihet e gjithë kisha ose asambleja e mbledhur bashkë. Nëse mëkatari nuk pendohet, kalohet në raundin e katërt, në të cilin personi largohet nga komuniteti i besëlidhjes — duke e trajtuar atë si një të jashtëm. Ndonjëherë kjo quhet *disiplina e kishës* ose *shkishërimi*.

Pastaj Jezusi u referohet sërish çelësave të mbretërisë: çfarëdo gjëje që kisha e lidh mbi tokë, do të jetë e lidhur edhe në qiell, dhe çfarëdo gjëje që kisha e zgjidh mbi tokë, do të jetë e zgjidhur edhe në qiell. Këtu Jezusi nuk po flet për apostujt apo për kishën universale. Ai ka në mendje një kishë vendore. Duket që kishës vendore i janë dhënë çelësat

ANËTARËSIA E KISHËS

apostolikë të mbretërisë. Si rezultat, *kisha vendore ka autoritetin e qiellit, për të deklaruar se cili person mbi tokë është qytetar i mbretërisë dhe, si rrjedhim, e përfaqëson qiellin.*

Jezusi e ka autorizuar kishën vendore për të qëndruar përpara një rrëfyesi, për ta marrë parasysh rrëfimin e tij, për ta parë jetën e tij apo të saj dhe për të dhënë një gjykim zyrtar për llogari të qiellit. A është ky rrëfimi i duhur? A është ky një rrëfyes i vërtetë? Njëlloj siç bëri Jezusi me Pjetrin. Kisha do t'i bëjë këto përmes sakramenteve të themeluara te Mateu 26 dhe 28 — Darka e Zotit dhe pagëzimi.

Mateu 18, i cili është i mbushur edhe më shumë me fjalë në lidhje me qiellin dhe tokën sesa Mateu 16, na paraqet një tablo shumë të qartë për këtë autoritet në kontekstin e disiplinës së kishës. Mirëpo aftësia për ta hequr dikë nga anëtarësia supozon një autoritet gjithëpërfshirës për të vlerësuar fjalët dhe veprat e ungjillit të një personi dhe për të dhënë një gjykim. Ky autoritet fillon që një çastin kur dikush vjen në kishë dhe, ashtu siç bëri Pjetri, thotë se Jezusi është Krishti.

Autoriteti përfaqësues i shtetit, siç thamë në kapitullin e parë, duket më qartë në aftësinë e tij për t'i dhënë fund jetës së një personi. Po kështu, autoriteti përfaqësues i kishës në mbretërinë e Krishtit duket më qartë në aftësinë e saj për ta hequr një person nga qytetaria në mbretërinë e Krishtit. Në të dyja rastet, masa e plotë e autoritetit institucional tregohet nga fuqia për t'i dhënë fund në mënyrë të prerë anëtarësisë së personit, përmes vdekjes në njërin rast dhe përmes shkishërimit në tjetrin.

Megjithatë, i njëjti autoritet ushtrohet “kudo që dy a tre janë bashkuar në emrin [e Jezusit]” (Mateu 18:20) dhe

e pagëzojnë dikë “në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë” (Mateu 28:19), kur e njohin personin si një dishepull të vërtetë, me të drejta e përgjegjësi të plota. Si e tillë, *kur bëhet fjalë për dishepullimin e një besimtar në Krishtin, kisha vendore është autoriteti më i lartë i Krishtit mbi tokë.*

Jo, kisha vendore nuk është një autoritet absolut, ashtu sikurse nuk është as shteti. Mirëpo Krishti dëshiron që të krishterët t’i nënshtrohen mbikëqyrjes së kishave vendore për shkak të qytetarisë së tyre në mbretërinë e tij.

A do t’i përdorë kisha vendore çelësat në mënyrë të përsosur? Jo. Ajo do të bëjë gabime, ashtu sikurse bën gabime edhe çdo autoritet tjetër i themeluar nga Jezusi. Si e tillë, kisha vendore do të jetë një përfaqësuese e papërsosur e asamblesë së Krishtit në kohët e fundit. Por fakti që ajo bën gabime, ashtu si presidentët dhe prindërit, nuk do të thotë që asaj nuk i është dhënë një mandat me autoritet.

A do të thotë e gjitha kjo se ajo që kisha vendore bën mbi tokë, në fakt, e ndryshon statusin e një personi në qiell? Jo, puna e kishës është si puna e një ambasadori apo ambasade. Mbani mend se çfarë ju thashë kur vizitova Ambasadën e SHBA-së në Bruksel, atëherë kur më skadoi pasaporta. Ambasada nuk më bëri qytetar; ajo e vërtetoi zyrtarisht qytetarinë time në një mënyrë që unë nuk mund ta bëja dot vetë — kështu është edhe me një kishë vendore.

ÇFARË ËSHTË NJË KISHË VENDORE?

Le të kthehemi te përkufizimi im institucional dhe me një fjali për kishën vendore. Ju thashë se një kishë vendore është një grup të krishterësh të cilët mblidhen rregullisht në emrin

ANËTARËSIA E KISHËS

e Krishtit, për ta afirmuar dhe për ta mbikëqyrur zyrtarisht anëtarësinë e njëri-tjetrit në Jezu Krishtin dhe në mbretërinë e tij, përmes predikimit dhe sakramenteve të ungjillit. Vini re pesë pjesët e këtij përkufizimi:

- një grup të krishterësh
- një mbledhje e rregullt
- një afirmim dhe mbikëqyrje nga e gjithë bashkësia
- qëllimi i përfaqësimit zyrtar të Krishtit dhe mbretërimit të tij mbi tokë — ata mblidhen në emrin e tij
- përdorimi i predikimit dhe sakramenteve për këto qëllime

Ashtu sikurse shpallja nga pastori i transformon një burrë dhe një grua në një çift të martuar, po kështu ato katër pikat e fundit e transformojnë një grup të zakonshëm të krishterësh që kalojnë kohë bashkë në park — menjëherë! — në një kishë vendore.

Mbledhja së bashku është e rëndësishme për disa arsye. Njëra prej tyre është se aty ne të krishterët “dalim publikisht” për të shpallur besnikërinë tonë më të madhe. Kisha vendore është pararoja ose ambasada që shërben si shfaqja publike për kombin tonë të ardhshëm. Këtu ne përkulemi përpara mbretit tonë, vetëm se këtë e quajmë adhurim. Faraonët e botës mund të na kundërshtojnë, por Perëndia i mbledh njerëzit e tij nga kombet për ta adhuruar atë. Ai do ta formojë bashkësinë e tij madhështore.

Mbledhja së bashku është gjithashtu vendi ku mbreti ynë e ushtron mbretërimin e tij përmes predikimit, sakramenteve dhe disiplinës. Predikimi i ungjillit shpjegon “ligjin” e kombit tonë. Ai deklaron emrin e mbretit tonë dhe shpjegon flijimin

që ai ofroi për t'u bërë mbreti ynë. Predikimi i ungjillit na mëson për udhët e tij dhe na ballafaqon me mosbindjen tonë. Ai, gjithashtu, na siguron për ardhjen e tij shumë të afërt.

Përmes pagëzimit dhe Darkës së Zotit, kisha mban lart flamurin dhe vesh uniformën e kombit tonë. Këto na bëjnë të dukshëm. Të pagëzohesh, do të thotë të identifikohesh me emrin e Atit, të Birit dhe të Frymës së Shenjtë, si dhe të identifikosh bashkimin tënd me Krishtin në vdekjen dhe ringjalljen e tij (Mateu 28:19; Romakëve 6:3–5). Marrja pjesë në Darkën e Zotit do të thotë që shpallim vdekjen e tij dhe anëtarësinë tonë në trupin e tij (1 e Korintasve 11:26–29; krahaso me Mateu 26:26–29). Perëndia dëshiron që populli i tij të njihet dhe të dallohet. Ai dëshiron një vijë dalluese mes kishës dhe botës.

Çfarë është kisha vendore? Ajo është institucioni që Jezusi e krijoi dhe e autorizoi për të shpallur ungjillin e mbretërisë, për të afirmuar rrëfyesit e ungjillit, për të mbikëqyrur dishepullimin e tyre dhe për të demaskuar mashtruesit. Sikurse e thashë edhe në kapitullin e parë, ne nuk u bashkohemi kishave ashtu siç u bashkohemi klubeve. Ne u nënshtrohemi atyre sikurse i nënshtrohemi qeverisë.

Dhe kjo na sjell tek anëtarësia e kishës.

ÇFARË ËSHTË ANËTARËSIA E KISHËS?

Çfarë është anëtarësia e kishës? Ajo është një deklaram i qytetarisë në mbretërinë e Krishtit. Anëtarësia është një pasaportë. Ajo është një njoftim i bërë në sallën e konferencave për shtyp të mbretërisë së Krishtit. Është deklarata që ju jeni një përfaqësues zyrtar, i autorizuar, me të drejta dhe përgjegjësi të plota i Jezu Krishtit.

ANËTARËSIA E KISHËS

Për të dhënë edhe një përkufizim tjetër të gjatë, ne mund të themi se *anëtarësia e kishës është një marrëdhënie zyrtare mes një kishe dhe një të krishterë, e cila karakterizohet nga afirmimi dhe mbikëqyrja nga ana e kishës e dishepullimit të të krishterit dhe e nënshtrimit të tij apo të saj, për ta jetuar dishepullimin e vet nën kujdesin e kishës.*

Vini re sërish elementet e ndryshme që janë të pranishme:

- Një bashkësi kishe *afirmon* zyrtarisht rrëfimin e besimit dhe pagëzimin e një personi si të besueshëm.
- Kisha premtun të *sigurojë mbikëqyrje* për dishepullimin e atij individit.
- Individit ia *nënshtro*n zyrtarisht dishepullimin e vet shërbimit dhe autoritetit të kësaj bashkësie dhe udhëheqësve të saj.

Bashkësia e kishës i thotë individit: “Ne e pranojmë rrëfimin tënd të besimit, pagëzimin dhe dishepullimin tënd në Krishtin si të vërtetë. Prandaj, ne të *afirmojmë* publikisht dhe të pranojmë si dikë që i përket Krishtit dhe *mbikëqyrjes* së bashkësisë sonë.” Në parim, individit i thotë bashkësisë së kishës: “Për aq sa ju njoh si një kishë besnike dhe që shpall ungjillin, unë ia *nënshtroj* praninë dhe dishepullimin tim dashurisë dhe mbikëqyrjes suaj.”

Në njëfarë mënyre, e gjitha kjo i ngjan deklaratës “Po, dua” në ceremoninë e martesës, dhe kjo është arsyeja pse disa flasin për një besëlidhje të kishës vendore.

Anëtarësia e kishës, me fjalë të tjera, ka të bëjë me faktin që një kishë mban përgjegjësi të veçantë për ju dhe ju për një kishë. Është e qartë që pleqtë ose udhëheqësit e një kishe

kanë një rol të madh dhe përfaqësues, të cilin duhet ta luajnë kur bëhet fjalë për mbikëqyrjen e kishës. Por kësaj teme do t'i kthehemi më vonë.

Vini re se si ky përkufizim na ndihmon për të shpjeguar dallimin ndërmjet marrëdhënies sime me Coyle-in, i cili i përket kishës sime, dhe marrëdhënies sime me Mike-un, i cili i përket një kishe tjetër. Kjo është sikur dy prej nesh i rino-vojnë pasaportat tona në Ambasadën e SHBA-së në Bruksel, ndërsa tjetri e bën të njëjtën gjë në Ambasadën e SHBA-së në Paris.

Është e vërtetë që një i krishterë duhet të zgjedhë t'i bashkohet një kishe, por kjo nuk e bën kishën një organizatë vullnetare. Ne, në fakt, e kemi për detyrë që të zgjedhim një kishë vendore ashtu sikurse duhet të zgjedhim edhe Krishtin. Pasi ka zgjedhur Krishtin, i krishteri nuk ka zgjedhje tjetër, veçse të zgjedhë një kishë së cilës t'i bashkohet.

SI DUKET NJË KISHË DHE ANËTARËT E SAJ?

A e dini se çfarë është një metaforë e përzier? Atë e gjeni aty ku përdoren dy imazhe të ndryshme që nuk përputhen bashkë në një shprehje të vetme.

Mund t'ju kujtohet Bulkthi Xhimini nga *Pinoku*, i cili tha: "E leve bukën me gjalpë. Tani fli në të!"¹, ose mund ta keni dëgjuar frazën: "Bëj një ngjitje në fluturim." Edhe sot e kësaj dite, ka raste kur i përsëris fjalët e Bifit, atij tipit mujshar dhe jo shumë të zgjuar nga filmat *Kthim në të ardhmen* (*Back to the Future*): "Pse nuk bëhesh pemë e të më ikësh nga sytë?"².

Pastaj kemi edhe përshkrimin e humoristit Dave Barry për krizën e madhe të tregut të aksioneve në vitin 1929: "Ekonomia në dukje e begatë e këtij kombi na doli thjesht një tigër prej letre me këmbë prej argjile, që jetonte në një shtëpi prej kashte dhe letre dhe që shumë shpesh kishte thërritur 'ujku, ujku'."³

Megjithatë, nuk janë vetëm shkruesit e komedisë që i përziejnë metaforat e tyre. Këtë e bëjnë edhe poetët, edhe pse përzierjet e tyre janë edhe më të holla. T. S. Elliot-i e hap një nga poemat e tij me një frazë të shkurtër për "dëborën harraqe"⁴

ANËTARËSIA E KISHËS

dhe William Butler Yeats-i shkruan për shkeljen mbi ëndrra.⁵ E thënë shkoqur, dëbora nuk mund të jetë harraqe dhe ëndrrat nuk mund të shkelen. Mirëpo kjo dyshe e pazakontë metaforash në të dyja rastet na jep mundësi për të parë gjëra të vërteta, të cilat zakonisht nuk mund t'i shohim dot nëse do të përdorim një gjuhë më të drejtpërdrejtë.

Mund ta keni vënë re se autorët e Dhiatës së Re shpesh i përziejnë metaforat e tyre dhe këtë e bëjnë me qëllim, sikurse edhe poetët. Mendoni për thënien e Palit drejtuar efesianëve: “[lutem që] t’ju ndriçojë sytë e mendjes suaj...” (Efesianëve 1:18). Mendjet nuk kanë sy, mirëpo përzierja e këtyre dy metaforave na ndihmon të shohim diçka të thellë dhe domethënëse.

FOTOGRAFITË E PARADËS SË TASAVE ME FRUTA

Kur autorët e Dhiatës së Re fillojnë të flasin për kishën dhe për anëtarët e saj, ata e ngrenë këtë përzierje metaforash në një nivel të paparë, si në rastin e makinave të garave kur piloti shtyp butonin “turbo”. Pali flet për të qenët të pagëzuar në një trup, a thua se dikush mund të zhytet brenda një trupi. Pjetri flet për të krishterët si “gurë të gjallë”, e cila në vetvete është një metaforë e përzier, dhe pastaj thotë se këta “gurë të gjallë, [ndërtohen] për të qenë një shtëpi frymërore, një priftëri e shenjtë” (1 e Pjetrit 2:5). Nëse do të kisha shkruar një fjali të tillë në lëndën e gjuhës në shkollën e mesme, mësuesi im do të kishte marrë stilografin e tij të kuq dhe do të niste korrigjimin me themel. Nuk jam i sigurt se çfarë do të shkruante atje, por stilografin e kuq do ta kishte me vete.

Kur hapni Biblën tuaj dhe lexoni atë që thotë Perëndia për kishën, ju do të zbuloni që po vështroni një metaforë të madhe

dhe të përzier. Ne lexojmë që kisha është si një trup, një tufë delesh, degët e një hardhie, një nuse, një tempull, ndërtesa e Perëndisë, një popull, mërgimtarë, një komb i shenjtë, një priftëri mbretërore, kripa e tokës, Izraeli i Perëndisë, zonja e zgjedhur, e kështu me radhë. Imazhet vazhdojnë dhe mbli-dhen njëra mbi tjetrën. Të duket sikur po shfleton një album fotografish. Ose ndoshta po sheh një paradë. Ose ndoshta po zgjatesh për të marrë një frutë nga tasi me fruta. Mendoj se është sikur po shihni një album të mbushur me fotografi të një parade tasash me fruta.

Në kapitullin e kaluar e pamë kishën vendore nga aspekti institucional: asambleja e besimtarëve të cilën Krishti e themeloi për qëllimin specifik që ajo të përdorte çelësat e mbretërisë dhe të bënte dishepuj përmes predikimit dhe sakramenteve. Ja se çfarë *është* një kishë vendore. Është një trup që mban çelësat, i themeluar nga Jezusi, për hir të të gjithë atyre që ai i ka blerë me gjakun e tij.

Por nëse përshkrimin tonë e mbylлим këtu, do të ishte sikur të thoshim që një martesë *është* besëlidhja martesore, dhe pastaj të mos thoshim asgjë në lidhje me të gjitha veprimtaritë që besëlidhja martesore i bën të mundura në mënyrë unike dhe të mrekullueshme, si krijimin e partneritetit dhe intimitetit fizik. E kemi thënë që pikëpamja institucionale duhet të mbështetet nga pikëpamja organike. Duhet të dini që rregullat e një institucioni jo vetëm që kufizojnë, por edhe autorizojnë. Ato fuqizojnë. Ato ngrenë bazën për veprimtari.

Çelësat e mbretërisë, të pasuar nga Porosia e Madhe e Krishtit te Mateu 28, i aftësojnë dishepujt e Krishtit që t'i rrokin mrekullitë e besëlidhjes së re dhe t'i zbatojnë ato mbi

ANËTARËSIA E KISHËS

tokë. Dhe pikërisht këtu shfaqen në realitet të gjitha metaforat e përdorura për kishën: trupi, nusja, tempulli, familja, e kështu me radhë. Ne e jetojmë të qenët trup, nuse, tempull dhe familje *përmes* strukturave të llogaridhënies të veprimtarisë gjykuese të kishës për afirmimin, mbikëqyrjen dhe disiplinën e anëtarësisë. Ju mund të thoni se gjuha institucionale e mbretërisë dhe e çelësave shërben si tasi që mban frutat ose si albumi ku janë ruajtur fotografitë.

Sigurisht, mbretëria e Jezusit nuk është metaforike, të paktën jo në të njëjtën mënyrë siç janë këto metafora të tjera për kishën. Mbretëria e Jezusit është *me të vërtetë një mbretëri*. Ai mbretëron me të vërtetë mbi popullin e tij. Mirëpo kisha *nuk është me të vërtetë një trup* njerëzor, një nuse me fustan të bardhë, një tempull i ndërtuar me tulla, një familje individësh të lidhur nga ana biologjike, e kështu me radhë. Ato janë metafora. Ja pse filluam me idenë e mbretërisë së Krishtit — që të na ndihmojë për të përshkruar se çfarë *janë* kisha dhe anëtarët e saj. Këta anëtarë janë si një trup, si një nuse që po bëhet gati, si një tempull, si një familje, si një priftëri mbretërore, e kështu me radhë.

Ja pse nuk mjafton që thjesht të themi se kisha është një ambasadë qytetarësh të ligjshëm. Kur shkova në Ambasadën e SHBA-së në Bruksel, askush nuk më quajti vëlla, siç bëjmë në kishë. Pse më quajnë vëlla në kishë? Sepse t'i përkasësh një kishe, do të thotë t'i përkasësh një familjeje të caktuar.

Kisha është shumë ndryshe nga çdo gjë tjetër mbi tokë. Ajo është njëkohësisht e ngjashme me familjen, me trupin, me tufën — e kuptoni idenë. Kjo është një tablo e vështirë për t'u pikturuar, madje edhe për artistët më të zotë.

RËNDËSIA E METAFORAVE BIBLIKE PËR KISHËN

Më lejon i të them disa gjëra në lidhje me këto metafora dhe arsyen pse ato janë kaq të rëndësishme për ta kuptuar anëtarësinë e kishës.

1. *Secili ka një punë për të bërë, që të përshkruajë diçka në lidhje me bashkimin tonë në një kishë.* Secila metaforë na mëson diçka të ndryshme në lidhje me faktin se si duket një kishë dhe anëtarët e saj. Ta përshkruash kishën si një familje, do të thotë të flasësh për *afrimitetin e marrëdhënieve* të saj dhe për *identitetin e saj të përbashkët*. Ta quash atë një trup, do të thotë që anëtarët e saj kanë një *vartësi reciproke*, e megjithatë kanë *role të ndryshme*. Kur i referohesh kishës si një tempull i Frymës, po thua që Perëndia e *identifikon veten specifikisht me këta njerëz dhe banon me ta*. Gjuha e hardhisë dhe e shermendeve komunikon *vartësinë e kishës te Jezusi dhe Fjala e tij* për vetë jetën e saj. E kuptoni?

Mendoni për këtë gjë në aspektin e bashkimit. Bashkimi i një çifti të martuar i shërben një qëllimi tjetër nga ai i bashkimit të dy tullave në një ndërtesë, duke qenë se këto janë bashkime të llojeve të ndryshme. Megjithatë, si duhet të duket bashkimi ynë brenda kishave tona? Si një bashkim marte-sor? Si një bashkim tullash? Çfarë? E po, ne kemi nevojë që të huazojmë fjalë dhe ide nga të gjitha këto imazhe të ndryshme, për të qenë në gjendje që të karakterizojmë marrëdhëniet tona brenda kishës vendore. A nuk është kjo e mahnitshme?

Prandaj, kur njerëzit më pyesin: “A e gjejmë anëtarësinë e kishës në Bibël?”, jam paksa i tunduar të përgjigjem: “Jo, ajo nuk gjendet në Bibël, të paktën jo ashtu siç e kupton ti.” Bibla ka një vizion shumë më të pasur dhe më të ndërlukar për

ANËTARËSIA E KISHËS

mënyrën se si të krishterët duhet ta jetojnë unitetin e tyre në kishat vendore. Është sikur të kemi qenë duke kërkuar mollë, kur realisht duhet të kërkonim tasa plot me fruta të ndryshme.

Mbi tokë nuk ka asgjë tjetër si kisha vendore.

2. Ne kemi nevojë për të gjitha këto imazhe për ta përshkruar kishën dhe anëtarët e saj. Nëse të gjitha këto metafora ose imazhe kanë një rol për të luajtur, atëherë ne kemi nevojë për të gjitha. Nuk mund të zgjidhni vetëm frutën tuaj të preferuar nga tasi me fruta dhe t'i lini të tjerat — “Unë do të marr mollët dhe do t'i lë portokallet, faleminderit.” Jo, duhet ta marrësh të gjithë tasin.

Me fjalë të tjera, duhet ta mendoni mirë përpara se të vendosni se cila nga metaforat për kishën është më e rëndësishmja. Disa të krishterë në historinë e kishës janë përpjekur të thonë se kisha është më shumë trupi i Krishtit ose më shumë populli i Perëndisë. Mirëpo kjo është sikur të thuash që unë jam më shumë bashkëshort sesa baba, ose më shumë baba sesa bashkëshort. E pranoj që bashkëshortja ime ose fëmijët e mi mund të preferojnë njërin apo tjetrin, mirëpo unë jam të dy njëkohësisht dhe asnjëri më pak se tjetri. Ju keni nevojë për kategoritë “baba” dhe “bashkëshort”, si edhe disa të tjera, për të përshkruar se kush jam në të vërtetë.

Kishat e pashëndetshme, madje edhe denominacionet, ndonjëherë janë rezultat i faktit që udhëheqësit e kishës kanë zgjedhur metaforat e tyre të preferuara nga ky “tas” dhe i kanë lënë të tjerat — ato bëhen krejtësisht afrimetet (familje) ose krejtësisht hierarki (trup).

3. Secila nga këto metafora zbatohet në kontekstin vendor. Çdo metaforë biblike për kishën mishërohet — ajo bëhet e prekshme — në kishën vendore. Familja, trupi, tempulli,

populli — të gjitha këto përshkrime të kishës së Krishtit nuk janë thjesht koncepte abstrakte. Ato bëhen konkrete në vende të caktuara. Ajo zbatohen praktikisht në nivel vendor.

Mirëpo, a nuk i përkasin familjes së Perëndisë të gjithë të krishterët kudo që ndodhen? E vërtetë, por Perëndia ju jep mundësinë që të silleni si një familje me kishën tuaj vendore; ju i trajtoni ata, së pari dhe mbi të gjithë, si motra dhe vëllezër. A nuk i përfshin trupi i Krishtit të krishterët në mbarë botën? Sigurisht që po, por ju jetoni si trupi i Krishtit në kishën tuaj vendore. Njëri nga ju do të jetë goja, një tjetër bërri dhe dikush tjetër ezofagu.

Kjo do të thotë që ju nevojiten të gjitha metaforat për ta përshkruar çdo kishë të gjallë në të cilën keni qenë ndonjëherë. Pikërisht këtu në Kishën e Parë Baptiste ose në Kishën e Dytë Presbiteriane, ose në Kishën Luterane të Shën Markut, ose në Komunitetin e Hirit, ose në kishën “Udhëtimi” e gjeni popullin e Perëndisë. Këtu keni tempullin e Frymës. Dhe këtu keni trupin e Krishtit. Ju nuk keni vetëm një krah ose një kyç të këmbës nga trupi i Krishtit.

Përshkrimi i Palit për trupin e Krishtit te 1 e Korintasve 12 na jep një ilustrim të mrekullueshëm për këtë që po themi. Kur Pali flet për trupin dhe gjymtyrët e tij në këtë pasazh, a po i referohet ai trupit vendor në Korint apo trupit universal të Krishtit? Mendoni për fjalinë: “Dhe ju jeni trupi i Krishtit dhe gjymtyrët e tij, veç e veç” (1 e Korintasve 12:27). Kjo tingëllon si vendore. Mirëpo më herët në kapitull, ai kishte përfshirë edhe veten: “Sepse të gjithë ne jemi pagëzuar në një Frymë të vetëm në një trup...” (12:13). Pali nuk ishte në Korint. Prandaj, a po flet ai për kishën universale?

ANËTARËSIA E KISHËS

Kjo çështje nuk është aq e vështirë kur kujtojmë që kisha universale është e pranishme në kishën vendore. Kisha vendore është një pararojë e kishës së ardhshme universale. Kjo do të thotë që Pali tani anon nga njëri drejtim dhe pastaj nga drejtimi tjetër. Kur ai shkruan: "...ato gjymtyrë të trupit që duken se janë të dobëta, janë të nevojshme" (1 e Korintasve 12:22), do të thosha që ai po thekson trupin vendor. Megjithatë, kur ai shkruan: "Sepse të gjithë ne jemi pagëzuar në një Frymë të vetëm në një trup..." (1 e Korintasve 12:13), do të thosha se ai po thekson aspektin universal. Me pak fjalë, 1 e Korintasve 12 është një ilustrim i mrekullueshëm i mënyrës se si një kishë vendore duhet të nisë ta mishërojë sot realitetin se si do të duket asambleja e Krishtit në kohët e fundit.

Për ta thënë ndryshe, anëtarësia juaj në një trup vendor tani paraqet një tablo të anëtarësisë suaj në trupin e tij të kohëve të fundit. Ju mund të jeni të kënaqur që e gjithë ideja e "kishës" të ekzistojë në mendjen tuaj. Mirëpo Jezusi nuk ishte dhe aq i kënaqur me këtë. Ai donte që kisha e tij dhe anëtarësia juaj në të të shfaqeshin në kohë reale. Prandaj, pa kishën vendore, ju nuk mund t'i përmbushni dot detyrimet tuaja ndaj të krishterëve të tjerë dhe ndaj udhëheqësve të kishës, të paktën jo në mënyrën se si Shkrimi ju bën thirrje për t'i përmbushur. Të krishterët e tjerë dhe udhëheqësit e kishës gjithashtu nuk mund t'i përmbushin detyrimet e tyre ndaj jush pa një kishë vendore. Ju keni nevojë për *një* trup të Krishtit që të jeni *trup*i i Krishtit. Ju keni nevojë për *një* familje të Perëndisë që të jeni *familja* e Perëndisë.

Si e përmbushni urdhërimin e Jezusit që "ta doni njëri-tjetrin" (Gjoni 13:34)? Si e përmbushni urdhërimin e Palit që

të mbani “barrët e njëri-tjetrit” (Galatasve 6:2)? Si u bindeni fjalëve të Pjetrit: “Gjithsecili le ta vërë në shërbim të tjetrit dhuntinë që ka marrë...” (1 e Pjetrit 4:10)?

Ju u bindeni të gjitha këtyre urdhërimeve përmes anëtarësisë suaj në kishën vendore.

Ja një mënyrë tjetër për të menduar se për çfarë bëhet fjalë: Si duhet të reagojmë ndaj një personi që thotë se është “i drejtë në Krishtin”, por nuk i bie kurrë pas drejtësisë? Do të thoshim se ai është i vetëmashtruar dhe do ta nxitnim që të pendohej. Ata, të cilëve u është dhënë falas drejtësia e Krishtit, vazhdojnë ta kërkojnë drejtësinë (p.sh., Romakëve 6:2; dhe 1 e Gjonit 3:7). Gjithashtu, si duhet të reagojmë ndaj personit që thotë se i përket trupit universal të Krishtit, por kurrë nuk bashkohet me një trup të Krishtit këtu mbi tokë? Duhet të themi se ky person ka mashtruar veten dhe duhet të pendohet.

Trupi i Krishtit, populli i Atit dhe tempulli i Frymës do të mblidhet i gjithi në lavdi. Megjithatë, është e mahnitshme sepse, edhe tani, ju mund të gjeni shprehje të papërsosura, pararoja ose ambasada të asaj asambleje në kishën vendore.

Mbi tokë nuk ka asgjë tjetër si kisha vendore — ajo vjen nga fundi i kohërave!

4. *Metaforat nuk janë vërtet metafora, por janë hije.* Këtë mund ta shihni tek Efesianëve 5. Pali shkruan: “Prandaj njeriu do të lërë atin e tij dhe nënën dhe do të ngjitet pas gruas së tij, dhe të dy do të bëhen një mish i vetëm.’ Ky mister është i madh; por unë e them në lidhje me Krishtin dhe me kishën” (Efesianëve 5:31–32). Pali po flet për martesën, por pastaj, krejt papritur, e ndryshon temën. Ai thotë se martesë është një referencë Krishtit dhe kishës. Martesë është një simbol ose një hije

ANËTARËSIA E KISHËS

e Krishtit dhe e kishës. Ne e kuptojmë së prapi këtë nëse mendojmë se martesë është realiteti dhe se dashuria e Krishtit për kishën është simbol për martesën.

Kjo është sikur, para se të krijonte botën, Perëndia të kishte thënë me vete: “Si mund të thur në pëlhurën e krijimit një simbol ose një hije të dashurisë besnike të Birit tim për kishën? Si mund ta shpall këtë gjë në nivel universal, në mënyrë që të gjithë ta shohin dhe të kuptojnë që po qëndrojnë nën hijen e diçkaje jashtëzakonisht madhështore?”.

Përgjigjja: ai krijoi martesën. Ky është skicimi i hijezuar që na tregon për realitetin *e vërtetë* — Krishtin dhe kishën.

Besoj se e njëjta gjë vlen për të gjitha metaforat biblike për kishën. Ato janë hijet e diçkaje edhe më të madhe. Mendoni, gjithashtu, për mënyrën se si Pali i referohet Atit qiellor, “nga i cili merr emër çdo familje në qiej dhe mbi tokë” (Efesianëve 3:15). Perëndia i vendosi etërit tokësorë këtu, në mënyrë që e gjithë bota të ketë një skicim të hijezuar për faktin se si duhet të jetë marrëdhënia me Atin tonë qiellor.

Pse mendoni se Perëndia ka krijuar vëllezër dhe motra? Sërish, që të gjithë të kenë një ndjesi sado të vogël të identitetit të vërtetë, i cili fillon tani në kishën vendore dhe do të jetë i plotë në lavdi.

Çfarë mund të themi për degët e hardhisë? Kjo na jep një tablo për varësinë tonë të Fjalës së Krishtit. Besoj se, kur të jemi në lavdi, varësia jonë e plotë dhe tërësore tek ai do të bëhet edhe më e qartë. Madje edhe metaforat e Dhiatës së Vjetër për kishën, si ajo e tempullit, edhe pse tregojnë pas në jetën e Izraelit, ato njëkohësisht tregojnë përpara drejt realiteteve më të mëdha në epokën që do të vijë.

NUK KA ASGJË TJETËR SI KISHA VENDORE

A po filloni ta kuptoni pse vazhdoj të them se nuk ka asgjë tjetër si kisha vendore dhe anëtarët e saj në këtë botë? Marrëdhëniet që kemi në kishën vendore, në fund të fundit, do të dalin edhe më të lidhura se një trup fizik, më të sigurt se përqafimi i një ati, më të ngrohta se dashuria vëllazërore, më të qëndrueshme se një shtëpi prej guri, më të shenjta se një priftëri, e kështu me radhë.

Këtë ka përgatitur Jezusi për ne në lavdi dhe këtë fillojmë ta praktikojmë tani në Kishën e Parë Baptiste ose në Kishën e Dytë Presbiteriane, ose në kishën “Udhëtimi”. Ne e praktikojmë këtë me të gjithë ata që janë ende mëkatarë dhe të çuditshëm, të cilët na lëndojnë, ashtu sikurse i lëndojmë edhe ne.

Çfarë janë kisha vendore dhe anëtarët e saj? Ata janë si një trup, si një nuse që po bëhet gati, si një tempull, si një familje, si një priftëri mbretërore... por, në secilin rast, janë *madje edhe më shumë se kaq!*

KTHEHEMI SËRISH NË REALITET?

Pasi kemi thënë gjithë këtë, çdo anëtar kishe në këtë botë e di që jeta në kishën vendore nuk është gjithmonë kështu — kaq e ndërlikuar, kaq e sigurt, kaq e ngrohtë, kaq e qëndrueshme, kaq e shenjtë. Në fakt, mund të na duket se është krejt e kundërta e kësaj.

Kohët e fundit një grua u largua nga kisha ime e zhgënjyer dhe e lënduar prej saj. Ajo më shkroi në një email: “Pavarësisht nëse janë besimtarë ose jo, anëtarët e familjes sime do të sakrifikojnë shumë për mua, gjë që një familje e kishës nuk do ta bënte kurrë. Prandaj, me sinqeritet, nuk ma mbush më

ANËTARËSIA E KISHËS

syrin ajo tabloja e familjes dhe e komunitetit ashtu si më parë. Familja në të cilën kam lindur dhe miqtë që kam pasur në jetën time, do të jenë njerëzit të të cilët mund të mbështetem me të vërtetë.”

Këto janë fjalët e dikujt shpresat e së cilës ishin shkatërruar. Asaj i kishin mësuar se kisha ishte një gjë, por ajo përjetoi diçka krejt tjetër. A është kisha më e lidhur se një familje? A është ajo më e sigurt se përqaftimi i një babai? A është ajo më e dashur se motrat dhe vëllezërit e një gjaku? Me të vërtetë?! Nuk ishte kështu në përjetimin e saj. Ndoshta as në tuajin.

Çfarë të themi për realitete si këto? Ja se çfarë i thashë unë asaj gruaje:

Si fillim, më vjen keq. Më vjen keq për mëkatin tonë dhe për lëndimin që të kemi shkaktuar. Besoj që mëkati dhe lëndimi janë realë.

Së dyti, të lutem, na fal. Kemi nevojë që të na falësh, në mënyrë që të mund të pajtohemi në Krishtin, edhe nëse nuk i përkasim së njëjtës bashkësi.

Së fundi, a dëshiron ta shohim ungjillin bashkë? Mendoj për Pjetrin, këtë shkëmb mbi të cilin është ngritur kisha, ai që i premtoi Jezusit se nuk do ta tradhtonte, dhe pastaj e tradhtoi. Më vonë, Pjetri zgjodhi të mos hante me një shtresë të tërë anëtarësh të kishës, me johebrenjtë. Megjithatë, Jezusi vdiq për tradhtarët, për hipokritët, për të pasjellshmit dhe për racistët si puna e këtij Pjetri. Dhe Pjetri është ai që më vonë e përshkroi kishën si “gurë të gjallë” dhe si një “shtëpi frymërore”. Pjetri, me të vërtetë? A ke qenë edhe ti kaq e fortë, kaq e qëndrueshme dhe kaq frymërore me vëllezërit dhe motrat e tua në Krishtin?

Megjithatë, ja cili është lajmi i mirë: nuk duhet të mbështetemi dhe as të kemi besim në forcën dhe dashurinë e njerëzve si Pjetri. Ne duhet të mbështetemi dhe t'i besojmë forcës

dhe dashurisë së Krishtit. Përmes punës së tij në kryq, ne jemi bërë trupi *i tij*, familja *e tij*, tempulli *i tij*, populli *i tij*, tufa *e tij*, gëzimi dhe kurora *e tij*. Ai na ka bërë këta që jemi dhe jo ne vetë. Tani, ai po na përsos që të bëhemi ata që (çuditërisht) tashmë jemi.

Prandaj, mbahu fort. Qëndro me ne. Këmbëngul në falje dhe dashuri. Do të arrijmë atje — jo falë nesh, por falë tij.

Vëllai yt në Krishtin,
Jonathan-i

Dymbëdhjetë arsye pse anëtarësia ka rëndësi

1. *Anëtarësia është biblike.* Jezusi e themeloi kishën vendore dhe të gjithë apostujt e kryen shërbesën e tyre përmes saj. Jeta e krishterë në Dhiatën e Re është jetë në kishë. Të krishterët e sotëm duhet të presin dhe të dëshirojnë të njëjtën gjë.
2. *Kisha janë vetë anëtarët.* Të jesh një kishë në Dhiatën e Re, do të thotë të jesh një prej anëtarëve të saj (lexo Librin e Veprave të Apostujve). Ju duhet të jeni pjesë e kishës, sepse këtë erdhi Jezusi që ta shpëtonte dhe ta pajtonte me veten.
3. *Anëtarësia është parakusht për të marrë Darkën e Zotit.* Darka e Zotit është një vakt për kishën e mbledhur bashkë, domethënë, për anëtarët e saj (shih 1 e Korintasve 11:20–33). Ju duhet të dëshironi të merrni pjesë në Darkën e Zotit. Kjo shërben si flamuri i ekipit tonë, i cili e bën kishën të dukshme mes kombeve.
4. *Anëtarësia është mjeti përmes të cilit e përfaqësoni zyrtarisht Jezusin.* Anëtarësia është afirmimi nga ana e kishës që ju jeni një qytetar i mbretërisë së Krishtit dhe, si rrjedhim, një përfaqësues i tij me përgjegjësi dhe të drejta të plota përpara kombeve. Ju duhet të dëshironi që përfaqësimi juaj të ketë autorizimin e duhur. E lidhur ngushtë me këtë...

5. *Anëtarësia është mjeti përmes të cilit ju shpallni besnikërinë tuaj më të madhe.* Anëtarësia juaj në ekip, gjë që bëhet e dukshme kur mbani lart flamurin e Darkës së Zotit, është një dëshmi publike që besnikëria juaj më e madhe i përket Jezusit. Sprovat dhe përndjekja mund të vijnë, por fjalët tuaja të vetme janë: “Unë jam i krishterë.”
6. *Anëtarësia është mjeti përmes të cilit i mishëroni dhe i përjetoni imazhet biblike.* Vetëm brenda strukturave të llogaridhënies së kishës vendore, të krishterët mund ta jetojnë dhe ta përjetojnë realitetin që trupi i tij është i lidhur bashkë, të përjetojnë plotësinë frymërore të tempullit të tij, si dhe sigurinë, afriimitetin dhe identitetin e përbashkët të familjes së tij.
7. *Anëtarësia është mjeti përmes të cilit u shërbeni të krishterëve të tjerë.* Anëtarësia ju ndihmon të dini se për cilët të krishterë në planetin Tokë keni përgjegjësi specifike për t’i dashur, për t’u shërbyer, për t’i paralajmëruar dhe për t’i inkurajuar. Anëtarësia ju jep mundësi për të përmbushur përgjegjësitë tuaja biblike ndaj trupit të Krishtit (për shembull, shih Efesianëve 4:11-16, 25-32).
8. *Anëtarësia është mjeti përmes të cilit i ndiqni udhëheqësit e krishterë.* Ajo ju ndihmon të dini se cilëve udhëheqës të krishterë në planetin Tokë jeni thirrur t’u bindeni dhe t’i ndiqni. Sërish, anëtarësia ju jep

mundësi për të përmbushur përgjegjësinë tuaj biblike ndaj tyre (shih Hebrenjve 13:7, 17).

9. *Anëtarësia i ndihmon udhëheqësit e krishterë që të udhëheqin.* Anëtarësia u jep mundësi udhëheqësve të krishterë që të dinë se për cilët të krishterë në planetin Tokë do të “japin llogari” (Veprat e Apostujve 20:28; 1 e Pjetrit 5:2).
10. *Anëtarësia bën të mundur disiplinën e kishës.* Ajo ju jep vendin e caktuar nga Bibla, ku të merrni pjesë me përgjegjësi, urtësi dhe dashuri në punën e disiplinës së kishës (1 e Korintasve 5).
11. *Anëtarësia siguron strukturën për jetën tuaj të krishterë.* Ajo e vendos shpalljen e një individi të krishterë për t’iu bindur Jezusit dhe për ta ndjekur atë, në sfondin e jetës reale, aty ku autoriteti, në fakt, ushtrohet mbi ne (shih Gjoni 14:15; 1 e Gjonit 2:19; 4:20–21). *Anëtarësia është programi dishepullues i Perëndisë.*
12. *Anëtarësia krijon një dëshmi dhe i fton kombet.* Anëtarësia e bën të dukshëm sundimin ndryshe të Krishtit, që ta shohë e tërë gjithësia (shih Mateu 5:13; Gjoni 13:34–35; Efesianëve 3:10; 1 e Pjetrit 2:9–12). Vetë caqet që janë vendosur rreth anëtarësisë së një kisha, krijojnë një shoqëri njerëzish, që i fton kombet të diçka më e mirë. *Anëtarësia është programi ungjillëzues i Perëndisë.*

CILAT JANË “STANDARDET” E ANËTARËSISË? (TË BËHESH ANËTAR)

Disa njerëz e shpërfillin anëtarësinë e kishës ngaqë mendojnë se kjo u vendos pengesa njerëzve. Ose ndoshta mendojnë se kjo do të thotë të vendosësh standarde të caktuara sjelljeje për të hyrë në kishë. Të dyja këto gjëra tingëllojnë si e kundërta e hirit të Perëndisë, i cili është falas.

Nuk është e vështirë të kuptojmë pse njerëzit mendojnë kështu. Zakonisht, anëtarësia përfshin arritjen e një standardi të caktuar. Për të qenë pjesë e një klubi të caktuar, duhet të jesh mjaft i pasur, duhet të jesh mjaft interesant për rrethin e vogël ekskluziv, duhet të jesh mjaft i zgjuar për të qenë pjesë e ekipit të debatit, duhet të jesh mjaft i shpejtë për të qenë pjesë e ekipit të futbollit dhe duhet të kujdesesh mjaftueshëm për të qenë pjesë e një organizate bamirësie.

Për të qenë anëtar i diçkaje do të thotë, me përkufizim, të jesh diçka që të tjerët nuk janë. Kjo tingëllon si shumë përjashtuese, apo jo? Mos vallë ideja e anëtarësisë mund t'i tundojë të krishterët drejt moralizmit dhe fariseizmit? Krishterimi nuk

ANËTARËSIA E KISHËS

ka të bëjë me standardet. Krishterimi ka të bëjë me hirin falas. Atëherë, si mund të caktojmë standarde?

Të them të drejtën, është e lehtë që të shkojmë në një drejtim moralist për sa i përket anëtarësisë së kishës. Më sipër thashë se një anëtar kisha është një përfaqësues i Jezusit, me përgjegjësi dhe të drejta të plota, dhe unë nuk lëviz nga kjo që kam thënë. Por mendoni pak se sa shpejt mund të gabojmë në të menduarit tonë: Jezusi është përsosurisht i shenjtë. Prandaj, përfaqësimi i Jezusit duhet të ketë kuptimin që ne duhet të jemi të shenjtë. Dhe kjo duhet të ketë kuptimin që standardi për anëtarësinë e kishës duhet të jetë shenjtëria. Prandaj, unë do ta përbuz këdo tjetër që nuk është i shenjtë si unë. Ndoshta as nuk duhet t'i lejoj që të hyjnë në kishën time. Ata nuk ua bëjnë shkollën fëmijëve në shtëpi siç bëj unë. As nuk luten me pasion siç bëj unë. Nuk shkojnë në udhëtime misioni siç bëj unë. Ata nuk kursejnë në blerjet e tyre siç bëj unë.

E shihni se ku po shkon një mendësi e tillë? Duket sikur e gjithë ideja e anëtarësisë së kishës thjesht mund të krijojë qytetarë të shtresës së lartë, qytetarë të shtresës së ulët dhe njerëz që nuk janë fare qytetarë, bazuar mbi *performancën* e tyre. Ky është antihir, është antiungjill. A është kjo ideja që mbron ky libër?

Cilat janë saktësisht “standardet” e anëtarësisë së kishës?

KUSH MUND TË HYJË?

Një nga privilegjet që kam shijuar, teksa kam shërbyer si plak kisha, është mundësia për të bërë intervista anëtarësie. Ju mund të thoni se kjo është si puna e bariut, i cili qëndron te

hyrja e vathës së deleve dhe tregon kujdes se ç’lloje kafshësh hyjnë brenda. Ju doni që brenda të hyjnë delet dhe jo ujqërit.

Bazuar mbi atë që personi thotë gjatë intervistës, unë mund ta rekomandoj individin te pleqtë e tjerë, të cilët, nga ana e tyre, mund ta rekomandojnë atë përpara gjithë bashkësisë. Përderisa Jezusi ia jep pushtetin e çelësve kishës vendore, ne besojmë se, në fund të fundit, vendimin duhet ta marrë kisha dhe jo pleqtë e saj.

Kush mund të hyjë? Ja cila është përgjigjja më e thjeshtë e mundshme: të krishterët. Kjo do të thotë që standardi për anëtarësinë e kishës nuk duhet të jetë as më i lartë dhe as më i ulët se standardi për të qenë i krishterë — me një përjashtim të vetëm, të cilin do ta bëj të qartë pas pak. Ju po përpiqeni të afirmoni delet.

Anëtarësia e kishës fillon kur kisha vendore e afirmon rrëfimin e besimit të një individi të krishterë. Ne e pyesim personin se kush është Jezusi, ashtu siç bëri edhe Jezusi me Pjetrin. Personi përgjigjet duke thënë se Jezusi është Krishti, Biri i Perëndisë të gjallë — duke e ditur se çfarë kuptimi kanë këto fjalë — ashtu siç bëri edhe Pjetri me Jezusin. E thënë ndryshe, për t’iu bashkuar një kishë, njerëzit kanë nevojë që ta kuptojnë dhe ta besojnë ungjillin.

Njerëzit nuk mund ta shpjegojnë gjithmonë mirë ungjillin, por, në njëfarë mënyre apo në një tjetër, ata duhet të jenë në gjendje për ta shpjeguar atë. Përpara se t’i quajmë zyrtarisht përfaqësues të Jezusit, ata duhet të jenë në gjendje për të thënë se kë përfaqësojnë. Më kujtohet një intervistë që bëra me një grua, gjuha e parë e së cilës nuk ishte anglishtja. Kur e pyeta se çfarë ishte ungjilli, ajo më pa çuditshëm dhe tha:

ANËTARËSIA E KISHËS

“Ungjilli?”, sikur të mos e kishte dëgjuar kurrë më parë atë fjalë. Prandaj, unë vazhdova dhe i thashë: “Lajmi i mirë i Jezus Krishtit.” Ky qartësim u duk sikur ndezi një dritë në mendjen e saj dhe ajo ma shpjegoi mjaft mirë ungjillin. Kisha jonë nisi ta quante atë anëtare. Kur e bëjmë këtë, është si rasti i nxjerrjes së një deklarate për shtyp që thotë: “Drejtuar të gjitha kombeve: Tani mund ta shihni këtë grua për të mësuar se si është Jezusi. Ajo është një përfaqësuese zyrtare e Jezusit.”

Herë të tjera, kam intervistuar individë që nuk mund të ma shpjegonin dot ungjillin. Më kujtohet një grua tjetër e cila më tha se, të qenët e krishterë, do të thotë “të bësh më të mirën”. U përpoqa që ta trajtoja temën nga disa këndvështrime të ndryshme duke i bërë më shumë pyetje, duke menduar se mund të merrja një përgjigje më të mirë prej saj. Mirëpo nuk mora një përgjigje më të mirë. Kur, më në fund, i shpjegova se *nuk* mund të shkonim drejt anëtarësimit, ajo nisi të qante. Edhe unë doja të qaja. Nëse do ta kishit dëgjuar historinë e vështirë të jetës së saj, do të ishit ndier njëlloj. Mirëpo nëse do të vazhdonim me procesin, nuk do t’i tregonim dashuri as asaj dhe as kishës.

Prandaj, e ftova të takohej me një grua në kishë, që ta studionin bashkë Ungjillin sipas Markut për gjashtë javë. Ajo pranoi. U takua me atë grua. Disa javë më pas, u ulëm sërish dhe e nisëm intervistën nga e para. Kësaj here, ajo e shpjegoi ungjillin në mënyrë të mrekullueshme dhe iu bashkua kishës sonë. Deklaratë për shtyp: “Drejtuar të gjitha kombeve: Shikoni këtu! Kjo është një përfaqësuese tjetër!”

Mendoj se këtë që bëra, ju mund ta përshkruani sikur e detyrova atë grua që “të kërcente mbi një pengesë”. Megjithatë, unë shpresoj që këtë do ta quanit përkujdesje pastorale ndaj saj

dhe ndihmë për t’u siguruar që ajo e njihnte ungjillin dhe ishte kthyer në besim, për të mos thënë që kjo ishte edhe një mënyrë për t’u kujdesur për kishën dhe për reputacionin e Krishtit.

BESIMI

Ju thashë se anëtarësia e kishës fillon kur një kishë e afirmon rrëfimin e besimit të një personi, siç bëri edhe Jezusi me Pjetrin. Për ta lehtësuar këtë proces, kishat shpesh përdorin një deklaratë besimi për t’u siguruar që të gjithë ata që po përfshihen në këtë bisedë, po thonë dhe po besojnë të njëjtat gjëra.

Për shembull, mormonët, Dëshmitarët e Jehovahit dhe disa protestantë liberalë e rrëfejnë besimin e tyre në Jezusin, ashtu siç bëri Pjetri. Mirëpo ata nuk do të thonë që Jezusi është Perëndi. Prandaj, për cilin Jezus po flasim? Deklarata e besimit të kishës na ndihmon për ta qartësuar këtë.

Në kishën e hershme kishte disa njerëz të cilët e mohuan faktin që Jezusi ishte plotësisht njeri. Dëgjoni se si e inkurajon apostulli Gjon një kishë që të ushtrojë dallim në këtë çështje:

Të dashur, mos i besoni çdo fryme, por i vini në provë frymërat nëse janë prej Perëndisë, sepse shumë profetë të rremë kanë dalë në botë. Në këtë e njihni Frymën e Perëndisë: çdo frymë, që rrëfen se Jezu Krishti ka ardhur në mish, është prej Perëndisë. Dhe çdo frymë, që nuk rrëfen se Jezu Krishti ka ardhur në mish, nuk është prej Perëndisë... (1 e Gjonit 4:1-3)

Kishte profetë që thoshin: “Po, edhe unë besoj në Jezusin. Unë jam njëlloj si ju.” Mirëpo Gjoni tha: “Duhet të hetoni pak më shumë. Ata mund të mos jenë njëlloj si ju.”

Dy mijë vjet kanë kaluar dhe mësimet e rreme thjesht

ANËTARËSIA E KISHËS

janë shumë. Ja pse shumica e kishave kanë deklarata besimi që trajtojnë Perëndinë, Shkrimin, mëkatin, shpëtimin, kishën dhe kthimin e Jezusit.

Kur i kërkojmë një personi të afirmojë një deklaratë besimi, synimi nuk është që të afirmojmë teologët profesionistë, por që të afirmojmë të krishterët. Dëgjoni standardet e Jezusit: “Kush, pra, do ta përulë veten si ky fëmijë i vogël, ai do të jetë më i madhi në mbretërinë e qiejve. Dhe kushdo që e pranon një fëmijë të vogël si ky në emrin tim, më pranon mua” (Mateu 18:4–5). Me fjalë të tjera, kishat duhet të zhvillojnë aftësinë për të dalluar thyerjen dhe përulësinë e dhënë nga Fryma e Shenjtë përpara Perëndisë. Si tingëllon një thyerje e tillë? Ajo tingëllon kështu: “Po, unë jam një mëkatar i prishur. Po, Perëndia duhet të më gjykojë. Mirëpo Jezusi vdiq në kryq për mëkatet e mia. Tani ai është Zoti im dhe unë e ndjek atë.”

Si tingëllon një zemër e thyer? Ajo tingëllon si fillimi i doktrinės së mirë dhe si një zemër që i beson asaj që thotë Bibla për Perëndinë dhe për ne.

PENDIMI

Krishterimi nuk fillon vetëm me besimin. Po kështu as anëtarësia e kishës. Jezusi predikoi: “U mbush koha dhe mbretëria e Perëndisë është afër. Pendohuni dhe besoni në ungjillin” (Marku 1:15).

Pendimi është fryt i një zemre të thyer nga Fryma, po ashtu si doktrina e mirë dhe besimi.

Nëse do të shkruaja një udhëzues për standardet për ata që bëjnë intervista anëtarësie, do të shkoja drejt e te Lumturitë e Mateut. Ja se çfarë mund të shkruaja:

Kërkoni ata që janë skamës në frymë; ata që vajtojnë për mëkatin e tyre; të cilët nuk pretendojnë për të drejta, që nuk ngulin këmbë gjithmonë në të tyren, por janë zemërbutë; të cilëve u ka ardhur në majë të hundës me mëkatin dhe gjithë marrëzitë e tij, prandaj edhe kanë etje dhe uri për drejtësi, sikur ajo të ishte ujë i freskët. Kur të gjeni njerëz të tillë, sigurohuni që ata ta dinë se kush është Jezusi. Sigurohuni që të jetë Jezusi ai që i mbush shpirtrat e tyre të varfër, ai që i ka falur mëkatet e tyre, që e pranon jetën dhe adhurimin e tyre, dhe në drejtësinë e të cilit ata mbështeten dhe e kërkojnë. Kur të gjeni njerëz të tillë, kërkojuni që t’ju bashkohen!

Vini re se nuk është përsosmëria morale ajo që e kualifikon një person për të qenë anëtar i kishës. Është krejt e kundërta. Është fakti që ai apo ajo e dallon mungesën e përsosmërisë morale, e cila shoqërohet me një uri për ta pasur atë. Nuk janë njerëzit që nuk mëkatojnë kurrë; janë njerëzit që luftojnë kundër mëkatit. Puna gjykuese e një kishe nuk është që të afirmojë të drejtët, por të padrejtët që kanë etje për drejtësi — atë drejtësi të cilën mund ta japë vetëm Perëndia në Krishtin.

Ja një mënyrë tjetër për ta thënë këtë: ajo që i bën njerëzit të pranueshëm për një kishë, nuk është pastërtia e tyre morale, por pastërtia e Krishtit — jo ajo që kanë bërë ata për ta shpëtuar veten, por ajo që ka bërë Perëndia për t’i shpëtuar ata.

PAGËZIMI

A kanë njerëzit vërtet nevojë që të ulen në një zyrë kishe me një nga pleqtë për të bërë një intervistë përpara se t’i bashkohen asaj? Jo, përpara se kisha ta vendosë vulën e saj të aprovimit mbi dikë, ka mënyra të ndryshme për t’u siguruar që dikush

ANËTARËSIA E KISHËS

e përfaqëson Jezusin. Për këtë gjë do të mendojmë më tej në kapitullin e tetë.

Tani për tani, është e rëndësishme të shohim që ka një çështje, përveç shpëtimit, për të cilën kishat duhet t'u kërkojnë anëtarëve të tyre të tregojnë bindje, dhe kjo është pagëzimi. Në kapitullin e dytë, pamë që hapi i parë i jetës së krishterë në Dhiatën e Re ishte pagëzimi — gjithmonë. Turmat e pyetën Pjetrin se çfarë duhet të bënin për t'u shpëtuar dhe ai u përgjigj: “Pendohuni dhe secili nga ju le të pagëzohet...” (Veprat e Apostujve 2:38). Pali, duke i shkruar kishës në Romë, thjesht e mori për të mirëqenë faktin që të gjithë ata ishin pagëzuar (Romakëve 6:4). Pagëzimi është gjëja e parë që Jezusi i urdhëroi dishepujt e tij të bënin në procesin e bërjes së dishepujve (Mateu 28:19).

Pagëzimi nuk e shpëton personin, por Jezusi do që individët e shpëtuar prej tij të identifikohen publikisht me të dhe me popullin e tij. Kjo është një pjesë e mënyrës se si zyrtarizohet qytetaria e ndjekësve të tij. Kështu ata e mbajnë lart flamurin e tij.

Në të njëjtën mënyrë, për dy mijë vjet, kishat e kanë trajtuar pagëzimin si një parakusht për anëtarësim. A thotë Bibla: “Duhet të pagëzohesh përpara se t'i bashkohesh një kishë”? Jo, por ajo thotë: “Pendohuni dhe secili nga ju le të pagëzohet...” Nëse dëshiron të identifikohesh me popullin e Krishtit dhe të presësh që ata të identifikohen me ty, ke nevojë që, më së pari, ta identifikosh veten tënde me Krishtin, dhe ky është qëllimi i pagëzimit. E po, nëse e refuzon pagëzimin, duket që nuk je penduar. Siç thotë edhe Mark Dever-i: “Të lagesh në ujë është

urdhërimi më i lehtë që Jezusi na dha ndonjëherë për t'iu bindur. Vetëm pas kësaj gjërat nisin të vështirësohen.”

PËRFUNDIMI

Përpara disa javësh, një shoku im pastor më telefonoi dhe më pyeti nëse duhej ta lejonte një burrë që të bashkohej sërish me kishën e tij. Ky burrë kishte hequr dorë nga anëtarësia disa muaj më parë, por tani dëshironte të kthehej. Ai ishte një individ disi problematik, nuk ishte përçarës haptazi, por ishte i papjekur dhe, me raste, irritues ndaj udhëheqjes. Shoku im po mendonte të mos e lejonte atë që të bashkohej sërish me kishën.

E pyeta nëse mendonte se ai burrë ishte i krishterë. “Po”, ishte përgjigjja e avashtë dhe disi hezituese.

Pastaj e pyeta nëse ai do të ishte i gatshëm të çohet në këmbë në një qendër tregtare, të tregonte me gisht nga ky burrë dhe t’u thoshte të gjithëve se ai ishte një përfaqësues i Jezusit. “Them se po”, ishte përgjigjja tjetër edhe më hezituese.

“E po, atëherë mendoj se ndoshta duhet ta lejosh t’ju bashkohet sërish. Duhet t’i lejojmë edhe të krishterët e pasjellshëm që t’u bashkohen kishave tona.”

Kishat nuk duhet të kërkojnë njerëz që kurrë nuk sillen keq, por njerëz që e pranojnë se janë të pasjellshëm dhe janë të gatshëm ta luftojnë këtë gjë.

Pak a shumë si puna ime. Ndoshta edhe si ju?

SI I NËNSHTROHET I KRISHTERI KISHËS? (TË JESH ANËTAR)

Më parë thashë se, në të vërtetë, të krishterët nuk u bashkohen kishave, ata u nënshtrohen atyre. Në fund të fundit, Jezusi u ka dhënë kishave autoritet për të lidhur dhe për të zgjidhur mbi tokë, gjë që do të thotë se të krishterët janë thirrur për t'iu nënshtroar atyre si një akt nënshtrimi ndaj tij. Është njëlloj si në rastin kur një fëmijë që e nderon Perëndinë, u nënshtrohet prindërve të tij apo të saj.

Fjala *nënshttrim* i frikëson shumicën e njerëzve sot, pjesërisht për shkak se kemi parë shumë abuzim të udhëheqjes, përfshirë këtu edhe të udhëheqjes nëpër kisha. Megjithatë, në gjithë Shkrimin, Perëndia na zbulon se qëllimi i tij për autoritetin është e mira jonë. Autori i krijimit e përdori autoritetin e tij për të na krijuar dhe për të na bekuar. Në të njëjtën mënyrë, ai ka për qëllim që administratorët njerëzorë, të autorizuar prej tij, ta përdorin autoritetin e tyre për të sjellë jetë dhe begati te të tjerët (për shembull, lexoni 2 i Samuelit 23:3-4; si dhe Isaia 11:2-10).

ANËTARËSIA E KISHËS

Çfarë do të thotë t'i nënshtrohesh një kishë, dhe a është kjo për të mirën tonë?

NATA ME YJE

Për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve, le të fillojmë duke i hipur makinës për të shkuar në Arizona.

Njëherë shkova për kampim në shkretëtirën e Arizonës, jo shumë larg Kanionit të Madh. Natën e parë i shtrua jorganët e kampimit nën qiellin e hapur me yje. Nuk kam parë kurrë qiell si ai. Atje, mes ajrit të pastër të shkretëtirës, yjet shkëlqenin aq fort, saqë mund të zgjatje dorën dhe gati-gati mund ta shihje hijen e saj mbi tokë.

Ky është qielli që dëshiroj të shihni. Dëshiroj të shihni lart dhe të vështroni kanavacën e zezë të spërkatur me dhjetëra mijëra diamante drite.

Pse? Kjo është tabloja që pikturon Pali për të krishterët dhe për kishat në botë. Ai u tha të krishterëve në qytetin e lashtë të Filipisë se dëshira e tij për ta ishte:

“...që të jeni të paqortueshëm e të panjollë,

bij të Perëndisë, të patëmetë në mes të një breznie të shthurur e të çoroditur.

Mes kësaj breznie ju ndriçoni si yjet në qiell.” (Filipianëve 2:15,
Bibla “Së Bashku”, 2023)

Qyteti i Filipisë ishte kanavaca e errët. Të krishterët duhej të ishin diamantet e dritës. Qyteti ishte dredharak dhe i çoroditur. Të krishterët duhej të ishin të paqortueshëm dhe të panjollë.

A mund ta dalloni? Pali dëshironte që këta besimtarë të

shkëlqenin, që ata të shkëlqenin në shtëpi, në vendin e punës, në treg dhe në fushën e lojës.

Mirëpo ka diçka që nuk duhet t’ju shpëtojë në lidhje me atë që po thoshte Pali. Ai nuk donte që ata thjesht të vezullonin dhe të xixëllonin kur ishin të shpërndarë, të veçuar nga njëri-tjetri. Ai donte që ata të shkëlqenin *përmes jetës së tyre së bashku*.

Ju tregova vargun e vetëm që flet për të ndriçuar si yje. Megjithatë, le ta zhvendosim kamerën. Disa paragrafë përpara këtij vargu, Pali u tha lexuesve të tij se ai donte që ata ta jetonin jetën “denjësisht ndaj ungjillit” (Filipianëve 1:27). Si duket një jetë e denjë për ungjillin?

Për të ndihmuar, Pali pikturon për filipianët dy tablo të një jete të tillë. Tabloja e parë ishte ajo që ai dëshironte të shihte në vetë kishën e Filipisë. Ai u bëri thirrje që të qëndronin të palëkundur në “një frymë të përbashkët”, të luftonin për ungjillin si “një” njeri i vetëm, duke pasur “të njëjtin mendim”, “të njëjtën dashuri”, “një unanimitet dhe një mendje të vetme” (Filipianëve 1:27–2:2).

Kjo është një tablo njëngjyrëshe, apo jo? Jeta e tyre së bashku duhej të kishte ngjyrën e unitetit. Ata duhej të ngjyrosnin me ngjyrën e unitetit, duke iu nënshtuar njëri-tjetrit. Pali vazhdon dhe i urdhëron duke thënë: “Mos bëni asgjë për rivalitet, as për lavdi të kotë...” Përkundrazi, ai u thotë: “...por me përulësi, secili ta çmojë tjetrin më shumë se vetveten”, dhe “Të mos shikojë secili interesin e vet, por edhe atë të të tjerëve” (Filipianëve 2:3–4). Me fjalë të tjera, tabloja e unitetit është një tablo e nënshtimit reciprok.

Megjithatë, përpara se Pali ta përfundojë tablonë e parë, ai ndalon dhe pikturon një tablo të dytë nënshtimi, atë që

ANËTARËSIA E KISHËS

duhej të ishte modeli për të parën. Kur bëhet fjalë për gjithë këtë unitet, nënshtrim dhe dashuri, Pali thotë: “Kini në veten tuaj po atë mendje që ishte edhe në Jezu Krishtin.” Jezu Krishti ishte “në trajtë Perëndie”, por ai “e zbrazi veten e tij, duke marrë trajtë shërbëtori, e u bë i ngjashëm me njerëzit”. Për më tepër, “e përuli veten duke u bërë i bindur deri në vdekje, edhe deri në vdekje të kryqit!”. Prandaj, në mënyrë të mrekullueshme, Perëndia “e lartësoi madhërisht dhe i dhuroi një emër përmbi çdo emër” (Filipianëve 2:5–9).

A e dalloni lidhjen mes këtyre dy tablove? Kjo tablo e dytë është një tablo e ungjillit — Krishti u bë njeri, u kryqëzua dhe u ringjall prej të vdekurish. Krishti bëri atë që vetëm ai mund ta bënte: ai pagoi për mëkatin dhe e mundi vdekjen. Tabloja e parë është ajo e një jete të *denjë* për këtë ungjill. Kjo është një jetë e përkushtuar ndaj dashurisë dhe unitetit me përlulësi mes popullit të Krishtit.

Pali, në fakt, po thotë: “Dëshironi të dini se si duhet të jetojë mes të krishterëve të tjerë dikush që rrëfen se e beson ungjillin? Thjesht shihni Shpëtimtarin tuaj!”.

Në këtë pikë të letrës, Pali i kthehet tablosë së parë. Ai u thotë që të vazhdojnë të binden. Që ta vënë në veprim shpëtimin e tyre me frikë e me dridhje. Të bëjnë gjithçka pa u ankuar dhe pa debatuar. Dhe të jenë të paqortueshëm dhe të panjollë. Atëherë ata do të ndriçojnë “si yjet në qiell” (Filipianëve 2:12–16, Bibla “Së Bashku”, 2023).

Kur të krishterët ndjekin unitetin në kishat e tyre, duke iu nënshtruar njëri-tjetrit, atëherë ato kisha do të vezullojnë si dritat e verandës së një shtëpie në rrugën e errët të një qyteti, si puna e fenerëve në një pyll të errët.

Kjo është një jetë e denjë për ungjillin dhe një kishë e denjë për ungjillin.

Nëse e dini se sa e errët dhe e humbur është kjo botë, ju mund ta dalloni se sa e bukur është kjo tablo. E keni idenë për martesat e prishura, për padrejtësitë raciale, për fëmijët e braktisur, për gjithë ato lloj varësish që i skllavërojnë njerëzit. E keni parë vetminë, lëndimin dhe ankthin. Ju keni përjetuar zemërim, urrejtje, krenari, si edhe vetëmashtrimin dhe vetë-justifikimin që i shoqërojnë të gjitha këto. Disa nga këto gjëra i keni parë te të tjerët; disa i keni parë në veten tuaj.

Ah, sa mirë është që t'i mbani lart këta fenerë vezullues drite në botën e errët! A nuk është kjo ajo që dëshironi që kishat tona të jenë dhe të bëjnë?

TETË MËNYRA PËR T'JU NËNSHTRUAR NJË KISHE VENDORE

Pali e pa në sy kishën filipiane dhe u tha atyre që të nënshtroheshin për të mirën e njëri-tjetrit, ashtu sikurse edhe Krishti e kishte përulur veten për të mirën e tyre.

E njëjta gjë vlen edhe për kishat tona vendore. Ashtu sikurse Krishti e nënshtroi gjithë jetën e tij për të mirën tonë, kështu edhe ne duhet ta nënshtrojmë gjithë jetën tonë për të mirën e njëri-tjetrit. Asnjë prej zonave të jetës sonë nuk është e përjashtuar nga vendosja e interesit të të tjerëve përpara interesit tonë. Në mënyrë specifike, ne duhet t'u përkushtohemi kishave tona në aspektet publike, fizike, sociale, të ndjenjave, financiare, profesionale, etike dhe frymërore.

ANËTARËSIA E KISHËS

Aspekti publik

Së pari, të krishterët duhet t'u nënshtrohen kishave të tyre në aspektin publik, dhe me këtë dua të them formalisht ose zyrtarisht. Ata duhet t'i bashkohen një kishë duke iu përkushtuar trupit vendor të besimtarëve, ku do të marrin rregullisht Darkën e Zotit. Jezusi e identifikoi veten e tij publikisht me kishën e vet. Edhe ne duhet të identifikohemi publikisht me të dhe me popullin e tij — duke iu bashkuar një kishë. (Shihni kapitullin e tetë në lidhje me kuptimin që mund të ketë kjo për kishën e përndjekur.)

Aspekti fizik/gjeografik

Së dyti, të krishterët duhet t'u nënshtrohen kishave të tyre në aspektin fizik dhe ndoshta edhe në atë gjeografik. Ne nënshtrohemi fizikisht duke u mbledhur rregullisht me kishën. Autori i Hebrenjve thotë: “Dhe le të... [mos heqim] dorë nga të mbledhurit tonë, sikurse kanë zakon disa...” (Hebrenjve 10:24-25; si dhe Veprat e Apostujve 2:42-47). Takohuni çdo Ditë të Zotit (Veprat e Apostujve 20:7; 1 e Korintasve 16:2).

Tani, më lejoni t'i bëj gjërat edhe më serioze. Nëse *mundeni*, çmojini të tjerët “më shumë se vetveten” dhe shikoni “edhe [interesin e] të tjerëve”, duke jetuar gjeografikisht afër kishës. Kur jetoni afër një kishë apo një grupi besimtarësh, është më e lehtë që t'i ftoni njerëzit në shtëpi për darkë, të kujdeseni për fëmijët e njëri-tjetrit ndërkohë që bëni punë të tjera, të bëni pazarin për njëri-tjetrin. Me fjalë të tjera, thjesht është më e lehtë që të integrohesh në jetën e përditshme kur ka një afërsi gjeografike — pra, që mund të arrihet edhe në këmbë.

Kur konsiderojnë se cilën shtëpi të blejnë ose cilin apartament të marrin me qira, të krishterët bëjnë mirë të shtrojnë disa nga pyetjet që bëjnë edhe jo të krishterët (Sa kushton? A ka shkolla të mira afër?). Por të krishterët bëjnë mirë gjithashtu që të shtrojnë edhe disa pyetje shtesë:

- A do të më lejojë kredia apo qiraja që të tregohem bujar me të tjerët?
- A do të kenë mundësi të krishterët e tjerë që të vijmë kollaj tek unë për t'u dishepulluar dhe për t'u mikpritur?

Gjatë zhvendosjes së fundit të familjes sime, çështja e nënshtërimit në aspektin gjeografik ndaj kishës erdhi në pikën e zgjedhjes mes dy shtëpive, të cilat ishin të dyja të përballueshme nga çmimi, por ishin shumë të ndryshme në aspektet e tjera. Shtëpia e parë ishte më e re, e projektuar më mirë, më tërheqëse, nuk kishte nevojë për riparime dhe ishte më e lirë. Por ajo ishte tridhjetë minuta me makinë larg nga ndërtesa e kishës, dhe nuk kishim afër anëtarë të kishës. Shtëpia e dytë ishte më e vjetër, më e ftohtë, kishte nevojë për disa riparime si, për shembull, veranda që i kishte dërrasat të kalbura dhe bodrumi që përmytej me raste, dhe ishte më e shtrenjtë. Mirëpo ajo ishte vetëm pesëmbëdhjetë minuta larg nga ndërtesa e kishës, dhe më e rëndësishmja ishte që ne mund të shkonim në këmbë te dymbëdhjetë nga familjet e kishës sonë (dhe tani janë njëzet e katër të tilla). Kërkova këshillën e disa prej pleqve të kishës dhe që të gjithë më këshilluan t'u jepja përparësi marrëdhënieve me kishën. Kjo, në fakt, do të thoshte që të zgjidhnim shtëpinë më të vjetër, më pak tërheqëse dhe më të shtrenjtë.

ANËTARËSIA E KISHËS

Fatmirësisht, këtë bëmë, dhe kjo ka qenë një bekim shumë i madh për familjen tonë! Bashkëshortja ime takohet me nënat e tjera pothuajse çdo ditë. Fëmijët tanë takohen me fëmijët e tyre. Jam takuar me një vëlla çdo mëngjes për t'u lutur dhe për të lexuar Shkrimin për një vit e gjysmë. Dhe familjet e kishës sonë mund të bashkëpunojnë për t'u shërbyer fqinjëve tanë dhe për t'i ungjillëzuar ata.

A duhet që një i krishterë të zhvendoset afër anëtarëve të tjerë të kishës së tij apo të saj? Jo, Bibla nuk na urdhëron që ta bëjmë këtë. Mirëpo kjo është një mënyrë konkrete se si mund ta duam kishën tonë.

A e përuli Jezusi veten fizikisht dhe gjeografikisht për të mirën tonë? Ai la qiellin!

Aspekti social

Së treti, ne duhet të nënshtrohemi në aspektin social. Kishat duhet të jenë më shumë se klube shoqërore, por nuk duhet të jenë më pak se kaq. Miqtë tanë janë ata që ne i imitojmë dhe i ndjekim. Ne harxhojmë para atje ku ata harxhojnë para. I rritim fëmijët tanë ashtu siç i rritin ata fëmijët e tyre. Lutemi ashtu siç luten ata. Miqtë tanë i japin trajtë personit që bëhemi teksa imitojmë njëri-tjetrin (shih Jakobi 4:4; si dhe 1 e Korintasve 15:33).

Komuniteti i kishës vendore duhet të jetë një vend ku të krishterët formojnë dhe e skalitin njëri-tjetrin për mirë, përmes të gjitha dinamikave të miqësisë. Sigurisht që miqtë e krishterë janë të çmuar si brenda, ashtu edhe jashtë së njëjtës kishe vendore. Mirëpo miqtë brenda një kishe vendore do të marrin formë nga e njëjta shërbesë e Fjalës, gjë që do t'u japë

mundësi për ta shtrirë atë shërbesë me më tepër kujdes në jetën e njëri-tjetrit gjatë javës.

Kisha, gjithashtu, duhet të jetë një vend i sigurt, në të cilin mund të dalim jashtë zonave tona të rehatisë shoqërore. Miqësitë duhet të krijohen mes të moshuarve dhe të rinjve, mes të pasurve dhe të varfërve, mes të arsimuarve dhe të paarsimuarve, mes një grupi etnik dhe një tjetri.

A keni dëgjuar ndonjëherë një zë brenda mendjes suaj që ju thotë: “Nuk dua të jem shok me të. Ai nuk është si unë. Ne kemi prejardhje të ndryshme. Nuk na interesojnë të njëjtat gjëra”? Unë për vete e kam dëgjuar. Mirëpo dëgjoni se si mund të përgjigjej Pali: Jezusi nuk e konsideroi barazinë me Perëndinë si diçka pas së cilës të mbahej fort, por e zbrazti veten. Ai ishte Perëndi — jo si ju! Pastaj ai u bë njeri — si ju!

Me të njëjtën përlulësi, çmojini të tjerët më shumë se vetveten kur bëhet fjalë për të zgjedhur miqtë tuaj. Shikoni interesin e tyre dhe jo tuajin.

Aspekti i ndjenjave

Sigurisht që një prej përbërësve të miqësisë është përjetimi i ndjenjave. Të krishterët duhet t’ia nënshtrojnë ndjenjat e tyre njëri-tjetrit. Çfarë më gëzon ose më trishton? Çfarë më bën që të festoj ose të vajtoj?

Dëgjoni çfarë u thotë Pali korintasve: “...të gjitha gjymtyrët të kenë të njëjtin kujdes për njëra-tjetrën. Dhe nëse vuan një gjymtyrë, të gjitha gjymtyrët vuajnë bashkë; kurse po të nderohet një gjymtyrë, të gjitha gjymtyrët gëzohen bashkë me të” (1 e Korintasve 12:25b–26).

Romakëve ai u thotë: “Duajeni njëri-tjetrin me dashuri

ANËTARËSIA E KISHËS

vëllazërore; në nderim t'ia kaloni njëri-tjetrit" (Romakëve 12:10).

Ai na urdhëron që të gëzohemi me vëllanë që ngrihet në detyrë, si dhe për gjithë shpërblimin monetar dhe prestigjin që vjen bashkë me këtë gjë. A mundemi ne? Ai e urdhëron vajzën beqare dyzetvjeçare, e cila dëshiron fort që të martohet, të gëzohet me vajzën njëzetedyvjeçare kur kjo e fundit martohet. A mundet ajo? A mund të vajtojë i varfri me të pasurin kur ai e humb punën e tij? T'u përgjigjesh me "po" këtyre pyetjeve — në vend që t'i thuash "po" rivalitetit dhe lavdisë së kotë — kërkon diçka më të fortë se sentimentit. Kjo kërkon që zemra të ndryshohet nga ungjilli dhe nga Fryma e Shenjtë.

Të përmbushësh urdhërimin e Palit për ta çmuar "tjetrin më shumë se vetveten" me "të njëjtën dashuri" do të thotë të njohësh dashurinë e atij që nuk e konsideroi barazinë me Perëndinë si diçka pas së cilës të mbahej fort, dhe pastaj të duash si ai.

Aspekti financiar

Të krishterët duhet t'u nënshtrohen kishave të tyre vendore edhe në aspektin financiar. Kjo do të duket ndryshe në kontekste të ndryshme. Mirëpo, sido që të bëhet, të krishterët duhet të përpiqen që të gjejnë mënyra për të përmbushur parime biblike si këto:

- "...ndihmoni për nevojat e shenjtoreve, jini mikpritës" (Romakëve 12:13; si dhe Galatasve 2:10; 1 e Gjonit 3:17).
- "Sa për të mbledhurit e ndihmave për shenjtoret, bëni edhe ju ashtu si i urdhërova kishat e Galatisë. Të parën ditë të çdo jave, secili nga ju le të vërë mënjane, dhe të mbledhë aq sa

mundet, që, kur të vij, të mos bëhen atëherë mbledhje ndih-mash” (1 e Korintasve 16:1–2; Romakëve 15:26).

- “Kështu edhe Zoti urdhëroi që ata, që shpallin ungjillin, nga ungjilli të rrojnë” (1 e Korintasve 9:14, si dhe 9:11–13; Mateu 10:10; Luka 10:7; Galatasve 6:6; si dhe 1 e Timoteut 5:17–18).

Aspekti profesional

Të krishterët duhet t’u nënshtrohen kishave të tyre në aspektin profesional. Për disa njerëz, kjo do të thotë të përfshihen në shërbesë me kohë të plotë. Për çdo të krishterë, kjo do të thotë të kuptojmë që jetët e bashkanëtarëve të kishës sonë do të zgjatin në përjetësi, kurse profesionet tona jo.

Njoh burra dhe gra nëpër punë laike të cilët, për hir të shërbimit në kishat e tyre vendore, nuk kanë pranuar ngritje në detyrë dhe as rroga më të larta, të cilët kanë lënë firma më të mëdha dhe më të famshme për të shkuar në firma më të vogla, të cilët nuk kanë dashur të transferohen në një qytet tjetër. Në secilin rast, personi e refuzoi mundësinë, pasi ai ose ajo e dinte që ky ndryshim do ta pengonte në aftësinë për t’u kujdesur për kishën dhe për familjen. Kam njohur gjithashtu të tjerë që nuk kanë pranuar të punojnë ditën e diel ose që kanë lënë punë që ua kërkonin këtë gjë, jo sepse janë të fiksuar pas ditës së shabatit, por sepse kjo është dita kur mbli-dhet kisha.

Meqë ra fjala, disa nga pleqtë më të mirë të kishës që nuk janë pjesë e stafit me pagesë, nuk janë ata që ngjitin shkallët e karrierës, por burrat që janë të gatshëm të zbresin disa shkallë për hir të kishës.

ANËTARËSIA E KISHËS

Aspekti etik

Të krishterët duhet t'u nënshtrohen kishave të tyre edhe në aspektin etik. Kjo nuk do të thotë ta bësh kishën autoritet absolut, ashtu sikurse edhe fëmijët nuk duhet t'i konsiderojnë prindërit në këtë mënyrë. Përkundrazi, të krishterët duhet të shohin drejt kishës për udhëzim, këshillë, llogaridhënie dhe disiplinë etike në çështjet që trajtohen nga Fjala e Perëndisë.

Pali shkruan: “Vëllezër, në qoftë se dikush bie në ndonjë faj, ju që jeni frymërorë, ndërtojeni të tillë në frymën e zemërbutësisë; duke u kujdesur për veten tënde, që të mos tundohesh edhe ti” (Galatasve 6:1). Juda thotë: “...shpëtojeni të tjerët me frikë, duke ia rrëmbyer zjarrit...” (Juda 23). Kisha vendore është vendi parësor ku ne përpiqemi që t'i ndihmojmë besimtarët për të luftuar kundër mëkatit të tyre dhe ku ne, gjithashtu, duhet të jemi të hapur për të marrë të njëjtën ndihmë.

Por në qoftë se vëllai yt ka mëkatuar kundër teje, shko dhe qortoje vetëm për vetëm; në qoftë se të dëgjon, e fitove vëllanë tënd; por në qoftë se nuk të dëgjon, merr me vete edhe një ose dy vetë, që çdo fjalë të vërtetohet nga goja e dy ose tre dëshmitarëve. Nëse pastaj refuzon t'i dëgjojë, thuaja kishës... (Mateu 18:15-17).

E gjitha kjo është pjesë e asaj se çfarë do të thotë t'i nënshtrohesh kishës sate vendore në aspektin etik.

Aspekti frymëror

Së fundi, të krishterët duhet t'i nënshtrohen një kishe vendore në aspektin frymëror. Me këtë dua të them tri gjëra specifike:

- Së pari, ky komunitet është vendi ku ne duhet të përpiqemi

që t'i ushtrojmë dhuntitë tona frymërore. Pali vëzhgoi dhe tha: “Dhe secilit i jepet shfaqja e Frymës për dobinë e përbashkët” (1 e Korintasve 12:7).

- Së dyti, kisha vendore është komuniteti ku të krishterët duhet ta ndërtojnë njëri-tjetrin në besim përmes Fjalës së Perëndisë. Juda shkruan: “Por ju, të dashur, duke ndërtuar veten tuaj mbi besimin tuaj shumë të shenjtë, duke u lutur në Frymën e Shenjtë, mbahuni në dashurinë e Perëndisë, duke pritur mëshirën e Zotit tonë, Jezu Krisht, për jetën e përhjetshme” (Juda 20–21; si dhe Efesianëve 4:11–32; Hebrenjve 10:25).
- Së treti, këta janë njerëzit për të cilët duhet të ndërmjetësojmë rregullisht në lutjet tona.

T'I NËNSHTROHESH SË SHËMTUARËS

E vërteta është që njerëzit nuk kanë frikë të nënshtrohen. Ata thjesht duan t'i nënshtrohen bukurisë, ashtu si trimi guximtar që ia nënshtrohet veten çlirimit të zonjushës që është në rrezik.

Ajo që është e pazakontë për krishterimin, është që heroi i tij nuk rrezikon gjithçka për një bukuroshe, por për atë që Bibla e krahason me një grua të përdalë. Pastaj, të gjithë ata që ai i shpëton, i thërret që t'i nënshtrohen kësaj gruaje të përdalë — nuses së tij, e cila është ende duke u bërë gati, pra, kishës.

Mirëpo nënshttrimi ndaj së shëmtuarës është ajo që i frikëson me të vërtetë njerëzit. Kështu mund të jetë edhe nënshttrimi ndaj kishës vendore. Kishat janë të mbushura me mëkatarë vizionet e të cilëve në lidhje me lavdinë bien ndesh me vizionin tonë. Megjithatë, kjo është mënyra se si na deshi Krishti: “...sikurse unë ju kam dashur ju, ashtu edhe ju ta doni njëri-tjetrin” (Gjoni 13:34).

ANËTARËSIA E KISHËS

Dashuria e Krishtit e transformon në mënyrë të mrekullueshme të shëmtuarën në të bukur (shih Efesianëve 5:22-31). Dashuria jonë për njëri-tjetrin duhet të bëjë të njëjtën gjë — ta ndihmojë të shëmtuarin të bëhet i bukur.

Kush mund të dojë kështu? Vetëm ata sytë e të cilëve janë hapur dhe zemrat e të cilëve janë çliruar nga skllavëria e dashurisë për këtë botë: “Pra, nëse Biri do t’ju bëjë të lirë, do të jeni me të vërtetë të lirë” (Gjoni 8:36).

Si duhet të lidhen anëtarët me pastorët?

Çdo anëtar kishe do të dalë përpara fronit të Perëndisë dhe do të japë llogari për mënyrën se si ai apo ajo punoi për ta mbrojtur ungjillin në jetët e bashkanëtarëve të kishës së vet (shih Galatasve 1). Tani që e kemi thënë këtë, duhet të shtojmë që Fryma e Shenjtë i ka bërë pastorët dhe pleqtë mbikëqyrës të kishës (Veprat e Apostujve 20:28; Titit 1:7; 1 e Pjetrit 5:2). Kjo do të thotë që pleqtë përfaqësojnë punën mbikëqyrëse të kishës në jetën e përditshme të bashkësisë. Të nënshtrohesh ndaj kishës shpesh do të thotë të nënshtrohesh ndaj udhëheqësve të saj. Nëse flasim në mënyrë të përgjithshme, si duhet të lidhen anëtarët me pastorët e tyre?

1. *Anëtarët duhet t'i afirmojnë zyrtarisht pastorët e tyre.* Tradita të ndryshme nuk bien dakord për këtë gjë, por unë besoj se, përderisa të krishterët, në fund të fundit, janë përgjegjës përpara Perëndisë për atë që u mësohet (shih Galatasve 1), anëtarët e kishës janë përgjegjës për të zgjedhur udhëheqësit e tyre. Bashkësitë duhet t'i lënë pleqtë që ta udhëheqin procesin, por miratimi final i takon kishës. (Mund të jetë gjithashtu e vërtetë që autoriteti i kishës për t'i afirmuar udhëheqësit e saj është një autoritet apostolik, të cilin ajo e trashëgon përmes çelësve

apostolikë. Shih Veprat e Apostujve 14:23; shih gjithashtu rolin e bashkësisë të Veprat e Apostujve 1 dhe 6.)

2. *Anëtarët duhet t'i nderojnë pastorët e tyre.* Aftësia e kulturës sonë për ta kuptuar nderimin duket sikur po pakësohet vazhdimisht. Por, ashtu sikurse Bibla u bën thirrje fëmijëve që t'i nderojnë prindërit e tyre, po kështu të krishterët duhet t'i nderojnë pastorët e tyre. Madje Bibla thotë që ata të “nderohen dyfish” (1 e Timoteut 5:17). Këtu përfshihet edhe sigurimi i një pagese për ta (5:18).
3. *Anëtarët duhet t'u nënshtrohen pastorëve të tyre.* Këto dy vargje të Hebrenjve duhet të përfshihen në të kuptuarit tonë për jetën e krishterë: “Kujtoni udhëheqësit tuaj, që ju thanë fjalën e Perëndisë dhe, duke vështruar rezultatin e sjelljes së tyre, imitoni besimin e tyre” (Hebrenjve 13:7). “Dëgjoni udhëheqësit tuaj dhe bindjuni, sepse ata rrinë syhapur mbi shpirtat tuaj, si ata që duhet të japin llogari; që ta bëjnë këtë me gëzim dhe jo me psherëtima, sepse kjo nuk do t'ju sillte dobi” (Hebrenjve 13:17).
4. *Anëtarët duhet të luten për pastorët e tyre.* Këta janë burrat që me jetën dhe mësimin e tyre e ndihmojnë dhe e forcojnë kishën. A nuk do të ishte në dobinë tonë që të luteshim për ta?
5. *Anëtarët duhet të ngrenë padi kundër pastorëve që e kanë skualifikuar veten.* Meqë ata janë përpara kishës,

Pali i mbron udhëheqësit duke kërkuar që çdo padi kundër tyre të ngrihet vetëm kur ka dy ose tre dëshmitarë (1 e Timoteut 5:19). Pasi e kemi thënë këtë, bashkësia *nuk duhet* të lejojë që një plak kishe, i cili e ka skualifikuar veten, të vazhdojë të shërbejë.

6. *Anëtarët duhet t'i heqin nga detyra pastorët që e mohojnë ungjillin.* Kur mësuesit e rremë hynë në kishën e Galatisë, Pali nuk qortoi pleqtë. Ai qortoi kishën. Kur pastorët nisin ta mohojnë ungjillin ose të japin mësim herezi të tjera, Perëndia u bën thirrje anëtarëve të kishës që t'i heqin ata nga roli i tyre.

ÇFARË NDODH KUR ANËTARËT NUK E PËRFAQËSOJNË JEZUSIN?

Nëse do të vizitonit bibliotekën vendore dhe do të hapnit numrin e parë të rregullt të *U.S. News & World Report* të botuar pas 11 shtatorit 2001, do të gjenit fotografinë e një burri të ulur në shkallët e Ndërtesës së Qeverisë së SHBA-së dhe duke mbajtur në dorë një flamur amerikan.¹ Emri i tij është Hermono ose Mono për shkurt. Mono-ja nuk ka mbiemër, prandaj te vendi për mbiemrin në patentën e tij të shoferit thuhet: “Lnu [Mnd]”, që do të thotë “mbiemri nuk dihet”. Mono-ja është qytetar i Indonezisë, e megjithatë, ai është një patriot i flaktë amerikan.

Mono-ja kishte qenë në Amerikë për disa vjet kur një krishterë i quajtur Doug e takoi në një qendër tregtare në Washington, DC. Ishte 4 korrik 2001 dhe Mono-ja po kënaqej me fishekzjarrët. Doug-u kishte plane të tjera. Ai i shpalli ungjillin Mono-s. Për mrekulli, Mono-ja dëgjoi dhe besoi. Ai lindi sërish.

Disa muaj më vonë, kisha ime e pagëzoi dhe e bëri anëtar. Gjërat ishin bërë zyrtare. Lajmëroni zyrën e shtypit dhe thua-juni kombeve: ky është një qytetar i ri i mbretërisë së Krishtit.

ANËTARËSIA E KISHËS

Kisha u kënaq me entuziazmin, mirësinë dhe bujarinë e Mono-s. Në një rast të caktuar, ai bleu një komplet pjatash thjesht që të kishte mundësi për të shtruar një darkë për të gjithë burrat e kishës, të cilët kishin kontribuar në dishepullimin e tij në Krishtin. Ai e donte kishën dhe kisha e donte atë.

Dikur gjatë vjeshtës, pasi ai iu bashkua kishës, pleqtë e kishës mësuuan që Mono-ja po punonte ilegalisht në vendin tonë. Ai i kishte gënjyer në lidhje me statusin e punës së tij dhe po vazhdonte ta gënjente punëdhënësin e tij, i cili besonte se ai kishte ardhur në mënyrë të ligjshme. Kishte opinione të ndryshme për mënyrën se si duhej të reagonim ndaj statusit të emigrimit të paligjshëm, duke qenë se qeveria e SHBA-së nuk po i përforconte ligjet e caktuara. Mirëpo një gjë ishte e qartë: të krishterët nuk duhet t'i gënjejnë punëdhënësit e tyre duke e falsifikuar statusin e tyre të punësimit. Jezusi nuk gënjen, dhe sigurisht që as nuk e ka zakon të gënjejë — dhe kështu duhet të jetë edhe me përfaqësuesit e tij.

Për disa muaj, kisha iu përgjërua Mono-s që të tregonte të vërtetën. Ajo u përpoq ta ndihmonte nga ana financiare. Ai vazhdonte të refuzonte. Disa herë dukej sikur ai do të dorëzohej, por pastaj tërhiqej sërish, dhe ishte i vendosur që të rrinte në SHBA me çdo kusht. Filloi të dukej sikur ai çmonte më tepër Amerikën sesa Fjalën e Perëndisë.

Më në fund, me një zemër të thyer, kisha e disiplinoi dhe e shkishëroi Mono-n, për shkak se ai refuzonte që ta thoshte të vërtetën. Ata i thanë se nuk mund ta quanin më të krishterë dhe nuk do ta afirmonin qytetarinë e tij në mbretëri. Ata e udhëzuan që të mos e merrte më Darkën e Zotit. Kisha e hoqi nga anëtarësia.

Kjo ishte një ditë e trishtueshme për kishën.

ÇFARË ËSHTË DISIPLINA E KISHËS?

Çfarë është disiplina e kishës? Në terma të përgjithshëm, disiplina e kishës është një pjesë e procesit të dishepullimit, pjesa ku ne korrigjojmë mëkatin dhe e drejtojmë dishepullin në një shteg më të mirë. Të *dishepullohesh*, mes shumë gjërash të tjera, do të thotë edhe të *disiplinohesh*. Një i krishterë disiplinohet përmes udhëzimit dhe korrigjimit, ashtu si në një orë matematike ku mësuesi jep mësimin dhe pastaj korrigjon gabimet e nxënësve. Pra, në mënyrë joformale, disiplina e kishës fillon me një fjalë private këshillimi ndaj një vëllai që po mëkaton.

Në terma edhe më specifike dhe formale, disiplina e kishës është akti i heqjes së një individi nga anëtarësia dhe pjesëmarrja në Darkën e Zotit. Kisha nuk i thotë personit që të mos vijë më në takimet publike. Kisha dëshiron që personi të vijë dhe ta dëgjojë Fjalën e Perëndisë të predikohet. Përkundrazi, kisha po thotë që ajo nuk mund ta afirmojë më rrëfimin e besimit të atij personi dhe, për këtë arsye, ajo refuzon që t'i japë Darkën e Zotit. Ky është shkishërimi ose nxjerrja e personit nga përbashkësia.

Përveç Mateut 18 (shih kapitullin e tretë), ndoshta pasazhi më i njohur mbi disiplinën e kishës është 1 e Korintasve 5. Atje Pali e qorton kishën e Korintit se është krekosur që e ka toleruar një burrë i cili “ka gruan e babait të vet”. Ai u thotë atyre: “...të hiqet nga mesi juaj...”, pra, ky burrë (1 e Korintasve 5:2), që ta gjykonin atë (1 e Korintasve 5:12), ta nxirrnin nga bashkësia e tyre (1 e Korintasve 5:13), që “t'i dorëzohet ai Satanit” (1 e Korintasve 5:5) domethënë, në mbretërinë e Satanit, e cila është kjo botë. Ai nuk mund të konsiderohet

ANËTARËSIA E KISHËS

më si një qytetar i mbretërisë së Perëndisë, jo për aq kohë sa ai jeton kështu.

Mbani mend, të jesh anëtar kishë, do të thotë të jesh përfaqësues i Jezusit. Prandaj, disiplina është shtegu i duhur i veprimit kur karakteri i përfaqësimit nga një person sjell turp mbi emrin e Jezusit.

CILI ËSHTË QËLLIMI I DISIPLINËS SË KISHËS?

Disiplina e kishës ka të paktën pesë qëllime. Së pari, disiplina ka për qëllim ta *ekspozojë* mëkatin. Mëkatit, ashtu si kancerit, i pëlqen të fshihet. Disiplina e ekspozon kancerin, që ai të mund të hiqet tej sa më shpejt (shih 1 e Korintasve 5:2).

Së dyti, disiplina ka për qëllim të *paralajmërojë*. Kisha nuk ushtron gjykimin e Perëndisë përmes disiplinës së saj. Përkundrazi, ajo jep një shfaqje të vogël, e cila portretizon gjykimin e madh që do të vijë (1 e Korintasve 5:5).

Së treti, disiplina ka për qëllim të *shpëtojë*. Kishat e ushtrojnë disiplinën kur shohin që një anëtar po ndjek shtegun drejt vdekjes dhe kur asnjë nga përgjërimet dhe paralajmërimet e tyre nuk e kthen personin nga rruga e tij. Disiplina është mjeti i fundit (1 e Korintasve 5:5).

Së katërti, disiplina ka për qëllim të *mbrojtë*. Ashtu si kanceri që përhapet nga një qelizë te tjetra, po kështu edhe mëkati përhapet shpejt nga një person te tjetri (1 e Korintasve 5:6).

Së pesti, disiplina ka për qëllim të *shfaqë një dëshmi të mirë për Jezusin*. Është e habitshme ta themi, por disiplina e kishës, në fakt, është e mirë për jobesimtarët, sepse ajo ndihmon në ruajtjen e tiparit tërheqës të popullit të Perëndisë (shih 1 e Korintasve 5:1). Mbani mend, kishat duhet të jenë kripë dhe

dritë. Jezusi tha: “...në qoftë se kripa bëhet e amësht, me se mund ta rifitojë shijen? Nuk vlen më për asgjë, veçse për t’u hedhur jashtë dhe për t’u shkelur nga njerëzit” (Mateu 5:13).

Mono-ja e fshehu mëkatën e tij në errësirë. Ai nuk donte që gënjeshtria e tij të ekspozohej. Kur ajo u ekspozua, ai nuk donte ta trajtonte si mëkat. Ai donte ta trajtonte si “të pashmangshme” ose “të nevojshme”, ose “jo dhe aq të keqe”. Mirëpo ai kishte mashtruar veten për shkak të një zemre që dëshironte diçka tjetër më tepër se Jezusin dhe Fjalën e tij.

E nxitur nga dashuria, kisha nuk donte që ai ose të tjerët të mashtroheshin. Kisha donte ta paralajmëronte atë, ta shpëronte, t’i mbronte besimtarët e rinj që mund të tundoheshin për ta justifikuar gënjeshtrenë si të arsyeshme, dhe t’u tregonte dashuri fqinjëve të saj duke e ruajtur veçantinë dalluese të kishës.

Prandaj, kisha, përmes disiplinës së saj, e nxori në pah dashurinë e tij të vërtetë, duke e lënë atë në zgjedhjet e tij. Në fund, kisha nuk bëri asgjë më shumë dhe as më pak sesa të shpallte: “Ti nuk po zgjedh Jezusin, prandaj nuk duhet të jesh me Jezusin.”

Sigurisht, qëllimi themelor në çdo akt discipline duhet të jetë dashuria: *dashuria për personin, dashuria për kishën, dashuria për botën që na sheh, dashuria për Krishtin*.

Në fund të fundit, Perëndia “ndreq atë që do”; dhe “fshikullon çdo bir që ai pranon” (Hebrenjve 12:6). Duke hequr dorë nga disiplina, ne pretendojmë se duam më mirë se Perëndia.

I nxitur nga dashuria, Perëndia e di që disiplina sjell jetë, rritje, dhe shëndet: “...ai [Perëndia, na ndreq] për të mirën tonë, që të bëhemi pjesëtarë të shenjtërisë së tij” (Hebrenjve 12:10).

ANËTARËSIA E KISHËS

Po, disiplina shkakton dhimbje, por ka një shpërblim: “Por çdo ndreqje aty për aty, nuk duket se sjell gëzim, po hidhërim; por më pas u kthen një fryt të paqshëm drejtësie atyre që janë ushtruar me anë të saj” (Hebrenjve 12:11).

KUR DUHET QË NJË KISHË TA PRAKTIKOJË DISIPLINËN?

Përgjigjja e shkurtër është kjo: një kishë duhet ta praktikojë disipelinën kur dikush mëkaton. Anëtarët e kishës duhet të mësojnë aftësinë për ta ballafaquar mëkatin privatisht dhe me butësi. Kjo nuk do të thotë që duhet të ngrini varenë dhe ta godisni një vëlla sa herë që ai shfaq edhe devijimin më të vogël. Shpesh më e mira është që të mos thoni asgjë. Dhe në rastet kur të thoni diçka, zakonisht është më mirë të filloni duke bërë pyetje, duke u siguruar që i keni mësuar faktet si duhet dhe që po e trajtoni personin me supozimin që ai po u thotë të vërtetën. Megjithatë, kishat duhet të kultivojnë ato lloje marrëdhëniesh në të cilat korrigjimi jozyrtar të shihet dhe të pranohet — si një akt dashurie.

Disiplina formale nga e gjithë bashkësia rezervohet për mëkate aq të rënda, për të cilat kisha mendon se nuk është më në gjendje që ta afirmojë rrëfimin e besimit të një personi. Personi vazhdon ta quajë veten e tij apo të saj të krishterë dhe përfaqësues të Jezusit, por fjalët e tij apo të saj nuk janë më të besueshme, për shkak të natyrës së mëkatit të tij.

Më lejoni që ta them kështu: ekziston diku një vijë ndarëse mes mëkateve dhe zakoneve mëkatore të cilat i prisni t'i shihni te të krishterët dhe atyre mëkateve dhe zakoneve mëkatore të cilat ju bëjnë të mendoni se, nëse dikush i bën, ai nuk është i krishterë. Ju mund të thoni se disiplina e kishës është me vend

kur dikush kalon nga njëra sferë te tjetra. Nuk po flasim për ato gjëra që na bezdisin ne personalisht; përkundrazi, këto janë ato lloj gjërash që i sheh e gjithë asambleja dhe bie dakord se ato janë gjëra skualifikuese. Fjalët e personit nuk mund të besohen më. Rrëfimi i tij e ka humbur besueshmërinë e tij. Ai mund të pretendojë se është “i penduar” ose “thjesht mirë”, ose “që nuk po tregon mosbindje dhe aq të madhe”, por, cilado qoftë arsyeya, kisha nuk mund ta besojë më atë person. Prandaj, ajo e tërheq afirmimin e saj publik, duke mos e lejuar që ai të marrë Darkën e Zotit. Kjo ia heq atij pasaportën dhe shpall që kisha nuk mund ta afirmojë më zyrtarisht qytetarinë e atij personi në mbretërinë e Krishtit.

Për shembull, dikush mund të thotë se ka një dallim mes një gënjeshtre të rastit për të cilën personi pendohet, dhe një gënjeshtre mbi të cilën personi ngre jetën e tij dhe refuzon të heqë dorë prej saj. Rasti i dytë ishte ai i Mono-s.

A do të thotë kjo që kishat duhet të njohin zemrat e njerëzve? Sigurisht që jo. Perëndia nuk na ka dhënë sy për të parë zemrat. Mirëpo Perëndia i thërret kishat që të shqyrtojnë frytin e jetës së individit dhe të japin një gjykim (Pali përdor pikërisht këtë fjalë — 1 e Korintasve 5:12; krahaso me Mateu 3:8; 7:16–20; 12:33; 21:43).

A mund të themi ndonjë gjë më konkrete për faktin se ku qëndron kjo vijë mes njëres sferë dhe tjetrës? Unë besoj se mund të themi që disiplina formale e kishës kërkohet në rastet e mëkatit të dukshëm, serioz dhe për të cilin nuk është treguar *pendim*. Së pari, mëkati duhet të ketë një manifestim të dukshëm. Kishat nuk duhet t’i bien alarmit për ta përjash-tuar dikë sa herë që dyshojnë për lakmi ose krenari në zemrën

ANËTARËSIA E KISHËS

e tij. Duhet të jetë diçka që mund të shihet me sy ose të dëgjo-
het me veshë.

Së dyti, mëkati duhet të jetë *serioz*. Jo çdo mëkat duhet të trajtohet me masat përfundimtare. Në jetën e një kishe duhet të ketë një hapësirë në të cilën dashuria të mbulojë “një shu-
micë mëkatesh” (1 e Pjetrit 4:8). Fatmirësisht, Perëndia nuk na disiplinon hapur sa herë që mëkatojmë.

Së fundi, mëkati duhet të jetë një mëkat për të cilin per-
soni *nuk është penduar*. Personi në fjalë është ballafaquar me urdhërimet e Perëndisë në Shkrim, por ai ose ajo refuzon ta braktisë mëkatin. Me aq sa shohim, duket që personi e çmon mëkatin më shumë se Jezusin.

Megjithatë, ka disa raste kur një person mund të kërkojë ndjesë dhe të thotë se është i penduar, por kisha me të drejtë mund të vendosë që të vazhdojë me disiplinën. Unë besoj se kjo është e pranueshme kur, për një arsye apo për një tjetër, kisha thjesht nuk mund t’u zërë besë fjalëve të personit. Ndoshta personi karakterizohet nga zakoni i gënjeshtërs. Ndoshta mëkati është aq i qëllimshëm (si një zakon i zgja-
tur abuzimi ose vrasje me paramendim) ose aq i neverit-
shëm (si puna e përdhunimit), saqë çdo fjalë e thënë shpejt për të kërkuar falje është e pabesueshme. Nuk po themi që mëkate të tilla nuk mund të falen, por duhet të kalojë ca kohë, në mënyrë që fryti i pendimit të shfaqet përpara se kisha të mund ta shpallë faljen me përgjegjësi (shih shembullin te Veprat e Apostujve 8:17-24). Nga ana tjetër, kur një kishë bin-
det që një person është me të vërtetë i penduar, ajo nuk duhet ta vazhdojë procesin zyrtar të disiplinës (dhe nuk më vjen në mendje asnjë përjashtim i vetëm nga ky parim).

SI DUHET TA PRAKTIKOJË KISHA DISIPLINËN?

Mateu 18 përshkruan procesin bazë të disiplinës, duke kaluar nga një person, te disa dhe pastaj tek e gjithë kisha. Shqetësimi bazë i Jezusit në këtë pasazh është që procesi të mos zgjatet dhe të mos zgjerohet më tepër nga sa është e nevojshme për të sjellë pajtim.

Ndonjëherë proceset e disiplinës duhet të lëvizin shumë ngadalë, sidomos kur personi tregon interes për ta luftuar mëkatit. Ndonjëherë proceset e disiplinës duhen shpejtuar, si në rastin e 1 e Korintasve 5, ku mëkati i atij burri ishte aq flagrant dhe dukej hapur që ai nuk ishte penduar.

Po kështu nuk duhet të merret parasysh vetëm natyra e mëkatit, por edhe natyra e vetë mëkatarit. Le ta themi shkoqur, mëkatarë të ndryshëm kanë nevojë për strategji të ndryshme (1 e Thesalonikasve 5:14).

Anëtarët e kishës shpesh vrasin mendjen se si ta trajtojnë dikë që është disiplinuar. Dhiata e Re e trajton këtë gjë në disa vende (1 e Korintasve 5:9, 11; 2 e Thesalonikasve 3:6, 14–15; 2 e Timoteut 3:5; Titit 3:10; 2 e Gjonit 10). Këshilla bazë që japin pleqtë e kishës sime është që natyra e përgjithshme e marrëdhënies së anëtarëve me personin e disiplinuar duhet të ndryshojë dukshëm. Ndërveprimet nuk duhet të karakterizohen nga shkujdesja, por nga biseda të qëllimshme për pendimin. Sigurisht që anëtarët e familjes duhet të vazhdojnë t'i përmbushin detyrimet familjare (shih Efesianëve 6:1–3; 1 e Timoteut 5:8; 1 e Pjetrit 3:1–2).

Kur ndodh ripërtëritja në përbashkësinë e kishës? Kur mëkatarit pendohet. Ndonjëherë pendimi është shumë i dukshëm, si në rastin e burrit që ka braktisur bashkëshorten e

ANËTARËSIA E KISHËS

tij. Ai duhet të rikthehet. Ndonjëherë pendimi nuk është aq i dukshëm, si në rastin e dikujt që ka rënë në një cikël varësie, dhe kërkohet shumë urtësi.

Sapo kisha të vendosë që ta ripërtërijë një individ të penduar në përbashkësinë e saj dhe në Darkën e Zotit, nuk duhet të flitet më për ndonjë periudhë prove apo për një status më të ulët qytetarie. Përkundrazi, kisha duhet ta shpallë publikisht faljen e saj (Gjoni 20:23), ta afirmojë dashurinë e saj për personin e penduar (2 e Korintasve 2:8), dhe të festojë (Luka 15:24).

MË E MENÇUR SE URTËSIA E NJERIUT

Kur kishat fillojnë të praktikojnë disiplinë, shpesh përballen me situata të ndërlikuara, për të cilat nuk ka raste studimi në Shkrim që mund t'i ndjekin. Mirëpo shqetësimi më i madh i kishës duhet të jetë që të ruajë reputacionin e Krishtit. Ajo e bën këtë gjë duke shqyrtuar me kujdes nëse mund të vazhdojë ta afirmojë rrëfimin verbal të dikujt, jeta e të cilit e keqprezanton së tepërmi Krishtin. Në fakt, ruajtja e reputacionit të Krishtit është gjëja më e dashur për mëkatarin, për kishën dhe për kombet.

Disiplina kishtare, në fakt, doli që ishte gjëja më e dashur për Mono-n dhe për kombin e Indonezisë. Ca kohë pas shkishërimit të tij, Mono-ja u bind thellë për mëkatin e tij, bleu një biletë avioni dhe u kthye në Indonezi. Rreth një vit më vonë, ai i shkroi një email njërit prej pastorëve të kishës sime:

Andy, faleminderit për këtë email kaq inkurajues që më dërgove. Falënderoj kishën që gjithmonë më kujton dhe vazhdon të lutet për mua. Më duhet të rrëfej që u largova nga kisha në

ÇFARË NDODH KUR ANËTARËT NUK E PËRFAQËSOJNË JEZUSIN?

një mënyrë të mëkatshme dhe pa i sqaruar gjërat, dhe gjëja më e trishtueshme ishte që nuk më bënte përshtypje. Duhej të kisha mësuar që ta përulja veten dhe të vija te ju për pajtim. A jemi armiq për njëri-tjetrin? Jo, ne jemi vëllezër të krishterë. Isha shumë krenar dhe kokëfortë. Krenaria më bëri të mendoja se vetëm Perëndia do ta sqaronte këtë punë dhe se unë s'kisha nevojë të ndërmerrija ndonjë veprim. Pastaj ndoqa shtegun tim. Cili qe rezultati? Nuk gjeta paqe... tani e di pse Perëndia më ktheu në shtëpi, sepse aty më priste një çmim i përjetshëm. Do të doja që të kisha mundësi t'ju përshkruaja se ç'lloj marrëdhënieje kam sot me Të. Është shumë e bukur për t'ju përshkruar... Andy, kam qenë duke u lutur që ky pajtim të ndodhë, por, të lutem, më trego se si të veproj. Dëshiroj të ribashkohem me familjen time. Së fundi, përcillua falënderimet e mia anëtarëve të kishës dhe pleqve. Më ka marrë malli për ju.

Me shumë dashuri,
Mono

Prandaj dhe kisha jonë iu përgjigj plot gëzim:

Mono,

Sa mirë që u lidhëm sërish me ty. Dëshiroj të të tregoj se mbrëmë në takimin e anëtarëve të kishës u lexuam atyre një pjesë të email-it tënd... të gjithë u prekën dhe u inkurajuan nga fjalët dhe veprimet e tua.

Anëtarësia votoi unanimisht për ta afirmuar deklaratën e mëposhtme të përgatitur nga pleqtë:

Deklaratë: Pleqtë e Kishës Biblike Capitol Hill rekomandojnë me gëzim që anëtarët e kishës ta pranojnë me falënderim para Perëndisë pendimin e vëllait tonë, Mono-s, saqë ia shprehim atij zyrtarisht faljen tonë për veprimet e tij ndaj nesh, dhe se, në mënyrë publike, po e ripërtërijmë shprehjen

ANËTARËSIA E KISHËS

tonë të përbashkësisë me të dhe dashurinë tonë ndaj tij si vëlla në Krishtin. Të gjithë këtë e bëjmë me falënderim të madh ndaj Perëndisë për besnikërinë e tij ndaj Fjalës së tij dhe ndaj atyre që e nderojnë atë me bindjen e tyre.

Pastaj u lutëm si bashkësi për ty dhe kërkuam që bekimet më të çmuara të Perëndisë të jenë mbi ty, mbi jetën dhe mbi punën tënde.

Perëndia vazhdoftë të të inkurajojë dhe të të forcojë teksa ti e ndjek atë.

Vëllai yt në Krishtin,
Andy

Mono-ja tani shërben si ungjilltar mes popujve mysli-manë në Indonezi.

Kështu, kisha veproi, Mono-ja u pendua, Perëndia u përlëvdua, dhe tani një komb në anën tjetër të globit po përjeton dobinë e këtij procesi.

A nuk është marrëzia e Perëndisë më e mençur se urtësia e njeriut?

Jezusi mbretëron.

Kur nuk duhet të nënshtroheni

Me raste, të gjithëve ne do të na bëhet thirrje për t'i duruar me përlulësi gabimet dhe mëkatet e një udhëheqësi. Megjithatë, nëse e gjeni veten në një kishë ku udhëheqja karakterizohet nga abuzimi, në shumicën e rasteve, unë do t'ju inkurajoja që të largoheshit. Largohuni për të mbrojtur dishepullimin tuaj, për të mbrojtur familjen tuaj, për t'u dhënë një shembull të mirë anëtarëve që po lini pas dhe për t'u shërbyer fqinjëve jobesimtarë, duke mos i dhënë besueshmëri shërbesës së asaj kishe.

Si ta dalloni udhëheqjen abuzuese? Pali kërkon dy dëshmitarë sa herë që ngrihet një padi kundër një plakut kishe (1 e Timoteut 5:19), ndoshta ngaqë ai e di se udhëheqësit do të paditen për shkak të pakënaqësive më tepër se të tjerët dhe shpesh në mënyrë të padrejtë. Tani që e kemi thënë këtë, duhet të themi që kishat abuzuese dhe udhëheqësit e krishterë abuzues *në mënyrë karakteristike*

- Japin udhëzime dogmatike për çështje për të cilat Shkrimi nuk thotë gjë.
- Mbështeten tek inteligjenca, humori, sharmi, faji, emocionet ose kërcënimet, në vend që të mbështeten te Fjala e Perëndisë dhe te lutja (shih Veprat e Apostujve 6:4).
- Zgjedhin të preferuarit e tyre.
- I ndëshkojnë ata që nuk bien dakord.

ÇFARË NDOH KUR ANËTARËT NUK E PËRFAQËSOJNË JEZUSIN?

- Përdorin forma ekstreme komunikimi (shpërthime, trajtime me heshtje).
- Rekomandojnë një sërë veprimesh të cilat, në njëfarë mënyre, gjithmonë e përmirësojnë situatën e udhëheqësit, madje edhe në kurriz të të tjerëve.
- Flasin shpesh dhe shpejt.
- Rrallëherë i bëjnë në fshehtësi veprat e mira.
- Rrallëherë inkurajojnë.
- Rrallëherë supozojnë se njerëzit po thonë të vërtetën.
- Theksojnë përshtatjen e jashtme, në vend të pendimit të zemrës.
- Predikojnë, këshillojnë dhe e mbikëqyrin kishën e tyre me buzë dhe nuk arrijnë ta themelojnë gjithçka mbi atë që Krishti ka bërë në ungjill dhe t'i japin lavdi Perëndisë.

A DUHET QË ANËTARËSIA TË DUKET KUDO NJËLLOJ?

Kisha nuk ka emër. Ajo nuk ka ndërtesë. Ajo nuk njihet nga qyteti, për shkak se qeveria do ta mbyllte menjëherë nëse do ta dinte që ekzistonte.

Kisha takohet në shtëpinë e një prej anëtarëve në një qytet të Azisë Qendrore, ku pothuajse të gjithë janë myslimanë. Ajo ka tetë deri në dhjetë anëtarë, dhe nuk do të rritet në më shumë se njëzet anëtarë. Kur kjo ndodh, kisha duhet të ndahet. Shtëpitë janë shumë të vogla, dhe më e rëndësishmja është që të krishterët në këtë vend nuk duhet të bien në sy të autoriteteve të qytetit dhe të klerikëve myslimanë.

Kisha takohet çdo të diel me dy pleqtë e saj “Frenkun” dhe “Hansin”, për t’u lutur, për të kënduar dhe për të mësuar nga Bibla. Që të dy këta burra janë kthyer në besim brenda dhjetë viteve të fundit dhe pjesën më të madhe të gjërave që dinë për Biblën i kanë mësuar nga dy apo tre misionarë.

Pyetja që duam të bëjmë në këtë kapitull është kjo: A duhet që kisha e Frenkut dhe Hansit ta praktikojë anëtarësinë njëlloj si një kishë në një qytet perëndimor me popullsi të

ANËTARËSIA E KISHËS

madhe si Washington, DC, aty ku unë vetë jam në kishë? A duhet që anëtarësia të duket kudo njëlloj?

A DO TË DUKET ANËTARËSIA KUDO NJËLLOJ?

Përgjigjja më e thjeshtë është “po” dhe “jo”. Le të fillojmë me “po”-në. Anëtarësia do të duket kudo njëlloj, sepse kisha e themeluar nga Jezusi është vetë anëtarësia e saj. Jezusi i ka dhënë çdo kishe, kudo që të jetë, *të njëjtat mjete* për të përmbushur *të njëjtën detyrë*.

- Detyra: të jetë një shoqëri e dallueshme dhe e përcaktuar qartë, që, përmes vetë dallueshmërisë së saj, t’i bekojë kombet dhe t’i sjellë lavdërim Atit qiellor (Mateu 5:3–16).
- Mjetet: autoriteti për ta ruajtur ungjillin, për t’i afirmuar rrëfimet e besueshme të besimit të ungjillit, për të mbikëqyrur dishepullimin e krishterë, për t’u mësuar dishepujve gjithçka që ai ka urdhëruar dhe për t’i përjashtuar rrëfyesit e rremë (Mateu 16:13–19; 18:15–20; 28:18–20).

Për më tepër, anëtarësia do të duket kudo njëlloj, sepse të gjitha kishat banojnë *pikërisht në të njëjtin kontekst*: në territorin e armikut. Mbani mend që kishat vendore janë ambasada. Ato nuk banojnë në një territor neutral ose miqësor, por pas vijës së armikut. Ja pse, te 1 e Korintasve, Pali e barazon shkishërimin e burrit që po kryente imoralitet me dorëzimin e tij në duart e Satanit. Satani është princi i kësaj bote dhe mbretëritë e botës i përkasin atij përkohësisht (Gjoni 12:31; 14:30; Mateu 4:8–9).

Satani përdor mjete të ndryshme në vende të ndryshme për ta dobësuar mbretërinë e Krishtit. Një nga mjetet e tij të

preferuara në Perëndim është krishterimi kulturor. Lloji amerikan i krishterimit kulturor ka ardhur si rezultat i të rriturve me qëllime të mira, të cilët u shpërndajnë karamellet e hirit që nuk kushton fare fëmijëve pesëvjeçarë dhe njëzetepesëvjeçarëve gjithashtu. Ju i pyesni ata nëse duan të jenë me mamin dhe babin në qiell, ose i shtrëngoni që të dalin përpara kishës [për të pranuar Krishtin]. Ideja është që ju luani me frikërat, emocionet ose orekset e tyre, që të fitoni rrëfime të shpejta dhe të pashqyrtuara besimi. Pastaj ju i afirmoni menjëherë këto lloj rrëfimesh. Kurse lloji i kishës shtetërore evropiane, nga ana tjetër, është shumë herë më i civilizuar. Hiri që nuk kushton fare vjen bashkë me një certifikatë lindjeje.

Gjenialiteti i këtij mjeti në të dyja sfondet është që i jep mundësi Satanit për t'i imunizuar këta njerëz kundër krishterimit të vërtetë. Është pothuajse e pamundur që t'ia shpallësh ungjillin një të krishteri kulturor, sepse ai tashmë e rrëfen me buzët e tij. "Po, *këtë* e besoj." Mirëpo nuk ka pendim. Ai thjesht pagëzon në krishterim një version disi të zbukuruar të vetes së tij të vjetër.

Rreziku tjetër i madh i krishterimit kulturor është që ai i mashtron kishat, duke bërë që të bien pre e mendimit se ato nuk janë duke jetuar në territorin e armikut. Kishat ndihen sikur kombi i tyre është atdheu i vërtetë. Ndihen sikur janë të sigurt.

Nga ana tjetër, Satani përdor mjete shumë të ndryshme në vende të ndryshme. Në Orissa të Indisë, ai do të përdorë një turmë hinduiste, realisht të paligjshme, për ta djegur kishën. Në qytetin e Azisë Qendrore ku Frenku dhe Hansi janë pas-torë, ai do të përdorë vetë pushtetet vendore për t'u infiltruar

ANËTARËSIA E KISHËS

në takimet e kishës, për t'ua konfiskuar materialet dhe për t'i futur pastorët në burg. Në pjesë të ndryshme të Afrikës, ai do të përdorë adhurimin e paraardhësve dhe fenë tradicionale afrikane për t'u bashkuar me ungjillin dhe për ta kthyer atë në diçka krejt tjetër.

Përderisa qeniet njerëzore jetojnë në trupa fizikë, sytë tanë kanë prirjen që të përqendrohen në dallimet sipërfaqësore. Mirëpo gjërat më të rëndësishme nuk dallohen kurrë me sy, dhe për sa i përket qëllimit që kemi këtu, gjëja më e rëndësishme që duhet të kuptojmë është që çdo kishë, kudo që të jetë, banon në një territor armiqësor. Nuk do të ketë asnjë tokë apo ndërtesë të shenjtë në këtë botë derisa Jezusi të kthehet sërish.

Pavarësisht se ku shkoni, pavarësisht se ç'vit është, kisha vendore e mbron ungjillin nga lloj-lloj sulmesh, duke u kujdesur fort për faktin se kë pranon si anëtar. Çdo kishë duhet të bëjë këto pyetje themelore: Kush thua ti se është Jezusi? A je i sigurt që je me të vërtetë gati ta marrësh kryqin tënd dhe ta mohosh veten për t'u identifikuar me Jezusin dhe me trupin e tij?

NË Ç'KUPTIM ËSHTË ANËTARËSIA E NDRYSHME KUDO?

Në të njëjtën kohë, duhet të jetë e qartë, nga ajo që kam thënë tashmë, se kishat në vende të ndryshme ballafaqohen me sfida të ndryshme. Detyra bazë dhe mjetet janë të njëjtat, por strukturat ose strategjitë mund të duken pak ndryshe.

Kompleksiteti shoqëror

Si fillim, sa më e madhe dhe sa më komplekse të bëhet një shoqëri, aq më e vështirë është që të afirmosh dhe të mbikëqyrësh rrëfimet e besueshme të besimit. Kjo detyrë vështirësohet

nga ndryshimet e punës, lëvizjet shoqërore, madhësia e kishës, rrëmuja urbane, oraret shumë të ngjeshura të punës, pluralizmi fetar, paragjykimi etnik, denominacionet e shumta kishtarë, shekujt e herezive të mbledhura bashkë, kishat e rreme, kalimi nga një kishë te tjetra, rrymat kulturore si individualizmi, konsumizmi dhe shumë të tjera. Sa më e madhe dhe sa më komplekse të bëhet një shoqëri, aq më e vështirë bëhet që të dish se kush është me kë.

A je me Jezusin? Nuk mund ta dalloj. Ti vjen vetëm të dielën në mëngjes. Ti jeton tridhjetë minuta larg. Nuk e kam fare idenë se si duket jeta jote gjatë javës. Për vite të tëra, ti ke kaluar nga një kishë te tjetra. Ti më thua se e do Jezusin, por për cilin Jezus po më flet? Kemi me qindra Jezus të ndryshëm nga të cilët mund të zgjedhim.

Pëlqimi ose mospëlqimi shoqëror

Qëndrimi i përgjithshëm i një shoqërie ndaj krishterimit ndikon gjithashtu aftësinë e një kishe për të afirmuar dhe për të mbikëqyrur rrëfimet e besimit. Është ironike, por në disa mënyra është më e lehtë që t'i afirmosh dhe t'i mbikëqyrësh të krishterët në një shoqëri që nga jashtë e kundërshton ungjillin. Mendoni pak për Palestinën e shekullit të parë ose për kombet e sotme myslimane. Në vende të tilla ka një frenim shumë të madh kulturor për t'u identifikuar me një kishë. Prandaj, njerëzit që kërkojnë të pagëzohen ka më pak gjasa që t'i bashkohen një kishe për hir të aprovimit shoqëror.

Tani mendoni për shoqërinë ku mbizotëron krishterimi kulturor. Pagëzimi dhe anëtarësia stimulohen. Fëmijët do të pagëzohen nga prindërit e tyre. Të rriturit do të përfitojnë një

ANËTARËSIA E KISHËS

listë më të madhe klientësh potencialë për shitjet e tyre apo për studion ligjore.

Besoj se që të dyja këto kategori ndryshimesh do ta ndikojnë faktin se sa shumë strukturë i nevojitet një kishë për ta përmbushur detyrën e saj me mjetet që i ka dhënë Krishti. Kjo është një çështje mençurie, gjë që nuk është asnjëherë shkencë ekzakte, por nëse flasim në përgjithësi, mendoj se mund të themi që sa më shumë favor shoqëror të marrë krishterimi dhe sa më komplekse të jetë shoqëria, aq më shumë strukturë mund t'i duhet kishës.

Për shembull, në shoqëritë komplekse, klasat e anëtarësisë ju ndihmojnë që të dini saktësisht se për cilin Jezus po flet kisha. Intervista formale e anëtarësisë e ndihmon kishën që të dijë se për cilin Jezus po flisni ju. Si klasat, ashtu dhe intervistat, ndihmojnë gjithashtu për të caktuar pritshmëritë e të gjithëve.

Për më tepër, në shoqëritë komplekse, regjistrat e anëtarësisë e ndihmojnë kishën për t'i njohur individët e shpërndarë në zona të mëdha metropolitane. Ato e ndihmojnë bashkësinë dhe udhëheqësit e saj që të dinë se për kë janë specifikisht përgjegjës.

Por në shoqëritë më të thjeshta që nuk e favorizojnë krishterimin, gjëra si klasat dhe regjistrat e anëtarësisë mund të jenë të panevojshme dhe të pavolitshme. Në fakt, regjistrat e shkruar mund të jenë të rrezikshëm nëse bien në duart e gabuara. Pasi e kemi thënë këtë, Jezusi ende u ka dhënë kishave të tilla të njëjtat mjete për të njëjtën detyrë: të jenë të dallueshme. Më lejoni t'ju ilustroj këtë gjë me miqtë tanë në Azinë Qendrore.

PIKËNISJA BIBLIKE

Në kishën e Frenkut dhe Hansit dikush bëhet anëtar në çastin e pagëzimit. Megjithatë, pagëzimi gjithmonë vjen pas disa javësh intervistash me pleqtë dhe kishën. Këto intervista nuk ndodhin në zyrat e kishës, pasi ato nuk ekzistojnë. Ato ndodhin gjatë shëtitjeve dhe duke ngrënë një tas me pilaf. Në fakt, ato u ngjajnë më tepër bisedave sesa intervistave, por qëllimi i tyre është i njëjtë: të sigurohen që rrëfyesi i besimit e kupton ungjillin dhe është penduar.

Pastaj personit i kërkohet që ta bëjë rrëfimin e vet të besimit përpara gjithë bashkësisë, dhe këtu anëtarët e kishës bëjnë pyetje. Pleqtë udhëheqin diskutimin, por ata i inkurajojnë të gjithë që të marrin pjesë, përderisa kjo ndihmon për të qartësuar kuptimin që kanë të gjithë për ungjillin.

Bashkësia nuk voton asnjëherë, por në fund arrin një dakordësi për faktin nëse personi është besimtar ose nëse ka nevojë për pak më shumë kohë, në mënyrë që ta demonstrojë vërtetësinë e besimit të tij apo të saj. Në një komunitet mysliman si ky, pritet që kthimi në besim ta ndryshojë jetën e personit, prandaj kisha kërkon prova të kthimit në besim. Ata nuk presin që gjithçka të jetë rregulluar, por duan që të shohin fillimin e pendimit, sidomos gatishmërinë për t'u identifikuar publikisht përpara kishës si një ndjekës i Jezusit.

Si hap i fundit, kisha e jep miratimin e saj përmes pagëzimit, gjë që është mikpritja zyrtare e personit në asamble. Sigurisht që pagëzimet janë të vështira nga ana logjistike për t'u kryer në këtë vend. Ndonjëherë pagëzimet bëhen në një liqen apo në një lumë pak larg qytetit, edhe pse kam pasur

ANËTARËSIA E KISHËS

privilegjin të jem dëshmitar i një pagëzimi që ndodhi në pishinën e një besimtar i më të pasur.

Besoj se kjo bashkësi e vogël në Azinë Qendrore na jep pikënisjen biblike. Ajo nuk i ka të gjitha strukturat që ka kisha ime, por unë do të thosha që ajo e përmbush kriterin e Dhiatës së Re për anëtarësinë biblike të kishës.

- Për të gjithë është e qartë se kush janë anëtarët, edhe pse nuk ekziston një regjistër zyrtar anëtarësie. Të gjithë e dinë se kush është penduar dhe ka besuar, dhe se kush nuk e ka bërë këtë gjë, sepse të gjithë janë të pranishëm në pagëzimet e të gjithë atyre që i bashkohen kishës pas tyre. Ata, gjithashtu, e ruajnë tryezën e Darkës së Zotit, për të ndihmuar që vija ndarëse mes kishës dhe botës të mbetet e qartë.
- Kisha i shqyrton me kujdes rrëfimet e besimit, për t'u siguruar për besnikërinë, edhe pse nuk ka klasa formale anëtarësie apo një intervistë të vetme anëtarësie. Përveç kësaj, deri tani nuk ka pasur kulte apo kisha të rreme, të cilat të kenë ofruar një lloj tjetër Jezusi ose pendimi.
- Çdo anëtar, përfshirë këtu edhe pleqtë, i nënshtrohet mbikëqyrjes së gjithë kishës, edhe pse nuk ka votime kishë. Konsensusi dallohet lehtë në një grup prej pesëmbëdhjetë ose njëzet personash.
- Kisha e praktikon disiplinën si për të ruajtur pastërtinë e saj, ashtu edhe për t'u treguar dashuri personave që janë në gabim.

Në të gjithën këtë, emri dhe fama e Krishtit po mbrohen dhe po shkëlqejnë.

NJË MODEL SHUMË I NDRYSHËM?

Në shikim të parë, procesi për t'iu bashkuar kishës sime në Washington, DC, mund të duket shumë ndryshe. Ju duhet

të filloni duke bërë gjashtë klasa anëtarësie, të cilat trajtojnë deklaratën e besimit të kishës sonë, besëlidhjen, historinë, punën ungjillëzuese dhe elemente të tjera të jetës së bashkësisë.

Nëse ende dëshironi të bëheni anëtarë edhe pas këtij mundimi, atëherë kërkonin një intervistë anëtarësie me një nga pleqtë, për të treguar dëshminë tuaj dhe për të shpjeguar ungjillin. Një nga pastorët njihet për faktin që u kërkon njerëzve ta shpjegojnë lajmin e mirë “për më pak se gjashtëdhjetë sekonda”. Në fund të intervistës do t’ju kërkohet që të firmosni deklaratën e besimit dhe besëlidhjen e kishës.

Plaku i kishës, i cili e ka kaluar gjithë intervistën duke plotësuar një formular anëtarësie, bën kopje të tij për çdo plak. Pleqtë duhet ta lexojnë atë përpara takimit të tyre të radhës. Ata e shqyrtojnë së bashku aplikimin tuaj, votojnë për të duke përdorur *Rregullat e Rendit të Robertit*¹ dhe ia përcjellin atë bashkësisë në takimin dymujor të radhës për anëtarësinë. Pas një prezantimi dyminutësh që ju bëhet nga njëri prej pleqve, ndërkohë që fotografia juaj shfaqet në prezantimin me PowerPoint, edhe bashkësia voton, sërish me ndihmën e Robertit të përpiktë dhe rregullave të tij.

Nëse miratoheni me votim si anëtar, do t’ju përfshijnë në regjistrin e anëtarësisë dhe do të merrni një paketë anëtarësie, e cila përmban disa gjëra të dobishme.

E gjitha kjo tingëllon si shumë burokratike, apo jo? Asnjë

¹ Shënim i përkthyesit: *Rregullat e Rendit të Robertit (Robert's Rules of Order)* është një manual i vëllimshëm mbi procedurat parlamentare për takimet e bordeve të drejtorëve në një larmi organizatash, i cili u shkrua në vitin 1876 nga Henry Martyn Robert.

ANËTARËSIA E KISHËS

nga këto hollësi nuk gjendet në Bibël. Jam i sigurt që Roberti nuk udhëtoi me Palin dhe Barnabën. Ndoshta ishte me Pjetrin?

Në fakt, do të thosha që sot një kishë në qytetet më laike dhe globale *thjesht nuk mund* të bëjë atë që Bibla i urdhëron kishat të bëjnë, pa pasur ndonjë strukturë si kjo. Nuk ka pse të jenë po këto struktura. Ndoshta një kishë dëshiron t'i kërkojë çdo kandidati për anëtar që të bëjë një shëtitje katërorëshe në park me një nga pleqtë e kishës dhe me disa anëtarë të tjerë, për të folur në lidhje me të gjitha çështjet që trajtohen në një klasë dhe intervistë anëtarësie. Ndoshta një kishë dëshiron t'u kërkojë anëtarëve të saj që t'i mësojnë përmendsh emrat, në vend që t'i shkruajnë ata.

Ideja është që duhet të bëhet njëfarë bisede përpara se dikush që rrëfen se është i krishterë dhe një kishë të mund të thonë “Po” në këtë marrëdhënie të ngjashme me një besëlidhje, e cila quhet anëtarësia e kishës. Kisha ka nevojë që të dijë se cilët janë gjithë anëtarët e saj. Në fund të fundit, Jezusi dëshiron që ne të jemi të kujdesshëm me *të gjitha* delet e tij.

Me pak fjalë, unë besoj se ndryshimet mes modeleve të Azisë Qendrore dhe atyre amerikane në thelb janë ndryshime sipërfaqësore. Të dyja kishat po arrijnë të njëjtat objektiva — shpalljen, shfaqjen, dhe mbrojtjen e ungjillit përmes jetëve të anëtarëve të tyre të njohur zyrtarisht.

ANËTARËSIA KA RËNDËSI — JETA E KRISHTERË KA RËNDËSI

Në kishën e Frenkut dhe Hansit faktorët kontekstualë i thjeshtojnë strukturat e anëtarësisë. Siç më tha dikush: “Të zbulosh se kush është brenda dhe kush është jashtë, është mjaft e lehtë.” Kjo u bë e dukshme gjatë bastisjeve të fundit të

kishës nga policia, gjë që i bëri anëtarët të ndiheshin edhe më të dallueshëm se më parë.

Sfida më e madhe për Frenkun dhe Hansin qëndron në mësimin e anëtarëve të kishës në lidhje me detyrimet e tyre të reja ndaj njëri-tjetrit, si dhe për qëllimin e disiplinës së kishës. Mirëpo, për ta, këto mësimë nuk janë aq shumë çështje të anëtarësisë, sa janë çështje të jetës së krishterë. Jeta e krishterë dhe anëtarësia e kishës mbivendosen pothuajse në mënyrë të përsosur për këta shenjtorë të bekuar. Ato janë e njëjta gjë.

Kështu duhet të jetë edhe për ne.

PËRFUNDIM:

Si përkufizohet dashuria nga anëtarësia e kishës

Përmes jetëve të anëtarëve të saj, kisha vendore përkufizon dashurinë për botën.

Ky është lajm i mirë, sepse bota e sotme është shumë e pështjelluar në lidhje me përkufizimin e dashurisë. Ajo mendon se dashuria është si puna e një grushti xhelatine, si diçka që nuk ka thelb, nuk ka pjesë dhe as cepa të ash-për. Bota mendon se dashuria është diçka që nuk ka asnjë kusht, pritshmëri, standard, gjykim. “♥ + ♥ = Martesë”, thotë një etiketë. Madje edhe në qarqet e krishtera, ne e pozicionojmë dashurinë kundër ligjit dhe së vërtetës, duke e ndarë kështu botën në njerëz të së vërtetës dhe njerëz të dashurisë. Problemi i vetëm është që dashuria e Jezusit nuk është e tillë. Dashuria e Jezusit fillon me një akt mëshire, dhe pastaj ata që kanë marrë mëshirë, i thërret në liri dhe bindje.

- Së pari, kjo dashuri është një akt mëshire: “Askush s’ka dashuri më të madhe se kjo, që të japë dikush jetën e vet për miqtë e tij”, tha Jezusi (Gjoni 15:13).
- Pastaj kjo dashuri është një thirrje për bindje: “Nëse më doni, mbani urdhërimet e mia” (Gjoni 14:15).

ANËTARËSIA E KISHËS

Ky është një kombinim të cilin bota nuk e kupton, mirëpo kjo është dashuria e Perëndisë: dashuria dhe shenjtëria nuk bien ndesh njëra me tjetrën, por bashkëpunojnë për t'i udhëhequr njerëzit tek Ai.

Prandaj, mbreti Jezus u bën thirrje kishave që ta shfaqin dashurinë e tij të mëshirshme dhe të bindur përpara botës: “Po ju jap një urdhërim të ri: ta doni njëri-tjetrin; sikurse unë ju kam dashur ju, ashtu edhe ju ta doni njëri-tjetrin. Prej kësaj do t’ju njohin të gjithë që jeni dishepujt e mi, nëse keni dashuri për njëri-tjetrin” (Gjoni 13:34–35). Prandaj, ne e japim jetën për njëri-tjetrin dhe pastaj luftojmë bashkë për lirinë e bindjes. Kur e bëjmë këtë, ne shfaqim dashurinë e Krishtit për botën dhe bëjmë që kombet ta lavdërojnë Perëndinë.

BURIME TË MËTEJSHME

1. Libri im *Disiplina e kishës: Si e ruan kisha emrin e Jezusit* (IGNIS, Tiranë, 2025) është vëllimi shoqërues i këtij libri, dhe shpjegon skenarët e ndryshëm që mund të kërkojnë ushtrimin e disiplinës. Aty zgjerohet përmbajtja e kapitullit të shtatë.

2. Një trajtim më i thellë biblik dhe teologjik i temave të këtij libri mund të gjendet në librin tim *The Church and the Surprising Offense of God's Love: Reintroducing the Doctrines of Church Membership and Discipline* (Crossway, 2010).

3. Thabiti Anyabwile na ofron një meditim të mrekullueshëm për mënyrën se si të kërkojmë një anëtarësi më kup-timplotë, në librin e tij *Çfarë është anëtari i shëndetshëm i kishës?* (Kisha e Hirit, Tiranë, 2014).

4. Nëse nuk e keni lexuar librin e Mark Dever-it, *What Is a Healthy Church?* (Crossway, 2007), ju ka shpëtuar një prezantim shumë i mirë për atë që duhet të kërkonin në një kishë të shëndetshme.

5. Shumë artikuj, vlerësime librash, intervista audio, si dhe pyetje e përgjigje të shkurtra mbi temat e anëtarësisë dhe disiplinës mund t'i gjeni në adresën <https://al.9marks.org/>.

FALËNDERIME TË VEÇANTA

Sërish, një falënderim i madh shkon për Mark Dever-in, Matt Schmucker-in dhe Ryan Townsend-in, të cilët më mbështetën në këtë punë. Bobby Jamieson ishte i pari që e lexoi dhe më ofroi sugjerime të mira. Faleminderit, vëllezër! E dua fort punën time për shkak të këtyre burrave dhe gjithë stafit të organizatës “9Marks”.

Crossway është një botues i mrekullueshëm me të cilin ia vlen të punosh. Faleminderit, Al Fisher dhe gjithë të tjerëve.

Falënderoj lexuesit e tjerë të dorëshkrimit të parë, të cilët e përmirësuan atë, përfshirë edhe Kendrick Kuo-n, Jeff Gearhart-in, Bill dhe Jane Englund-in, Robert Cline-in, dhe Jeramie Rinne-in. Faleminderit shumë, miq!

Si gjithmonë, bashkëshortja ime e mrekullueshme, Shannon, ishte burim mbështetjeje dhe diskutimi në lidhje me përmbajtjen e këtij libri. Jam shumë mirënjohës për ty, e dashur.

Së fundi, falënderoni Perëndinë bashkë me mua, që dërgoi Birin e tij për ta blerë kishën, e cila përfshin rebelë si unë.

SHËNIME

Kapitulli 1: Qasja jonë ka qenë krejt e gabuar

1. Nuk do të thosha që këto dy pika të fundit janë një kërkesë “e detyrueshme”; megjithatë, do të thosha që pagëzimi *zakonisht* duhet të çojë në anëtarësi, dhe që Darka e Zotit *zakonisht* është për anëtarët e kishës.

2. Cituar në librin e Janet Coleman-it, *Against the State: Studies in Sedition and Rebellion* (New York: Penguin, 1990), 37.

Kapitulli 3: Çfarë është një kishë? Çfarë është një anëtar kishë?

1. Edmund P. Clowney, *The Church*, *Contours of Theology* (Downers Grove, IL: InterVarsity, 1995), 40.

Kapitulli 4: Si duket një kishë dhe anëtarët e saj?

1. Walt Disney, *Pinocchio*, drejtuar nga Ben Sharpsteen-i (Burbank, CA: Walt Disney Studio, 1940), DVD.

2. *Back to the Future*, drejtuar nga Robert Zemeckis-i (Hollywood, CA: Universal Studios, 1985), DVD.

3. Dave Barry, *Dave Barry Slept Here: A Sort of History of the United States* (New York: Ballantine, 1997), 149.

4. T. S. Eliot, “The Waste Land” në *Collected Poems 1909–1962* (Boston: Faber & Faber, 1963), 63.

5. W. B. Yeats, “He Wishes for the Cloths of Heaven”, *William Butler Yeats Selected Poems and Three Plays*, botimi i tretë, redaktuar nga M. L. Rosenthal (New York: Collier, 1986), 27.

Kapitulli 7: Çfarë ndodh kur anëtarët nuk e përfaqësojnë Jezusin?

1. David Gergen, “It’s Not Can We, but Will We?” *U.S. News & World Report*, 24 shtator 2001, 60.

TREGUESI I SHKRIMEVE

2 i Samuelit

23:3-4 99

Fjalët e Urta

5:15-16 56

Isaia

11:2-10 99

Mateu

3:8 123

3:9-12 59

3:17 59

4:8-9 132

4:17 59

5:3 59

5:3-16 132

5:10 35

5:13 88, 121

5:48 59

7:16-20 123

7:21-23 59

8:11-12 59

10:10 109

11:27 59

12:33 123

16 64, 66

16:1-12 62

16:13-19 132

16:16 62

16:18-19

18 66, 119, 125

18:3 59

18:4-5 94

18:15-20 65, 132

18:15-17 110

18:20 66

20:25 34

20:26-28 34

21:43 123

24:5 59

25:44-45 59

26 66

26:26-29 69

28 66, 75

28:18-20 11, 132

28:19 67, 69, 96

Marku

1:15 94

Luka

10:7 109

15:24 126

Gjoni

8:36 112

12:31 132

13:34 80, 111

13:34-35 88, 144

ANËTARËSIA E KISHËS

14:9	59	9:10	42
14:15	88, 143	9:18	47
14:30	132	9:20	42
15:13	143	9:22	42
19:11	23	9:27-28	42
20:23	126	9:31	42
20:31	45	9:32	42
		9:42	42
<i>Veprat e Apostujve</i>		10:24	42
1	114	11:18	42
1:15	40	11:19-22	43
2:2	39	11:22	46
2:5	39	11:24	43
2:9-11	39	11:26	43, 46, 50
2:36	39	12:1	46, 50
2:37	39	12:1-2	44
2:38	39, 47, 96	12:5	46
2:41	40, 47	13:4	44
2:42-47	104	13:12	44
2:44-45	40	14:20-23	44
2:46	41	14:23	114
2:47	41	14:27	46, 27
4:4	41	15:3	46
4:20	41	15:4	46
5:1-11	41	15:36-18:22	44
5:11-12	41	16:33	47
5:13	41	17:3	45
5:29	41	18:8	44, 47
5:42	42	18:17	45
6	114	18:23-21:26	44
6:1-2	41	20:7	104
6:4	129	20:28	49, 88, 113
8:3	42, 46	22:16	47
8:4	42	24:26	44
8:12	47	26:24	44
8:14	42	26:28	44
8:17-24	124		

28:31	51	12:25-26	107
Romakëve		12:27	79
6:2	81	15:1-5	45
6:3	47	15:33	33
6:3-5	69	15:49	59
6:4	96	16:1-2	109
8:29	59	16:2	104
10:9	45	2 e Korintasve	
12:4-16	48	2:8	126
12:10	108	3:18	59
12:13	108	4:5	45
13:4	22	6:14	48
15:26	109	6:17	48
1 e Korintasve		Galatasve	
5	88, 119, 125	1	113
5:1	120	2:10	108
5:2	119, 120	2:11-12	48
5:4	46	6:1	110
5:5	119, 120	6:2	81
5:6	120	6:6	109
5:9	125	Efesianëve	
5:9-10	47	1:7	45
5:11	48	1:18	74
5:12	119, 123	3:10	88
5:13	49, 119	3:15	82
9:11-13	109	4:11-16	87
9:14	109	4:11-32	111
11:18	47	4:13	11
11:20-33	86	4:15	11
11:26-29	69	4:25-32	87
12	79, 80	5	81
12:3	45	5:22-31	112
12:7	111	5:31-32	81
12:13	80	6:1-3	125
12:22	80	6:20	44

ANËTARËSIA E KISHËS

Filipianëve

1:27-2:2	101
2:3-4	101
2:5-9	102
2:11	31
2:12-16	102
2:15	100

Kolosianëve

1:15	59
3:9-10	59

1 e Thesalonikasve

5:14	125
------	-----

2 e Thesalonikasve

3:6	125
3:14-15	125

1 e Timoteut

5:8	125
5:9-10	48
5:17	49, 114
5:17-18	109
5:19	115, 129

2 e Timoteut

3:5	125
-----	-----

Titit

1:7	113
3:10	49, 125

Hebrenjve

10:24-25	104
10:25	111
10:34	48
12:6	121

12:10	121
12:11	122
13:7	88, 114
13:17	49, 88, 114

Jakobi

4:4	106
-----	-----

1 e Pjetrit

1:1	45
1:3-12	45
2:5	74
2:9-12	88
3:1-2	125
4:8	124
4:8-11	48
4:10	11, 81
5:2	48, 88, 113

1 e Gjonit

2:19	49, 88
3:7	81
3:17	108
4:1-3	93
4:20-21	88

2 e Gjonit

10	125
----	-----

Juda

20-21	11, 111
23	110

Zbulesa

1:5	23
6:15-17	23
11:15	31

IX 9Marks

Seria “Si të ndërtojmë kisha të shëndetshme”

A ËSHTË KISHA JOTE E SHËNDETSHME?

9Marks ekziston për të pajisur udhëheqësit e kishave me një vizion biblik dhe me burime praktike, për ta shfaqur lavdinë e Perëndisë ndër kombe përmes kishave të shëndetshme.

Për këtë qëllim, ne duam t'i ndihmojmë kishat të rriten në nëntë shenjat e shëndetit, të cilat shpesh lihen pas dore:

1. Predikimi shtjellues
2. Doktrina e ungjillit
3. Një kuptim biblik i kthimit në besim dhe i ungjillëzimit
4. Anëtarësia biblike në kishë
5. Disiplina biblike në kishë
6. Interesimi biblik për dishepullimin dhe rritjen
7. Udhëheqësia biblike e kishës
8. Një kuptim biblik i praktikës së lutjes
9. Kuptimi dhe praktika biblike e misioneve

Në organizatën “9Marks”, ne shkruajmë artikuj, libra, vlerësime librash, si dhe një revistë “online”. Ne organizojmë konferenca, regjistrojmë intervista dhe prodhojmë materiale të tjera për t'i pajisur kishat që ta shfaqin lavdinë e Perëndisë.

Vizitoni faqen tonë të internetit për të gjetur materiale në më shumë se 60 gjuhë të ndryshme dhe për t'u abonuar për revistën tonë falas “online”. Shihni një listë të plotë të të gjitha faqeve tona në gjuhë të huaja në adresën: www.9marks.org/international/.

Shqip: al.9marks.org | Anglisht: 9marks.org

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Leeman, Jonathan

Anëtarësia e kishës : si e kupton bota se kush e përfaqëson Jezusin / Jonathan Leeman;
përkth. Asim Hamza ; red. Rudina Boçe-Le Clus.
- Tiranë : IGNIS, 2026.

156 f. ; 12,7 x 17,78 cm. - (Si të ndërtojmë kisha të shëndetshme).

Tit. origj.: Church membership: How the world knows who represents Jesus. - Parathënia nga Michael Horton .

ISBN 9789928488367

1.Feja kristiane 2.Kisha

PSE DUHET T'I BASHKOHENI NJË KISHE?

Të jesh anëtar i një kishe është pjesë e rëndësishme dhe shpesh e shpërfillur e jetës së krishterë. Megjithatë, prirja këto kohë është që t'i rrimë larg praktikës së fesë së organizuar dhe të shfaqim një mospëlqim apo frikë nga përkushtimi, sidomos ndaj institucioneve.

Jonathan Leeman-i i trajton këto çështje me një shpjegim të qartë se çfarë është anëtarësia e kishës dhe pse është e rëndësishme. Duke i dhënë kishës vendore rëndësinë që i takon, Leeman-i ka paraqitur një argument bindës për t'iu përkushtuar një bashkësie vendore.

“Ky libër i vogël është i mbushur me ide praktike dhe argumente të mira, të cilat do të na ndihmojnë që t'i kurojmë të krishterët në kulturën tonë të sotme nga alergjia e tyre ndaj anëtarësisë së kishës, autoritetit pastoral, llogaridhënies në jetë, si dhe ndaj çdo kufizimi që i bëhet lirisë së tyre personale.”

TIM KELLER, pastor kryesor, Redeemer Presbyterian Church, New York City

“I shkurtër, i freskët, argëtues dhe, mbi të gjitha, biblik. Ky libër është shpjegimi më i qartë dhe mbrojtja më e mirë e anëtarësisë së kishës që keni pritur të lexoni.”

MARK DEVER, pastor kryesor, Capitol Hill Baptist Church, Washington, DC

“Leeman-i na kujton që anëtarësia e kishës nuk është një zgjedhje, por një domosdoshmëri. Ky është një libër goditës dhe provokues, por, njëkohësisht, është i mbushur me ungjillin e hirit.”

THOMAS SCHREINER, profesor i interpretimit të Dhiatës së Re në katedrën “James Buchanan Harrison”, The Southern Baptist Theological Seminary

JONATHAN LEEMAN (MDiv, Southern Baptist Theological Seminary) është anëtar i Kishës Baptiste Capitol Hill, në Washington, DC, autor i librit *The Church and the Surprising Offense of God's Love*, si dhe bashkautor i librit *Rizbulo Kishën*, të botuar tashmë në gjuhën shqipe. Ai, gjithashtu, shërben si drejtor i redaktimit për shërbesën *9Marks* dhe është redaktor i revistës së saj digjitale *eJournal*.

*Ky vëllim është pjesë e serisë “9Marks: Si të ndërtojmë kisha të shëndetshme”.